



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TREGTISË
DHE SIPËRMARRJES
DREJTORIA E AUDITIT TË BRËNDSHËM

Drejtoria e Përgjithshme e
Patentave dhe Markave
NR. 7157/2 PROT
DT. 24/2/2015

Nr. 7157/2 Prot.

Tiranë, më 24/2 /2015.

Drejtuar:

Z. ELVIN LAKO
DREJTOR I PËRGJITHSHËM
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PATENTAVE DHE MARKAVE

TIRANË

Lënda: Dërgohen konstatimet pas përfundimit të angazhimit të auditimit dhe rekomandimet.

I nderuar Z. LAKO

Bazuar në Ligjin nr.9720, datë 23.04.2007 "Për Auditin e Brëndshëm në Sektorin Publik", ndryshuar me Ligjin nr. 10318, datë 16.09.2010 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr 9720, datë 23.04.2007 "Për auditimin e brëndshëm në sektorin publik", Manualin e Procedurave të Auditimit të Brëndshëm miratuar me Urdhërin nr. 69 datë 29.09.2010 të Ministrit të Financave "Për miratimin e manualit të procedurave të auditimit të brëndshëm", Urdhërin e Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes nr.420, datë 05.09.2014 "Për kryerje auditimi" dhe në zbatim të Programit të Angazhimit të Auditimit nr 7157 prot, datë 07.10.2014, Drejtoria e Auditimit të Brëndshëm (DAB) në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave (DPPM), Tiranë, kreu një mision auditimi të pjesshëm me objekt : "Zbatimi i ligjëshmërisë dhe rregullshmërisë në procedurat e prokurimeve publike", për periudhën 01.01.2014 deri më 30.08.2014.

Grupi i auditimit gjatë realizimit të këtij angazhimi, ka konstatuar gjetjet e mëposhtëme:

✦ Në drejtim të procedurave të prokurimit me vlera të vogla, rezultoi se:

- Në 17 raste, nuk paraqitet i dokumentuar procesi i përlogaritjes së fondit limit, duke marrë për bazë çmimet për mallrat ose shërbimet nga eksperiencat e mëparëshme ose nga ofertat e marra nga testimi i tregut, proces ky i moskryer nga anëtarët e Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël, konformë :

-VKM nr 1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, Kreu VI, pika 2/a, "c";

-Udhëzimit nr 2, datë 28.03.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, i ndryshuar, pika 2.

- Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr 33, datë 11.07.2013 “Për gjurmët standarte të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë” (deri në shfuqizimin nga Udhëzimi nr 57, datë 12.06.2014),

- Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr 57, datë 12.06.2014 “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë më të madhe se 400.000 lekë pa tvsh dhe më të vogël se 400.000 lekë pa tvsh”

- Në 3 procedurat te prokurimit, mbështetur dhe referuar Faturës Tatimore të Shitjes të lëshuar nga operatori ekonomik i shpallur fitues dhe përcjelljes së mallit pranë Institucionit , konstatohet se secili Operator ekonomik, nuk ka përmbushur kërkesën e paraqitur nga AK në pikën 2 të Ftesës për Oferte , sipas të cilës : Operatori ekonomik fitues të paraqitet pranë DPPM për kryerjen e shërbimit, jo më vonë se një ditë pune nga marrja e njoftimit të fituesit. Furnizimi është kryer tej afatit të kërkuar.

- Në procedurën e prokurimit me objekt : Për lyerjen e ambienteve të brëndshme të DPPM u konstatuan këto mangësi :

✓ Dokumentohet se ka ndryshime në volumin e punimeve të paraqitur në Urdhërin e Prokurimit me atë të paraqitur e publikuar në Ftesën për Ofertë.

✓ Nuk dokumentohet ndjekja e hapave dhe proceseve të lidhura me:

1. Procesin e përlllogaritjes së fondit limit , bazuar në preventivin përkates i cili përcakton zërat e punimeve dhe volumin e tyre, të hartuar nga specialist të fushës (ing) ,

2. Hartimin e procesverbalit për të përshkruar të gjitha ofertat e mbledhura dhe përcaktimin e fondit limit .

Mos kryerja e veprimeve të mësipërme është në kundërshtim me Urdhërin e Ministrit të Financave nr 57, date 12.06.2014”Për gjurmët standarte të auditit për prokurimin me vlerë më të madhe se 400.000 lekë pa tvsh dhe më të vogël se 400.000 lekë pa tvsh”.

✓ Në kushtet kur objekti i prokurimit lidhet dhe është përfundimi i një pune publike , detyrimisht midis palëve duhej hartuar dhe nënshkruar Kontrata e Shërbimit, në të cilin të paraqiteshin detyrimet dhe përgjegjësitë e palëve (Investitorit dhe Sipermarresit). Aktualisht kjo kontrate nuk është lidhur .

- Nga ana e Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël (KPVV), nuk dokumentohet ndjekja e hapave dhe proceseve të lidhura me:

1. Procesin e përlllogaritjes së fondit limit , pas testimit të tregut për të marrë tregues për çmimin e mallit ,

2. Hartimin e procesverbalit për të përshkruar të gjitha ofertat e mbledhura dhe përcaktimin e fondit limit .

Mos kryerja e veprimeve të mësipërme është në kundërshtim me Urdhërin e Ministrit të Financave nr 33, date 11.07.2013”Për gjurmët standarte të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë “

Jo në të gjitha rastet, praktikat administrojnë kopjet e printuara nga sistemi për “Njoftimin e Fituesit “.

Përfundimisht auditimi vlerëson se: Institucioni , Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave, për procedurat e prokurimit me vlera të vogla, ka krijuar një sistem të plotë dhe të

rregullt procedurash, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Risku në këtë fushë rezulton në nivel të Ulët.

✚ Nga ana e DPPM dhe Titullarit të Institucionit, në referim të gjurmës standarde të auditit për prokurimet me vlerë më të madhe se 400.000 lekë dhe më të vogël se 400.000 lekë, nuk janë marrë masat për hartimin e gjurmëve të auditimit për procedurat kryesore të menaxhimit dhe administrimit të mjeteve monetare dhe materiale të institucionit , duke u miratuar me pas nga Titullari i Institucionit.

Në përfundim të procesit të vlerësimit të sistemeve të bëra nga DAB, në mbështetje të : nenit 7, pika 1a/iii dhe nenit 21, pika 7, të Ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007 “ Për auditin e brëndshëm në sektorin publik”, ndryshuar me Ligjin nr.10318, datë 16.09.2010, pikës 4.4 “Raportimi i rekomandimeve” dhe pikës 4.5 “Projekt raporti dhe raporti final” të Kapitullit IV të Manualit të Auditimit të Brëndshëm në sektorin publik, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave Nr 69, date 29.09.2010 dhe pikes 3.3.4 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr 12, date 05.06.2012 “Mbi procedurat e kryerjes së veprimtarise se auditimit të brëndshëm në sektorin publik”, me qëllim përmirësimin e veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave (DPPM), për të rritur efektivitetin e punës, funksionimin dhe drejtimin e saj, janë dhënë rekomandimet përkatëse, të cilat janë paraqitur dhe përfshirë në Planin e Veprimit.

I. Bazuar në pikën “b”, të nenit 11, të Ligjit nr 9720, datë 23.04.2007 “Për auditin e brëndshëm në sektorin publik”, të ndryshuar , pikën 4.4 “Raportimi i rekomandimeve” të Manualit të Auditimit të Brëndshëm dhe pikën 3.3.6 të Procedurave të kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brëndshëm në sektorin publik (miratuar me Udhëzimin e Ministrit të Financave, nr 12, date 05.06.2012) :

- të hartohet një Plan-Veprimi për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna (sipas Formatit bashkëlidhur) ;
- Një kopje e këtij Plan Veprimit të miratuar nga Drejtori i Pergjithshem i Institucionit, të dërgohet zyrtarisht në Drejtorinë e Auditimit të Brëndshëm, brënda 30 ditëve nga mbritja e kësaj shkrese.

II. Në zbatim të Urdhërit nr. 70, datë 18.04.2006, të Kryeministrit “Për masat në zbatim të rekomandimeve të KLSH, Auditit të Brëndshëm dhe Departamentit të K.B.A dhe Antikorupsion në Këshillin e Ministrave , në Institucionet në varësi të Kryeministrit a të ministrave”, të kërkesave të pikës 3.2.3 “Përgjegjësia e organizatës për të zbatuar rekomandimet e auditimit të brëndshëm ” të Manualit të Auditimit të Brëndshëm Publik (miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave Nr.69, date 29.09.2010), Drejtori i Përgjithshëm i Institucionit, të informojë zyrtarisht Drejtorinë e Auditimit të Brëndshëm, mbi marrjen e masave dhe programimin e detyrave.

III. Bazuar në pikën 7 të nenit 21 të Ligjit nr .9720, date 23.04.2007“ Për auditimin e brëndshëm në sektorin publik “, i ndryshuar dhe të pikës 4.5 të Kap.IV të “Manualit të Auditimit të Brendshëm”, bashkëlidhur ju dërgojmë një kopje të Planit të Veprimit të

rekomandimeve të miratuara, mbi auditimin tematik të kryer në Drejtorinë e Përgjithshme të Patentave dhe Markave, Tiranë.

DREJTOR
TEUTA SHKËMBI

PLAN VEPRIMI MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË MIRATUARA.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PATENTAVE DHE MARKAVE, TIRANË

Nr. i Reko mand imeve	Rekomandimet	Renditja sipas niveleve	Reagimi i menaxhimit	Afati i Përcaktuar
IMAZA ORGANIZATIVE				
1	Çdo procedurë prokurimi, të administrojë dhe të dokumentojë procesin e përlogaritjes së Fondit limit, duke marrë për bazë çmimet për mallrat ose shërbimet nga eksperiencat e mëparëshme ose nga ofertat e marra nga testimi i tregut.	Niveli i ulët.	Institucioni nuk ka paraqitur asnjë reagim .	Në vijim për çdo procedurë të prokurimit me vlera të vogla.
2	Komisioni i Prokurimit me vlera të vogla, gjatë përcaktimit të <u>Afatit të lëvrimit të mallit ose realizimit të shërbimit/punës</u> të paraqitur tek Ftesa për Oferte, për procedurat e prokurimit të furnizimit apo shërbimeve ,të përcaktojnë këtë afat në varësi të objektit të prokurimit dhe specifikës së tij për tu realizuar.	Niveli i ulët	Institucioni nuk ka paraqitur asnjë reagim .	Në çdo rast , për procedurat e prokurimit në vijim.
3	Mbështetur dhe bazuar në detyrimin e përcaktuar në : - nenit 16 “Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit”, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 10296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” , - Kapitullin III të “Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, miratuar nga Ministri i Financave me Urdhrin nr. 54, date 15.07.2010, - pikës 3 të Urdhërit të Ministrit të Financave nr. 57, datë 12.06.2013 “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë më të madhe se 400.000 lekë pa tvsh dhe më të vogël se 400.000 lekë pa tvsh” , Titullari i Institucionit të marrë masa për hartimin e gjurmëve të auditimit për procedurat kryesore të menaxhimit dhe administrimit të mjeteve monetare dhe materiale të	Niveli i mesem	Institucioni nuk ka paraqitur asnjë reagim .	Afati : Brënda 6/mujorti të l-r të vitit 2015.

	institucionit dhe të miratohen nga titullari.				
--	---	--	--	--	--

DIREKTOR
TEUTA SHKËMBI

Detajimi i limitit mujor per fondet buxhetore te vitit 2015,

Elda Rama

Sent: Tuesday, January 20, 2015 9:57 AM

To: Aferdita Rrokaj

Pershendetje,

Në mbështetje të Ligjit Nr. 160, datë 27.11.2014, "Për buxhetin e vitit 2015", Udhëzimit Nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", si dhe shkresës Nr. 18082/151, datë 13.01.2015, të Ministrisë së Financave, ju dërgojmë miratimin e detajimit të limitit mujor të fondeve buxhetore për vitin 2015, për shpenzimet korrente, sipas Tabeles Nr. 2 të bashkëlidhur.

MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TREGTISE DHE SIPERMARRJES

Detajimi i limitit mujor per fondet buxhetore te vitit 2015,

					Tabela nr.2			
Muaji	Enti	Minstr.	Kodi	Emeri i institucionit		Llogaria	Kodi	Debiti
v.2014	Qeverises	Linjes	Institucionit	Emer institucioni	Kapitulli	Ekonomike	Thesarit	ne leke
01-2015	001	04	1004076	Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave	01	6009999	3535	2.163.000
01-2015	001	04	1004076	Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave	01	6029999	3535	375.000
02-2015	001	04	1004076	Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave	01	6009999	3535	2.167.000
02-2015	001	04	1004076	Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave	01	6029999	3535	375.000
03-2015	001	04	1004076	Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave	01	6009999	3535	2.167.000
03-2015	001	04	1004076	Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave	01	6029999	3535	375.000
04-2015	001	04	1004076	Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave	01	6009999	3535	2.167.000
04-2015	001	04	1004076	Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave	01	6029999	3535	375.000
05-2015	001	04	1004076	Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave	01	6009999	3535	2.167.000
05-2015	001	04	1004076	Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave	01	6029999	3535	375.000
06-2015	001	04	1004076	Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave	01	6009999	3535	2.167.000
06-2015	001	04	1004076	Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave	01	6029999	3535	375.000
07-2015	001	04	1004076	Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave	01	6009999	3535	2.167.000
07-2015	001	04	1004076	Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave	01	6029999	3535	375.000
08-2015	001	04	1004076	Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave	01	6009999	3535	2.167.000
08-2015	001	04	1004076	Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave	01	6029999	3535	375.000
09-2015	001	04	1004076	Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave	01	6009999	3535	2.167.000
09-2015	001	04	1004076	Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave	01	6029999	3535	375.000
10-2015	001	04	1004076	Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave	01	6009999	3535	2.167.000
10-2015	001	04	1004076	Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave	01	6029999	3535	375.000
11-2015	001	04	1004076	Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave	01	6009999	3535	2.167.000
11-2015	001	04	1004076	Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave	01	6029999	3535	325.000
12-2015	001	04	1004076	Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave	01	6009999	3535	2.167.000
12-2015	001	04	1004076	Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave	01	6029999	3535	325.000

Elda Rama

Përgjegjëse e Sektorit të Buxhetit

Drejtoria e Financës

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë

Tel: +355 42 22 34 55

Mob: +355 68 56 41 942

E-mail: elda.rama@ekonomia.gov.al

Web: <http://www.ekonomia.gov.al>

Entiteti Qeverisës	Grupi	Kodi i institucionit	Emertimi i institucionit	Kapitulli	Programi	Elogjaria ekonomike	Kodi i Thesarit	Plani i miratuar 2016 në lekë
001	04	1004001	Aparati i MZHEHTS	01	01110	6000000	3535	155,900,000
001	04	1004001	Aparati i MZHEHTS	01	01110	6010000	3535	26,000,000
001	04	1004001	Aparati i MZHEHTS	01	01110	6020000	3535	48,390,000
001	04	1004001	Aparati i MZHEHTS	01	01110	6050000	3535	63,250,000
001	04	1004001	Aparati i MZHEHTS	01	01110	6060000	3535	360,000
001	04	1004131	AIDA	01	04130	6000000	3535	23,500,000
001	04	1004131	AIDA	01	04130	6010000	3535	4,500,000
001	04	1004131	AIDA	01	04130	6020000	3535	16,000,000
001	04	1004093	QKR	01	04130	6000000	3535	34,276,000
001	04	1004093	QKR	01	04130	6010000	3535	5,724,000
001	04	1004093	QKR	01	04130	6020000	3535	47,500,000
001	04	1004093	QKR	01	04130	6040000	3535	50,500,000
001	04	1004083	ATRAKO	01	04130	6000000	3535	12,000,000
001	04	1004083	ATRAKO	01	04130	6010000	3535	2,000,000
001	04	1004083	ATRAKO	01	04130	6020000	3535	2,000,000
001	04	1004121	QKI	01	04130	6000000	3535	26,500,000
001	04	1004121	QKI	01	04130	6010000	3535	4,500,000
001	04	1004121	QKI	01	04130	6020000	3535	10,000,000
001	04	1004009	"DPA	01	04160	6000000	3535	12,000,000
001	04	1004009	"DPA	01	04160	6010000	3535	2,500,000
001	04	1004009	"DPA	01	04160	6020000	3535	3,000,000
001	04	1004009	"DPA	01	04160	6050000	3535	1,000,000
001	04	1004121	DPPM	01	04160	6000000	3535	22,500,000
001	04	1004121	DPPM	01	04160	6010000	3535	2,500,000
001	04	1004121	DPPM	01	04160	6020000	3535	2,000,000
001	04	1004121	DPPM	01	04160	6050000	3535	2,000,000



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PATENTAVE DHE MARKAVE

RAPORTI VJETOR 2015



PËRMBAJTJA:

Faqe

FJALA E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM	5
INFORMACION I PËRGJITHSHEM	7
I. PATENTAT MBI SHPIKJET	8
II. MARKAT TREGTARE DHE TË SHËRBIMIT	11
III. DISENJOT INDUSTRIALE	15
IV. TREGUESIT GJEOGRAFIKË	17
V. NDRYSHIME LIGJORE, ÇËSHTJE NË BORDIN E APELIMIT, PËRFAQËSIMI NË GJYKATË.	18
VI. BASHKËPUNIME DHE MARRËVESHJE NDËRKOMBËTARE	21
VII. BASHKËPUNIME DHE MARRËVESHJE NDËRMJET INSTITUCIONEVE VENDASE	23
VIII. FINANCA	24
IX. TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT, KOMUNIKIMIT DHE SHËRBIMET ELEKTRONIKE	26
X. AKTIVITETE TË DPPM	29





FJALA E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM

Jam i nderuar që paraqes raportin vjetor të punës së DPPM për vitin 2015.

Së pari, dua të falenderoj të gjithë subjektet tregtare, personat fizikë dhe juridikë shqiptarë dhe të huaj për interesin që paraqitën duke aplikuar pranë DPPM për të siguruar mbrojtjen ligjore të pronës së tyre industriale. Me regjistrim, idetë dhe shpikjet e tyre sigurojnë jo vetëm mbrojtjen, por edhe një vlerë ekonomike të shtuar për ta.

E bëj këtë falenderim nisur edhe nga fakti që në vitin 2015 u rrit ndjeshëm numri i aplikimeve nga bizneset shqiptare për të mbrojtur produktet e reja dhe shërbimet me të cilat ato operojnë në tregun shqiptar. Numri i aplikimeve shqiptare për regjistrim markash, i shprehur në përqindje ka një rritje prej 20.9% më shumë për vitin 2015 në krahasim me vitin 2014 dhe 35.4% më shumë se në vitin 2013. Përsa i përket numrit të aplikimeve për patenta kombëtare, kemi një rritje prej 41.7% më shumë në krahasim me vitin 2014.

Rritja e këtyre aplikimeve është një tregues i mirë se produktet e reja që po hidhen në treg po shtohen ndjeshëm dhe se biznesi ynë po ndërgjegjësohet për regjistrimin dhe mbrojtjen nga konkurrenca e pandershme.

Eksperiencat e vendeve të zhvilluara kanë treguar se çelësi i suksesit tashmë janë idetë, risia, inovacioni si dhe ofrimi i shërbimeve të reja.

Bizneset tona po fillojnë të kuptojnë, që asete nuk quhen vetëm prona dhe kapitali, por ajo që tashmë më shumë se kurrë ndikon tek suksesi është pronësia intelektuale dhe strategjia e hedhjes së saj në treg.

Është mjaft inkurajues edhe fakti që biznesi i huaj e sheh Shqipërinë si vend atraktiv për regjistrimin e produkteve të tyre. Këtë vit numri patentave të regjistruara në Shqipëri nga të huajt arriti rekord ndër vite. Patentat shënuan një rritje prej 27 % krahasuar me vitin 2014 dhe prej 52 % krahasuar me vitin 2013, duke treguar kështu, që bizneset e huaja po ndërtojnë urat e tyre lidhëse për transferimin e teknologjive të reja në Shqipëri. Aplikimet për regjistrimin e markave nga biznese të huaja, gjithashtu në vitin 2015, shënuan një rritje të konsiderueshme duke treguar që tregu shqiptar është tërheqës për investitorët e huaj. Nga Marrëveshja dhe Protokolli i Madridit, janë depozituar 2555 aplikime për vitin 2015, krahasuar me vitin 2014 ku janë depozituar 2414 aplikime, kjo e shprehur në përqindje me rritje prej 5.8% në 2015-tën.

Konkretisht, shifrat përkatëse që tregojnë trendin në rritje të aplikimeve për regjistrim të markave dhe patentave pranë DPPM, mund t'i gjeni në vijim të këtij raporti vjetor.

Në këto kushte, mund të themi me bindje se Shqipëria ka hyrë në një fazë të rëndësishme të reformave të transformimit të ekonomisë. Ne si DPPM, kemi patur një vizion të qartë dhe ambicioz në lidhje me objektivat që kërkojmë të arrijmë me punën tonë. Politikat e qeverisë e listojnë pronësinë intelektuale si një ndër prioritetet e saj në rrugën drejt zhvillimit ekonomik dhe integritetit në BE. Këto politika synojnë vendosjen e dialogut gjithpërfshirës ndërmjet aktorëve të ndryshëm në mënyrë që të krijohen kushte të përshtatshme për respektimin dhe mbrojtjen e pronës intelektuale. Sa më e mbrojtur të jetë prona intelektuale, aq më e zhvilluar është ekonomia e një vendi. Ajo është një forcë shtytëse drejt progresit.

Përpjekjet tona janë fokusuar në përmbushjen e detyrave tona funksionale duke treguar përpikmëri në zbatimin e detyrimeve ligjore dhe korrektësi për dhënien e informacionit personave të interesuar, si dhe duke ofruar shpejtësi në shërbimet tona.

Një ndër sfidat tona ka qenë orientimi i biznesit drejt inovacionit. Mënyra e duhur për të mundur këtë synim tonin, është nxitja e bashkëpunimit ndërmjet bizneseve të mëdha apo ndërmarrjeve të mesme dhe të vogla me universitetet dhe qendrat kërkimore. Ky bashkëpunim do mundësonte identifikimin dhe nxitjen e personave me potencial për krijimtari dhe sjellje të inovacionit në industrinë shqiptare. Gjithashtu, ndërgjegjësimi i publikut mbi rolin e pronësisë industriale dhe avantazhet që ajo sjell, ka qenë prioritet i yni.

Është vlerësuar si domosdoshmëri forcimi i kapaciteteve administrative të DPPM. Aktualisht ne kemi një staf prej 24 personash nga 15 që ishin më parë, si dhe kemi një strukturë të re të DPPM. Ndryshimi i strukturës së DPPM i shërben përmbushjes së një prej detyrave funksionale të DPPM për ndërgjegjësimin dhe shpërndarjen e informacionit ndaj publikut dhe faktorëve dhe

aktorëve të përfshirë në sistem, si dhe rritjes të cilësisë së ekzaminimit dhe përshpejtim të procedurave. Volumi i punës që DPPM përballon është gjithnjë e në rritje, prandaj synohet që në të ardhmen të bëhet e mundur shtimi më tej i stafit. Ndër çështjet mbi të cilat është fokusuar vëmendja jonë, ka qenë puna për hartimin e projekt-strategjisë kombëtare mbi pronësinë intelektuale 2016-2020 në bashkëpunim me Grupin Ndërinstitucional të Punës, si dhe hartimin e projektiligjit për amendimin e ligjit 9947 dt.07.07.2008, "Për pronësinë industriale". Këto dy dokumente përbëjnë në vetevete një iniciativë për reformimin e sistemit të pronësisë industriale në vend. Kjo ka ardhur pas një analize të detajuar të problematikave të hasura gjatë punës sonë, konsultimit me grupet e interesit, si dhe me miratimin për iniciimin e përmirësimeve ligjore nga MZHETTS.

DPPM ishte në rolin e sekretariatit teknik të hartimit të strategjisë kombëtare. Hartimi i saj u krye nga bashkëpunimi mes ekspertëve nga të gjitha institucionet shqiptare të përfshira në sistemin e pronësisë intelektuale, si dhe me konsultimin me mbi 40 grupe të ndryshme të interesit.

Gjithashtu, hartimi i kësaj strategjie është asistuar nga ekspertët e Organizatës Botërore e Pronësisë Intelektuale si dhe nga pjesëmarrja në mbledhjet e grupit të punës për strategjinë e përfaqësuesve të Delegacionit të Komisionit Evropian në Shqipëri. Fokusi i saj është përmirësimi i funksionimit të sistemit të pronësisë intelektuale me qëllim, nxitjen dhe mbështetjen e inovacionit nëpërmjet punës kërkimore, në veçanti nga shoqëritë tregtare shqiptare, universitetet vendase dhe individët, për të drejtuar ekonominë shqiptare dhe qytetarët drejt zhvillimit dhe standardeve më të larta.

Pjesë përbërëse e kësaj strategjie janë sigurimi i të drejtave të pronësisë intelektuale, mirëfunksionimi i sistemit gjyqësor, si dhe një infrastrukturë moderne për ofrimin e shërbimeve në këtë fushë. Strategjia gjithashtu sugjeron që sistemi i PI duhet të inkurajojë transferimin e teknologjisë përmes shitjes dhe blerjes të teknologjisë së mbrojtur me patentë. Ajo gjithashtu i jep prioritet fushatave të ndërgjegjësimit në publik mbi rëndësinë e PI dhe forcimin e bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar ndërmjet institucioneve të përfshira në sistem.

Një nga objektivat e strategjisë është edhe përmirësimi i kuadrit ligjor të pronësisë industriale. Për këtë arsye është hartuar projektligji mbi ndryshimet në ligjin "Për Pronësinë Industriale".

Ky projektligj parashikon një sërë masash reformuese të cilat konsistojnë në:

- Reformë administrative të institucioneve që administrojnë të drejtat e pronësisë intelektuale.
- Rritjen e cilësisë së shërbimit duke shkurtuar afatet procedurale,
- Rregullime dhe saktësime të problemeve të hasura nga zbatimi i ligjit aktual në praktikë,
- Përshtatja me eksperiencat dhe praktikat e zyrave homologe ndërkombëtare,
- Plotësimi i rekomandimeve të Komisionit Evropian në progres-raportin e tij për Shqipërinë.

Rëndësi e veçantë i është dhënë forcimit të bashkëpunimit me institucione të huaja dhe vendase me qëllim mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale.

Shqipëria është anëtare e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale dhe Organizatës Evropiane të Patentave, si dhe është në proces anëtarësimi (në varësi të anëtarësimit të Shqipërisë në BE), me Zyrën e Pronësisë Intelektuale të Bashkimit Evropian, me të cilën ka edhe marrëveshje bashkëpunimi dypalëshe. Duke qenë se këto janë tre organizmat ndërkombëtarë më të rëndësishme në fushën e pronësisë intelektuale, janë përmbyllur detyrimet për pjesëmarrje dhe përfaqësim në komitetet dhe takimet e organizuara prej tyre, si dhe janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi të cilat konsistojnë në planet e përbashkëta për organizimin e trajnimeve, seminareve dhe shkëmbimin e eksperiencave si dhe për përmirësimin e sistemeve operative. Gjithashtu stafi i DPPM-së ka marrë pjesë në trajnimet e organizuara prej tyre, për të arritur një nivel kualifikimi sipas standardeve ndërkombëtare.

Shfrytëzoj rastin të shpreh mirënjohjen time për Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për kujdesin dhe mbështetjen që na ka ofruar në lidhje me iniciativat e ndërmarra për fuqizimin e kapaciteteve institucionale dhe përmirësimet ligjore në fushën e pronësisë industriale me qëllim përmbylljen me sukses të misionit tonë.

Mirënjohje dhe falenderime shkojnë edhe për Organizatën Botërore të Pronësisë Intelektuale, për Zyrën Evropiane të Patentave, si dhe për Zyrën e Pronësinë Intelektuale të Bashkimit Evropian, për bashkëpunimin dhe suportin që na kanë ofruar.

Për sa prezantova më sipër, fjala ime do të përmbyllet duke theksuar që;

Është shumë e rëndësishme t'i japim vetes dhe vendit tonë mundësitë dhe benefitet më të mira që pronësia industriale na ofron, duke i sjellë zhvillimin e mëtejshëm ekonomisë sonë dhe hapa konkretë drejt integritit në Bashkimin Evropian.

Duke ju falenderuar!

Elvin LAKO

Drejtor i Përgjithshëm

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Pronësia industriale është pjesë e pronësisë intelektuale. Si e tillë ajo është rezultat i krijimeve të mendjes njerëzore. Qënia njerëzore nga vetë natyra shpik dhe krijon ide duke gjetur zgjidhje të problemeve të ndryshme që përmirësojnë jetën tonë. Këto ide kanë nevojë të mbrohen, përkufizohen dhe të promovohen. Është pikërisht pronësia intelektuale, ajo që kryen këtë funksion duke i specifikuar dhe mbrojtur të drejtat e krijuesve, shpikësve dhe sipërmarrësve, por edhe të konsumatoreve. Pronësia intelektuale është nxitëse zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të një vendi.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PATENTAVE DHE MARKAVE

STATUSI

DPPM është institucion buxhetor publik i krijuar në mbështetje të Ligjit Nr. 9947 datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale” i ndryshuar dhe është institucioni i vetëm nëpërmjet të cilit shteti shqiptar jep të drejtat mbi patentat e shpikjeve dhe modelet e përdorimit, topografinë e produkteve gjysmë përçues, markat tregtare dhe të shërbimit, dizenjot industriale dhe treguesit gjeografikë, duke iu njohur mbajtësve të të drejtave pronësinë mbi këto objekte nëpërmjet regjistrimit. DPPM është institucion në varësi të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë, dhe Sipërmarrjes.


MISIONI

DPPM ka si mision të forcojë mbrojtjen e pronësisë industriale brenda territorit shqiptar nëpërmjet njohjes, regjistrimit, dhe promovimit të këtyre të drejtave, për të garantuar një nivel mbrojtjeje të njëjtë me atë të vendeve të Bashkimit Evropian.

KOMPETENCAT

- Ushtimi i kompetencave ekzekutive në fushën e pronësisë industriale.
- Ekzaminimi i aplikimeve për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale.
- Regjistrimi i objekteve të pronësisë industriale dhe lëshimi i çertifikatave të regjistrimit.
- Mbajtja e regjistrave të objekteve të pronësisë industriale të regjistruara për territorin e Republikës së Shqipërisë.
- Lëshimi i vërtetimeve mbi statusin e objekteve të pronësisë industriale si dhe i ekstrakteve të regjistrimit.
- Promovimi dhe trajnimi i aktorëve të përfshirë në sistemin mbi të drejtat dhe rëndësinë e pronësisë industriale me qëllim nxitjen, zhvillimin dhe forcimin e mbrojtjes së saj.
- Koordinimi i punës dhe marrëdhënieve me organizatat ndërkombëtare të pronësisë intelektuale në të cilat Shqipëria është anëtare.
- Pjesëmarrja në komitetet dhe takimet e organizuara nga Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale Organizata Evropiane e Patentave
- Publikimi i buletineve me të dhënat mbi aplikimet në DPPM.
- Shqyrtimi dhe vendimmarrja mbi kundërshtimet ndaj aplikimeve për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale në Bordin e Apelit.

STRUKTURA





I. PATENTAT E SHPIKJEVE

Shpikje konsiderohet zgjidhja e një problemi teknik. Problemi mund të jetë i ri ose i vjetër, zgjidhja duhet të jetë e re. Kjo zgjidhje mund të sjellë krijimin e një produkti ose të një procesi. E rëndësishme është që shpikja të përbëjë risi, hap shpikës, si dhe të jetë e aplikueshme në industri. Personi që arrin të bëjë një shpikje duhet të përfitojë ekonomikisht nga ajo. Këtë e bën të mundur mbrojtja me patentë e shpikjes, e cila zgjat 20 vjet.

Ka tre mënyra për regjistrimin e patentave në Shqipëri:

1. Aplikime për patenta që paraqiten drejtpërdrejt në DPPM si një aplikim kombëtar;
2. Aplikime për patenta nëpërmjet Traktatit të Bashkëpunimit për Patentat (TBP);
3. Patenta të lëshuara nga Zyra Evropiane e Patentave (ZEP) dhe që kërkojnë shtrirje të mbrojtjes në Shqipëri.

Pothuajse të gjitha patentat të cilat janë të vlefshme në Shqipëri janë patenta të grantuara në ZEP dhe janë në fuqi në Shqipëri në bazë të marrëveshjes me ZEP ose në bazë të konventës Evropiane për Patentat (KEP).

Rreth 97.5% e të gjitha patentave të regjistruara në DPPM janë patenta të lëshuara nga Zyra e Patentave Europiane (ZEP) dhe janë shtrirë ose janë bërë të vlefshme në Shqipëri. Kjo do të thotë se gati të gjitha patentat në fuqi në Shqipëri janë dhënë nga ZEP dhe janë pjesë e një familjeje të madhe patentash të cilat janë mbrojtur edhe në vende të tjera anëtare të KEP.

Nga viti 1997 deri në vitin 2015, janë paraqitur vetëm 68 aplikime për patenta drejtpërdrejt në DPPM nga aplikantë shqiptarë e cila përbën 1.16% të aplikimeve në total. Kjo tregon një përdorim të ulët të patentave kombëtare, dhe gjithashtu justifikon faktin e mungesës së ekzaminimit në substancë të patentave nga DPPM, pasi pjesa më e madhe e tyre vjen e ekzaminuar nga ZEP.

Në listën me 20 të parët, e mbajtësve të së drejtës për patentë në Shqipëri gjatë periudhës 1997-2015 janë kompani shumëkombëshe të huaja farmaceutike dhe kimike. Këto kompani zotërojnë gati 40% të totalit të patentave të regjistruara në Republikën e Shqipërisë.

Aplikimet nga universitetet dhe institucionet kërkimore përbëjnë pak më shumë se 2% të aplikimeve për patenta në DPPM. Numri i ulët i aplikimeve për patenta nga universitetet ka mbetur konstant me kalimin e kohës. Universitetet dhe institutet kërkimore të cilat aplikojnë për mbrojtjen e patentave në Shqipëri janë të vendosura kryesisht në vendet e BE dhe SHBA dhe aplikimet e tyre përqëndrohen kryesisht në aplikime për patenta farmaceutike dhe kimike. Aktualisht nuk ka asnjë aplikim për patentë të paraqitur nga një universitet apo institut kërkimor shqiptar.

Shumica e kompanive të huaja, të cilat i kanë të mbrojtura patentat e tyre në Shqipëri, nuk i kanë të regjistruara markat e tyre në DPPM. Nisur nga ky fakt, mund të themi se shpikjet e patentuara nuk përdoren në Shqipëri.

Shumica e patentave mbahen në fuqi për të gjithë afatin ligjor të parashikuar nga ligji (20 vite). Kjo për faktin se shumica e patentave të mbrojtura farmaceutike janë pronë e kompanive të mëdha shumëkombëshe farmaceutike dhe rritja e tarifave të rinovimit të patentave pothuajse është e papërfillshme për këto kompani.

Përsa i takon aplikimeve për modele përdorimi janë vetëm tre aplikime të tilla në DPPM deri në fund të vitit 2015.

Kompanitë vendase, universitetet, dhe shpikësit individuale janë pak prezent në sistemin e mbrojtjes së patentave për shpikje. Arsyet për këtë situatë janë si më poshtë:

- kompanitë dhe universitetet shqiptare nuk gjenerojnë shpikje të patentueshme;


- patentat shqiptare kanë nivel të ulët përdorimi nga kompanitë, universitetet dhe shpikësit për shkak të rrezikut të ulët të perceptuar të imitimit, si dhe mungesës së një tregu aktiv për teknologjitë ku shpikjet e patentuara mund të liqensohen apo të shiten;
- niveli i ulët i ndërgjegjësimit në universitete dhe kompani për sistemin e mbrojtjes së patentave për shpikje.

Pavarësisht shkaqeve të mësipërme, vlen për t'u përmendur së gjatë këtij viti është rritur ndjeshëm numri i aplikimeve për patenta kombëtare nga 12 në 17, e përkthyer në 41.7% më shumë.

Në funksion të nxitjes së regjistrimit të shpikjeve vendase, u vendos që për personat me aftësi të kufizuara, pensionistët dhe studentët tarifa e aplikimit dhe e regjistrimit të një patente të bëhej 100 lek. Si pasojë gjatë periudhës në vazhdim për herë të parë gjatë funksionimit të kësaj zyre, u aplikuan 2 patenta nga studentë dhe 1 patentë nga një pensionist.


Në vitin 2015 në DPPM janë depozituar 534 aplikime për patenta në krahasim me 423 aplikime të depozituara gjatë vitit 2014, pra kemi një rritje prej 22.8 % të numrit të aplikimeve për patenta. Nga këto, 2 aplikime për patenta vijnë nga Traktati i Bashkëpunimit për Patentat, 17 aplikime për patenta janë aplikime kombëtare me aplikantë nënshtetas Shqiptarë, dhe 515 aplikime për patenta, janë patenta të lëshuara nga Zyra Europiane e Patentave të cilat kërkojnë mbrojtje në Shqipëri. Tabela dhe grafiku i mëposhtëm tregojnë numrin e aplikimeve për patenta në pesë vitet e fundit.

	Aplikime për patenta kombëtare	EP	PCT	Totali
2010	2	338	1	341
2011	5	342	6	353
2012	5	342	4	351
2013	4	340	4	348
2014	12	409	2	423
2015	17	520	2	539
Totali	45	2291	19	2355



Patenta të regjistruara nga DPPM në periudhën 2010-2015

Viti	Numri i patentave të grantuara
2010	340
2011	438
2012	352
2013	414
2014	391
2015	478
Totali	2415



APLIKIME	Viti 2014	Viti 2015	% e rritjes
Aplikime për patentë kombëtare	12	17	41.7%
Patenta nga Zyra Europiane e Patentave	409	520	27.1%
Aplikime nga Traktati i Bashkëpunimit në fushën e patentave	2	2	0 %
TOTALI	2	2	0 %

DOKUMENTA TË DEPOZITUARA NË DPPM	2014	2015
Numri i kërkesave për patentë shpikje	423	520
Numri i kërkesave për ripërtëritje të patentave	2220	2449
Dokumenta të tjera në lidhje me patentat	480	818
TOTALI	3123	3787

Gjatë vitit 2015, janë lëshuar 3890 akte administrative brenda afateve të parashikuara në Ligj dhe në rregulloren e patentave gjë që tregon volumin e punës të këtij sektori.



II. MARKA TREGTARE DHE TË SHËRBIMIT

Çelësi i suksesit për një ndërmarrje është edhe marka që ajo përdor. Marka duhet që qartazi të bëjë të mundur që të dallohet origjina tregtare e produkteve dhe shërbimeve që ofrohen në treg, si dhe të jetë tërheqëse dhe joshëse për sytë e konsumatorit.

Marka garanton ruajtjen e reputacionit të pronarit të saj si dhe besimin e konsumatorit mbi cilësinë e produkteve. Marka duhet të regjistrohet në mënyrë që të ndalohet falsifikimi saj. Mbrojtja e markës zgjat pafundësisht duke u ripërtërirë çdo 10 vjet.

Ka dy mënyra për të kërkuar mbrojtje për një markë në Shqipëri, nëpërmjet:

1. Aplikimit drejtpërdrejt në DPPM nga subjekte shqiptare dhe subjekte të huaja nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar të markave.
2. Aplikimit ndërkombëtar, drejtpërdrejt në Organizatën Botërore të Pronësisë Intelktuale (OBPI) nëpërmjet Marrëveshjes dhe Protokollit të Madridit.

Këto marka tregtare të depozituara për të cilat kërkohet mbrojtje sipas mënyrave të lartpërmendura, kanë të njëjtën vlerë për territorin e Republikës së Shqipërisë.

DPPM ekzaminon aplikimet për marka mbi formalitetet dhe shkaqet absolute për refuzim.

APLIKIME PËR MARKA TREGTARE

Në vitin 2015, DPPM pranoi 3492 aplikime për marka, duke patur një rritje të konsiderueshme në krahasim me vitin 2014, ku janë pranuar 3319 aplikime dhe 3282 aplikime të pranuar në vitin 2013. Shifrat e vitit 2015 përfshijnë 937 aplikime kombëtare nga të cilat 507 janë aplikime shqiptare dhe 2555 aplikime nga OBPI sipas Marrëveshjes dhe Protokollit të Madridit.

Rritje ka patur numri i aplikimeve shqiptare që në vitin 2015 kanë arritur në 509 aplikime në krahasim 421 aplikime në vitin 2014 dhe 376 aplikime në vitin 2013. E shprehur në përqindje 20.9% më shumë në 2015 se në 2014 dhe 35.4% më shumë se në 2013.

Nga Marrëveshja dhe Protokollit i Madridit janë depozituar 2555 aplikime për vitin 2015, krahasuar me vitin 2014 ku janë depozituar 2414 aplikime, e shprehur në përqindje me rritje prej 5.8% në 2015-tën.

Gjatë vitit 2015 në përgjithësi numri i aplikimeve kombëtare (shqiptare) dhe numri i aplikimeve nga Marrëveshja dhe Protokollit i Madridit janë rritur.

Në rritjen e numrit të aplikimeve kombëtare ka ndikuar rritja ekonomike, shtimi i numrit të bizneseve vendase të reja të regjistruara, fuqizimi i atyre ekzistuese dhe shtimi i gamës së produkteve që ato prodhojnë si dhe puna e kryer nga punonjësit e DPPM për ndërgjegjësimin e biznesit në lidhje me rëndësinë e regjistrimit të markave të tyre.

Numri i aplikimeve nga pronarë të huaj ka pësuar një rënie të lehtë por që gjatë vitit 2015 është kompensuar me shtimin e numrit të aplikimeve nga marrëveshja dhe protokollit i Madridit. Në total, kemi një rritje të numrit të aplikimeve të huaja nga 2898 në vitin 2014 në 2984 në vitin 2015, pra 86 aplikime më shumë në vitin 2015. Kjo për arsye se shumë persona që bëjnë biznes për herë të parë në vende të ndryshme e kanë parë më të arsyeshme rrugën ndërkombëtare të aplikimit për regjistrim, pasi Marrëveshja dhe protokollit i Madridit, parashikon më shumë lehtësira si në mënyrën e aplikimit (nëpërmjet

një aplikimi në disa shtete njëkohësisht), pagesë më e lirë, përdorimi i vetëm një gjuhe të huaj dhe pa patur nevojë për shumë përfaqësues të autorizuar (PA).

Tabela e mëposhtme tregon numrin e kërkesave nga aplikantë shqiptarë, numrin e kërkesave nga aplikantë të huaj dhe numrin e kërkesave për regjistrim nga Marrëveshja dhe Protokollin e Madridit në 5 vitet e fundit.

	Aplikime Shqiptare	Aplikime në rrugë Kombëtare nga aplikantë të huaj	Aplikime nga Marrëveshja dhe Protokollin e Madridit	Total
2010	238	372	2897	3507
2011	257	463	2776	3496
2012	276	410	2697	3383
2013	377	398	2507	3282
2014	420	485	2414	3319
2015	509	428	2555	3492
Total	2077	2556	15846	20479

Rritja e numrit të aplikimeve shqiptare ka ardhur si rezultat i fushatës së gjerë ndërgjegjëse të ndërmarrë nga DPPM.

Tabela e mëposhtme tregon numrin e kërkesave regjistrim/ripërtëritjeve dhe numrin e regjistrimeve/ripërtëritjeve.

	Numri i kërkesave për marka	Numri i kërkesave për ripërtëritje të markave në fazë kombëtare	Dokumenta të tjera në lidhje me marka e aplikuar në fazë kombëtare	Dokumenta të tjera në lidhje me marka të aplikuar nga Sistemi i Madridit	Total
2013	3282	297	2207	14663	20449
2014	3319	271	2555	8553	14203
2015	3492	614	2674	7474	14254
Total	10093	1182	6941	30690	48906

Gjatë vitit 2015 janë depozituar 937 aplikime kombëtare dhe 2555 aplikime ndërkombëtare, në total 3492 aplikime dhe 763 regjistrime. Janë refuzuar 36 aplikime për marka si rezultat i ekzaminimit për baza absolute dhe 5 refuzime për moskryerje pagese regjistrimi. Gjatë vitit 2015 kemi një ulje të numrit të refuzimeve për moskryerje pagese regjistrimi. Aplikimet për marka normalisht ekzaminohen brenda 3-mujave nga data e depozitimit. Koha për regjistrimin e një marke zgjatet në rastet kur ka probleme me listën e mallrave dhe shërbimeve.



Aplikimet për marka sipas klasifikimit të Nicës për vitin 2015

Mallrat dhe shërbimet për të cilat kërkon të regjistrohet një markë klasifikohen sipas Marrëveshjes së Nicës (Klasifikimi i Nicës). Klasifikimi për produktet dhe shërbimet bëhet sipas objektit të mbrojtjes së markës. Shqipëria është anëtare e kësaj Marrëveshje dhe për këtë qëllim është detyrim klasifikimi i mallrave dhe shërbimeve sipas këtij klasifikimi.

Tabela dhe grafiku i mëposhtëm tregon se pjesa më e madhe e markave të regjistruara pranë DPPM i përkasin klasave 02, 05, 35, 01, 41, 30, 03, 32, 25, 38 dhe 29 të klasifikimit të Nicës. Pra, këto të dhëna tregojnë se në Shqipëri vazhdon të ketë më shumë interes për regjistrimin e markave që i përkasin produkteve si bojra, verniqe, llaqe, sektorit farmaceutik, shërbime të administrimit, menaxhimit, duke vazhduar me produktet e industrisë kimike, shërbimet për administrim dhe manazhim biznesi, edukim, argëtim dhe aktivitete sportive dhe kulturore dhe produktet ushqimore me ingredientet e tyre etj.

Marka sipas klasave (mallrave dhe shërbimeve përkatëse).

Nr. Klasave	2	5	35	1	41	30	3	32	25	38	29
Nr. Aplikimeve	221	143	122	116	106	105	94	67	65	61	61



Shoqëri tregtare shqiptare që kanë aplikuar në Shqipëri për regjistrim markash.

Numrin më të madh të regjistrimeve në vitin 2015 e ka një shoqëri tregtare shqiptare me 22 marka e shoqëruar nga Hemofarm a. d. farmaceutsko-hemijska industrija Vršac me 20 regjistrime dhe Colgate-Palmolive Company (A Delaware Corporation) me 16 regjistrime.

SHOQËRIA/KOMPANIA	NR. APLIKIMEVE		SHTETI	
DAST	22		AL	
Hemofarm a. d. farmaceutsko-hemijska industrija Vršac	20		MK	
Colgate-Palmolive Company (A Delaware Corporation)	16		US	
British American Tobacco (Brands) Inc.	15		US	
Albtelecom sh.a.	14		AL	
RM sh.p.k	14		AL	
Eastern Company S. A. E.	11		EG	
Sanovel Ilac Sanayi Ve Ticaret Anonim Sirketi	11		TR	
SIGAL UNIQA Group AUSTRIA	11		AL	
MAHS INVESTMENT HOLDING LTD.	10		AL	
Valtelina Shpk	9		AL	
Toto Limited	9		AL	
"DMAX EXPERT" SH.P.K	8		AL	
COOP ITALIA SOCIETA' COOPERATIVA	7		IT	
Uniliver N. V.	7		NL	
Bosnaliyek, farmaceutska i hemijska industrija, dionicko drustvo	7		BA	

MARKA TË REGJISTRUARA NGA DPPM NË VITET 2010 - 2015

Tabela e mëposhtme tregon numrin e markave të regjistruara në vitet 2010-2015. Viti 2015 ka numrin më të madh të regjistrimeve në 6 vitet e fundit.

Viti	Numri i markave të regjistruara
2010	590
2011	567
2012	721
2013	563
2014	498
2015	763
Totali	3702

Tabela tregon numrin e dokumentave të lëshuara nga ky sektor i DPPM në lidhje me aplikimet për marka. Në vitin 2015 kemi numrin më të madh të dokumentave të lëshuara nga DPPM 7910 dokumenta.

	Nr. i dokumentave të lëshuara
2010	6044
2011	6674
2012	8367
2013	6440
2014	5845
2015	7910
Totali	41280

INDUSTRIAL DESIGN



III. DISENJOT INDUSTRIALE

Kur zgjedhim një produkt të ri sigurisht që tërhiqemi nga pamja e jashtme estetike e tij. Na pëlqen që produkti të ketë një pamje të re dhe të sofistikuar në detaje apo ngjyra. Disenjoja duhet të performojë me efikasitet në mënyrë që t'i japë vlerë produktit për konsumatorin. Krijuesi i një disenjoje industriale duhet ta mbrojë nëpërmjet regjistrimit krijimin e tij që të mos kopjohet nga të tjerët. Një disenjo industriale mbrohet për një periudhë 25-vjeçare, me mundësi ripërtëritjeje çdo 5 vjet.

Ka dy mënyra në të cilat mund të regjistrohen disenjot industriale në Shqipëri:

- Aplikime për disenjo industriale direkt në DPPM.
- Aplikime për disenjo industriale nëpërmjet marrëveshjes së Hagës.

Tarifa e depozitimit është 4000 lekë dhe tarifa e regjistrimit 6000 lekë. Pas lëshimit të dëshmisë së depozitimit ka një periudhë 3-mujore nga data e publikimit.

Shqipëria është palë kontraktuese e marrëveshjes së Hagës dhe disenjot regjistrohen përmes sistemit ndërkombëtar të regjistrimit e hyjnë automatikisht në fuqi në Shqipëri, në qoftë se vendi është përcaktuar nga aplikanti (përveç rasteve kur DPPM-ja lëshon një refuzim). DPPM nuk ri-publikon regjistrimin ndërkombëtar.

Janë 76 aplikime kombëtare për disenjo deri tani në Shqipëri dhe 1201 aplikime nga Marrëveshja e Hagës. Përpara vitit 2010 aplikimet për diseno depozitoheshin nga shtetas jo shqiptarë. Qysh nga 2010 janë kryesisht kompanitë shqiptare që kanë aplikuar për depozitim të disenjove në Shqipëri. Nuk ka universitete apo institucione shkencore që të kenë aplikuar për regjistrim disenjosh në Shqipëri.

Tabela e mëposhtme tregon numrin e aplikimeve në fazë kombëtare dhe aplikime nga Marrëveshja e Hagës.

	Aplikime ne faze kombëtare	Aplikime nga Marrëveshja e Hagës
2010	6	193
2011	17	190
2012	25	193
2013	8	291
2014	15	231
2015	5	293
Totali	76	1391

Tabela paraqet 10 subjektet që kanë depozituar më shumë disenjo industriale në DPPM.

10 Aplikantët më kryesorë për disenjo industriale.

Shoqëria	Shteti	Disenjo	%
Alumil Albania	AL	16	22.54%
Pirro	AL	8	11.27%
Coca Cola	US	6	8.45%
Arseni	AL	4	5.63%
Ardeno	AL	3	4.23%
Mars	US	3	4.23%
Sony	JP	3	4.23%
Tigani Group	AL	3	4.23%
Shell	CH	3	4.23%
Bibita Group	AL	3	4.23%





IV. TREGUESIT GJEOGRAFIKË

Çdo konsumator dëshiron që produktet të cilat përdor në kuzhinën e tij t'i ketë të kontrolluara dhe të ketë garanci mbi origjinën e tyre. Këtë e bën të mundur treguesi gjeografik i regjistruar i produkteve. Tregues gjeografik është emri i një vendi, lokaliteti ose rajoni që shërben për të përcaktuar produktet që e kanë origjinën në atë vend, cilësia, reputacioni dhe karakteristikat e të cilit janë atribut i kësaj origjine gjeografike.

Në Shqipëri ne kemi zona që kanë veçori klimaterike të ndryshme si dhe krahina që kanë trashëguar traditë dhe kulturë të hershme. Kjo bën që në krahina të ndryshme të ekzistojnë një larmi produktesh që mund të regjistrohen si tregues gjeografikë. Prandaj është punuar për identifikimin e këtyre produkteve, për të mundësuar shfrytëzimin e tyre ekonomik, por edhe për t'i treguar botës kulturën dhe traditën e vendit tonë.

Në 1 Dhjetor 2015 përfundoi zbatimi i projektit “Mbrotjtja e produkteve dhe markave nëpërmjet bashkëpunimit ndërkufitar” i cili filloi zyrtarisht në 2 qershor 2014. Qëllimi kryesor i projektit ishte rritja e ndërgjegjësimit nëpërmjet promovimit për mbrojtjen e markave dhe patentave në Shqipëri. Në fund të implementimit të projektit, në DPPM janë paraqitur dy aplikime për regjistrimin e treguesit gjeografikë, Molla Dibrane dhe Jufka Dibre.

Ka një mënyrë për regjistrimin e treguesve gjeografikë në Shqipëri:

-Aplikime për tregues gjeografikë që paraqiten drejtpërdrejt në DPPM si aplikim kombëtar.

Gjatë gjithë viteve janë paraqitur gjithsej 11 kërkesa për regjistrim të Treguesve Gjeografikë, nga të cilat 2 janë aplikuar në vitin 2015.

Tregues gjeografikë të regjistruar janë 5 nga të cilat 4 janë me aplikantë shqiptarë.

Vihet re që numri i aplikimeve për regjistrimin e treguesve gjeografikë është i ulët.

Aplikimet për regjistrim të treguseve gjeografikë në vite

	Nr. i aplikimeve
2010	1
2011	0
2012	0
2013	2
2014	2
2015	2
Totali	7



V. NDRYSHIME LIGJORE, ÇËSHTJE NË BORDIN E APELIMIT, PËRFAQËSIMI NË GJYKATË.

Përmirësimi i vazhdueshëm i bazës ligjore me qëllim përafrimin me legjislacionin dhe standardet e vendeve të BE është në fokusin e veprimtarisë së DPPM.

Mbrojtja e të drejtave mbi objektet e pronësisë industriale është një nga aspektet më të rëndësishme të rregulluara nga legjislacioni mbi pronësinë industriale. Mbrojtja fitohet fillimisht nëpërmjet aplikimit për regjistrim pranë DPPM dhe në vijim duke provuar të drejtën e mëparshme mbi një objekt të pronësisë industriale pranë Bordit të Apelit apo në Gjykatë. DPPM publikon periodikisht buletin e aplikimeve për regjistrimin e patentave, markave, disenjove apo treguesve gjeografikë, në mënyrë që çdokush që është mbajtës i të drejtave mbi pronësinë industriale të ketë mundësi të kundërshtojë në rrugë administrative regjistrimin e një objekti të pronësisë industriale që cënon të drejtat e tij.

Spektori Juridik gjatë vitit 2015, në përmbushje të aktivitetit të tij funksional, ka punuar në këto drejtime kryesore:

Hartimi i akteve ligjore me qëllim përmirësimin e legjislacionit

1. Gjatë vitit 2014 u miratua ligji Nr. 9947 datë 07.07.2008, "Për Pronësinë Industriale" i ndryshuar, i cili për të qenë i zbatueshëm dhe funksional, ngarkon ligjvënësin për nxjerrjen e akteve nënligjore. Në vitin 2015 u miratuan 5 (pesë) projektvendimet në fushën e Pronësisë Industriale, konkretisht:

- Vendim i Këshillit të Ministrave, Nr. 37, datë 21.1.2015 "Për Disa Shtesa Dhe Ndryshime Në Vendimin Nr. 883, Datë 13.5.2009, Të Këshillit të Ministrave, "Për Miratimin e Tarifave për Regjistrimin e Objekteve të Pronësisë Industriale", të Ndryshuar, u publikua në Fletoren Zyrtare Nr.7, datë 21.01.2015
- Vendim i Këshillit të Ministrave, Nr. 38, datë 21.1.2015 "Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Vendimin Nr. 1707, Datë 29.12.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për Miratimin e Rregullores për lëshimin e Patentave për Shpikjet dhe modelet e Përdorimit", të Ndryshuar, u publikua në Fletoren Zyrtare Nr.7, datë 21.01.2015
- Vendim i Këshillit të Ministrave, Nr. 548, Datë 18.6.2015 "Për Disa Shtesa Dhe Ndryshime Në Vendimin Nr. 381, Datë 8.4.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për Miratimin e Rregullores "Për Regjistrimin E Disenjove Industriale", u publikua në Fletoren Zyrtare Nr.108, datë 18.06.2015
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 549, Datë 18.6.2015 "Për Disa Shtesa Dhe Ndryshime në Vendimin Nr. 1705, Datë 29.12.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për Miratimin e Rregullores "Për Regjistrimin e Treguesve Gjeografikë", u publikua në Fletoren Zyrtare Nr.108, datë 18.06.2015
- Vendim i Këshillit të Ministrave, Nr. 550, Datë 18.6.2015 "Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Vendimin Nr. 1706, Datë 29.12.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për Miratimin E Rregullores Për Regjistrimin e Markave Tregtare dhe të Shërbimit", u publikua në Fletoren Zyrtare Nr.108, datë 18.06.2015.

Në Ligjin 9947 datë 07.07.2008, "Për Pronësinë Industriale" i ndryshuar, edhe pse konsiderohet si i përafëruar me *acquis communautaire*, nuk gjejnë zbatim rekomandimet e raportit të vlerësimit të Komisionit Evropian të nëntorit 2013, i cili ngre një sërë çështjesh të rëndësishme për t'u zgjidhur si hartimi i kriterëve për markat e mirënjohura,

hartimi i kriterëve për ekspertët e PI-së në Gjykata, përmirësimi i cilësisë së ekzaminimit, aplikimet on-line si dhe forcimi i kapaciteteve administrative të drejtorisë. Për këto arsye pas shumë diskutimeve që bëri grupi i punës i ngritur me Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të DPPM, nr.30 datë 22.07.2015 “ Për ngritjen e grupit të punës për draftimin e versionit fillestar të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin 9947, Datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale”, i ndryshuar” nxori në pah produktin e përfituar nga zbatimi i urdhërit nr. 39, datë 05.12.2014, të Drejtorit të Përgjithshëm të DPPM-së, për reformimin e sistemit të PI-së. Pikat kryesore të identifikuara të cilat propozohen të ndryshohen në legjislacion, janë:

- *Ndryshimi i strukturës organizative dhe funksionale të DPPM-së me qëllim forcimin e kapaciteteve administrative dhe financiare, si element kryesor i realizimit të misionit të saj.*

- *Rishikimi i bazës ligjore përsa i përket:*

kompetencave *ex-officio* të Zyrës për ç’regjistrim të objekteve të regjistruara në DPPM;

funksionit dhe kompetencave të Bordit të Apelimit;

kompetencave të Gjykatës.

- *Përmirësimi i bazës ligjore që ka të bëjë me:*

lehtësimin e procedurave të ekzaminimit;

eliminimin e problemeve të hasura gjatë zbatimit të ligjit në praktikë.

-*Përcaktimi ligjor i rregullave për markat e mirënjohura;*

- *Hartimi i kriterëve për ekspertët që Gjykata dhe Prokuroria përcakton për objektet e PI-së.*

-*Krijimi i një mjedisi ligjor për përmirësimin e shërbimeve elektronike dhe të komunikimit. Mundësia e aplikimit on-line.*

-*Rishikimi i bazës ligjore për përfaqësuesit e autorizuar.*

Përfaqësimi i DPPM në çështjet gjyqësore me objekt të drejtat e pronësisë industriale.

Për gjithë vitin 2015, Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave ka ndjekur 23 çështje në Gjykatë. Ndër të cilat:

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë janë ndjekur 13 çështje, ndër të cilat:

- 3 çështje kanë pasur si objekt shfuqizim i vendimit të Bordit, ku DPPM është thirrur si palë e paditur;

- 1 çështje me objekt kthim shume, ku DPPM është thirrur si person i tretë;

-2 çështje me objekt ç’regjistim marke ndërkombëtare, ku DPPM është thirrur si person i tretë;

- 1 çështje me objekt ç’regjistrim marke kombëtare, ku DPPM është thirrur si person i tretë;


- 6 çështje me objekt konstatim konkurrence e pandershme, ku DPPM është thirrur si person i tretë.

Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë janë ndjekur 10 çështje ndër të cilat:

- 1 çështje me objekt rivendosje në afat të së drejtës së ankimit, ku DPPM është thirrur si person i tretë.

- 9 çështje me objekt shfuqizim vendim i bordit të Apelimit të DPPM, ku DPPM është thirrur si palë e paditur (Gjykata ka vendosur për pranimin e kërkesës së padisë në 3 çështje dhe në 5 çështje ka rrezuar kërkesë padinë, në 1 çështje palët kanë arritur në marrëveshje mes tyre).

Në Gjykatën e Apelit Tiranë është ndjekur 1 çështje ku DPPM është thirrur si Person i Tretë me objekt: “Pavlefshmëri marke”.



Ndjekja e procedurave dhe përpilimi i akteve ligjore të Bordit të Apelit.

Kërkesa të depozituara për kundërshtim nga Bordi i Apelit:

	Nr. i kërkesave të depozituar
2014	48
2015	55

Gjatë vitit 2015 Bordi i Apelit ka marrë vendim për 39 çështje duke vendosur:

- pranimin e kërkesës dhe refuzimin e aplikimit për regjistrim marke në **21** raste;
- rrëzimin e kërkesës dhe vazhdimin e procedurave të regjistrimit të markës në **14** raste;
- mospranimin për shqyrtim të kërkesës në **2** raste;
- pushimin e shqyrtimit për shkak të dorëheqjes nga marka ose nga kërkesa për kundërshtim, në **2** raste;

9 prej vendimeve të Bordit janë apeluar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Vendimet e marra nga Bordi i Apelit



VI. BASHKËPUNIME DHE MARRËVESHJE NDËRKOMBËTARE

Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave është anëtare e marrëveshjeve ndërkombëtare më të rëndësishme mbi Pronësinë Intelektuale, si dhe është anëtare e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (WIPO) dhe e Zyrës Evropiane të Patentave (EPO). Me qëllim përmbushjen e detyrimeve që lindin nga anëtarësimi, si dhe realizimin e objektivave dhe angazhimeve të ndërmarra nga Shqipëria lidhur me të drejtat e Pronësisë Intelektuale në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizimit Asociimit dhe Integritimit në Bashkimin Evropian, DPPM i kushton një rëndësi të veçantë zbatimit dhe zhvillimit të çështjeve që lidhen me marrëdhëniet ndërkombëtare mbi pronësinë intelektuale.



Përfaqësues të DPPM në kuadër të bashkëpunimit me Organizatat dhe Zyrat Ndërkombëtare, ndjekin rregullisht takimet dhe mbledhjet periodike të organizuara prej tyre duke plotësuar detyrimin që lind si vend anëtar për përfshirje aktive në çështjet që diskutohen në këto takime.

Në vitin 2015 DPPM ka firmosur marrëveshje bashkëpunimi me:

- Zyrën për Harmonizim të Tregut të Brendshëm (OHIM), sot Zyra e Pronësisë Intelektuale e Bashkimit Evropian (EUIPO)
- Zyrën Evropiane të Patentave (EPO)

Këto marrëveshje konsistojnë në planet e përbashkëta për organizimin e trajnimeve, seminareve dhe shkëmbimin e eksperiencave si dhe për përmirësimin e sistemeve operative si më poshtë:

Marrëveshja me Zyrën e Harmonizimit të Tregut Të Brendshëm u nënshkrua më datë 27 Korrik 2015. Kjo marrëveshje vjen në vijim të plotësimit të kushteve për antarësimin e Shqipërisë në BE, pas marrjes së statusit kandidat në Qershor 2014.

Kjo marrëveshje shpreh edhe njëherë gadishmërinë e të dy institucioneve për të forcuar bashkëpunimin ndërmjet tyre i cili mund të drejtojë në krijimin e një partneriteti strategjik në tregun Evropian sa i përket mbrojtjes së Markave dhe Disenjove Industriale.

Bashkëpunimi i DPPM-së me Zyrën e Pronësisë Intelektuale të Bashkimit Evropian, ndikon në harmonizimin e procedurave të regjistrimit dhe mbrojtjes së markave dhe disenjove industriale në Shqipëri me atë të vendeve të BE. Aktivitetet e parashikuara në këtë marrëveshje janë:

- Programe trajnimi për stafin e zyrës.
- Takime të përbashkëta midis ekspertëve të markave dhe disenjove industriale.
- Bashkëpunim në shkëmbimin e informacionit.

- Përmirësimin e sistemeve dhe shërbimeve elektronike.
- Harmozimin e praktike të ekzaminimit të markave dhe disenjove industriale.
- Rritjen e ndërgjegjësimit për markat dhe disenjt industrialë në Shqipëri.

Marrëveshja për Planin e Bashkëpunimit Dypalësh me Zyrën Europiane të Patentave u nënshkrua më datë 12 Gusht 2015.

Plani afatmesëm përfshin periudhën 2015-2018, dhe është në kuadër të zhvillimit të bashkëpunimit me Zyrën Europiane të Patentave antëtare e së cilës Shqipëria është që prej muajit Maj 2010.

Aktivitetet e parashikuara në këtë plan do të bëjnë të mundur forcimin e sistemit të mbrojtjes së Patentave Europiane në territorin e Republikës së Shqipërisë, forcimin e kapaciteteve administrative të zyrës si edhe rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit për patentat e shpikjeve në Shqipëri.

Gjithashtu, janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi teknik me zyrat homologe të Pronësisë Intelektuale me vendet e tjera. Është ripërtërirë marrëveshja e bashkëpunimit teknik me Zyrën e Pronësisë Intelektuale të Turqisë si dhe është nënshkruar marrëveshja me Zyrën e Pronësisë Intelektuale të Serbisë e cila parashikon bashkëpunimin ndërmjet palëve i cili do të kryhet në shkëmbim të praktikave dhe eksperiencave më të mira, organizim i vizitave të ndërrjellta, shkëmbim njohurish mbimbi ofrimin e shërbimeve të specializuara të pronësisë intelektuale tek klientët dhe mbi aktivitetet e rritjes së ndërgjegjësimit, organizim i konferencave simpoziumeve, seminareve dhe eventeve të tjera edukative mbi pronësinë intelektuale.

Memorandumi i bashkëpunimit do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit dhe do të mbetet në fuqi për pesë vjet. Ai do të zgjerohet automatikisht për të njëjtin afat me përjashtim nëse njëra nga Palët dorëzon një njoftim me shkrim tek Pala tjetër, të paktën gjashtë muaj përpara datës së planifikuar të përfundimit, duke deklaruar qëllimin e saj për ta përfunduar atë.

Pjesëmarrje në seminare dhe trajnime



Stafi i DPPM ka marrë pjesë në seminare dhe trajnime të organizuara nga Organizatat dhe Zyrat Ndërkombëtare, me qëllim përafrimin e praktikave dhe përfitimin nga eksperiencat e zyrave homologe të PI, si dhe arritjen e kualifikimit profesional dhe rritjen e kapaciteteve njerëzore dhe administrative të DPPM në përputhje me standartet Evropiane. Jemi të bindur se me një organizim të duhur dhe me staf të kualifikuar profesionalisht, do të rrisim nivelin dhe cilësinë e shërbimit, dhe për këtë qëllim e kemi prioritet trajnimin e vazhdueshëm të stafit ekzistues dhe rekrutimet e reja.



VII. BASHKËPUNIME DHE MARRËVESHJE NDËRMJET INSTITUCIONEVE VENDASE

Bashkëpunimi me institucionet e tjera vendase ka për qëllim zhvillimin dhe përmirësimin e sistemit të pronësisë industriale si dhe forcimin e mbrojtjes të të drejtave mbi të në territorin e Republikës së Shqipërisë.

DPPM ka marrë mandatin për të koordinuar axhendën kombëtare për Pronësinë Intelektuale si dhe ka ushtruar funksionin e saj si Sekretariat Teknik i Grupit Ndërinstitucional të punës dhe ka koordinuar punën për hartimin e progres-raporteve të Strategjisë Kombëtare të PI. Hartimi i raporteve të progresit, PKIE, Kapitullit 7 “Pronësia Intelektuale”.

DPPM në rolin e koordinatorit të kapitullit 7 “Pronësia Intelektuale”, ka hartuar dhe ka koordinuar punën ndërmjet institucioneve të përfshira në fushën e Pronësisë Intelektuale, duke grumbulluar dhe përpunuar informacionin e tyre dhe hartimin e progres-raporteve finale, hartimin dhe përditësimin e PKIE-së.

DPPM ka kryer rolin e sekretariatit teknik të hartimit të strategjisë kombëtare, duke koordinuar punën ndërmjet institucioneve dhe grupeve të interesit të përfshira në sistemin e pronësië intelektuale, interesit etj.

Janë nënshkruar:

Marrëveshje me Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Me qëllim zhvillimin e politikave për promovimin e të drejtave të Pronësisë Industriale për rritjen e ndërgjegjësimin të biznesit, për të drejtat që ata gëzojnë në lidhje me markën tregtare dhe të shërbimit, disenjon industriale apo treguesin gjeografik të regjistruar, DPPM ka nënshkruar në 20.11.2014 një marrëveshje bashkëpunimi me QKR i cili është institucioni i vetëm përgjegjës për regjistrimin e biznesit në Shqipëri i krijuar me Ligjin nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar. Pas nënshkrimit të saj DPPM për ta konkretizuar me mirë këtë marrëveshje bashkëpunimi ka nënshkruar në 10.06.2015 një aneks marrëveshje me QKR. Me qëllim realizimin e objektit të kësaj aneks-marrëveshje, palët angazhohen në:

- Trajnimin e punonjësve të QKR-ve në rrethe të ndryshme të vendit;
- Shpërndarjen e materialeve promovuese (postera dhe fletë-palosje) në mjediset e QKR-së , për informimin e bizneseve.

Marrëveshje me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

Me qëllim realizimin e objektit të marrëveshjes së bashkëpunimit me nr. Prot. 339, datë 18.11.2010 për DPPM dhe nr. Prot 16345 datë 18.11.2010 për DPD, për të mundësuar rritjen e nivelit të mbrojtjes së të drejtave të Pronësisë Industriale në Shqipëri, për intesifikimin e bashkëpunimit institucional si dhe për dhënien e asistencës teknike të ndërsjelltë, të dy institucionet vendosën hartimim e një kalendarit të përbashkët trajnimesh në të cilin do të përshihen të gjitha Degët Doganore të Republikës së Shqipërisë si dhe nënshkruan një aneks marrëveshje.



VIII. FINANCA

Të ardhurat financiare janë tregues i performancës së një institucioni. Shifrat shënojnë tregues mjaft pozitivë për DPPM. Aktiviteti i saj është fokusuar jo vetëm në zbatimin e funksionit të saj për regjistrimin dhe administrimin e objekteve të pronësisë industriale, por edhe forcimin e rolit të saj duke nxitur drejt zyrave tona personat dhe shoqëritë tregtare, që të investojnë duke regjistruar pronën e tyre industriale. Ky investim do t'i shërbejë të ardhmes së biznesit të tyre.

Si rezultat i rritjes së numrit të aplikimeve në DPPM, gjatë vitit 2015 të ardhurat e arkëtuara nga aktiviteti kryesor i DPPM-së ishin 81 108 236 lekë duke shënuar rritje me rreth 13 753 576 lekë në krahasim me vitin 2014 dhe 17 463 945 lekë në krahasim me vitin 2013.

Të ardhurat nga Sistemi i Markave për regjistrimin ndërkombëtar të markave të administruara nga DPPM për vitin 2015 janë 529,538.03 Franga Zvicerane (aplikimet bëhen në OBPI me seli në Gjenevë të Zvicrës, dhe administrohen nga DPPM). Të ardhurat që gjenerohen nga DPPM i kalojnë tre deri në katër herë shpenzimet e saj.

Rritje e të ardhurave – Shpenzime të moderuara

I. Fondet e kushtëzuara

1. Buxheti i planifikuar

Paga	12.889.709 lekë
Sigurime shëndetësore dhe shoqërore	2.113.344 lekë
Transferta me jashtë	500.000 lekë
Shpenzime korrente	3.860.000 lekë
Investime pajisje kompjuterike	489.240 lekë

2. Realizimi i Buxhetit

Paga	12.889.709 lekë	100%
Sigurim shëndetësor dhe shoqëror	2.113.344 lekë	100%
Transferta me jashtë	439.636	88%
Shpenzime korrente	3.650.385 lekë	95%
Investime pajisje kompjuterike	489.240 lekë	100%

3. Të ardhurat - Fonde të pakushtëzuara.

Aktiviteti Kryesor

Në bazë të Udhëzimit të Përbashkët Nr. 1041/3 prot, datë 18.02.2015 të MZHETTS dhe Nr. 2388/3, prot, datë 25.02.2015 të MF, Për përcaktimin e drejtimit dhe kriterëve të Përdorimit të të ardhurave që do të përdoren nga Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave “, të ardhurat e realizuara deri në masën 10%, përdoren nga DPPM në dy drejtime kryesore:

Për shpenzime operative

Për investime


Plani i arkëtimit është 81.108.236.49 lekë, kurse 10% për përdorim 8.110.824 lekë

Plani shpenzime 3.218.341 lekë, fakti 3.128.078 lekë realizim 97%

Plani i investimeve 1.948.884 lekë, fakti 1.822.074 lekë realizim 94 %

Total nga të ardhurat realizimi 61 %.

	2013	2014	2015
Të ardhurat	116,253,983.176	138,411,072.00	148,491,373.99
Shpenzimet	19,423,715	19,539,268	24,532,466





IX. TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT, KOMUNIKIMIT DHE SHËRBIMET ELEKTRONIKE

Përmirësimi i shërbimeve elektronike është një aspekt shumë i rëndësishëm në kohët e sotme. Teknologjia njihet një zhvillim të fuqishëm dhe çdokush mund të marrë shumë lehtë informacionin dhe shërbimet në formë elektronike duke ulur koston dhe kohën. DPPM gjatë vitit 2015 ka përmirësuar ndjeshëm regjistrat on-line dhe ka zvogëluar kohën e përditësimit të tyre.

Infrastruktura e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Drejtorinë e Patentave dhe Markave ka patur një përmirësim të ndjeshëm gjatë vitit 2015.

Në Janar 2015 u konfigurua për procedimin e të gjithë vitit 2015, për arsye se sistemi funksionon me procedime vjetore, ku çdo ditë punë e vitit ka veprimet e bëra në këtë ditë.

Janë administruar të drejtat e përdoruesëve në përputhje me profilin e punës si dhe janë zgjidhur problemet e hasura nga këta të fundit gjatë përdorimit të sistemit.

Është administruar dhe mirëmbajtur rrjetit kompjuterik (LAN) dhe është siguruar funksionimi i tij dhe i pajisjeve të instaluar në të. Për të rritur sigurinë e të dhënave u transferuar në mjediset e AKSHI-t të serverave të DPPM.

Gjatë gjithë vitit, stafi teknik i DPPM I ka ardhur në ndihmë të gjithë stafit, në përdorimin e bazës së të dhënave, dhe programeve të ndryshme në funksion të punës.

Sistemi i Administrimit të Pronësisë Industriale (SAPI), një sistem i dhuruar nga WIPO dhe bën të mundur automatizimin e plotë të procedurave të regjistrimit të objekteve të PI, është përditësuar duke instaluar versionet e reja të ofruara nga WIPO, me qëllim pasjen e tij në të njëjtin standard me vendet e tjera të cilat përdorin të njëjtin sistem.

Sigurimi i back-up të përditshëm dhe testimi i funksionimit të tij, ka qënë një nga prioritetet kryesore të DPPM me qëllim sigurimin e ruajtjes së informacionit të plotë dhe të saktë për të bërë të mundur rikthimin e këtyre të dhënave në çdo rast dëmtimi.

Stafi i DPPM-së në bashkëpunim me studentët të zgjedhur në programin kombëtar të praktikës, ka përfunduar klasifikimin e elementëve figurativë të markave sipas klasifikimit ndërkombëtar të Vienës me qëllim rritjen e cilësisë së rezultateve të kërkimit për marka. Kjo do të bëjë të mundur kërkimin në bazën e të dhënave jo vetëm mbi elementet fjalë të markave por edhe mbi elementët figurative të tyre. Gjithashtu, ka nisur saktësimin e të dhënave të importuara automatikisht në sistem nga markat ndërkombëtare. Theksojmë se këto të dhëna nuk ishin të sakta që prej antarësimit të Shqipërisë në Sistemin e Madridit për Regjistrimin Ndërkombëtar të Markave.

DPPM ka përfunduar skanimin e arkivës së patentave dhe ka nisur skanimi i arkivës së markave tregtare, disenjove industriale dhe treguesve gjeografikë.

Këto dy aktivitete plotësojnë dixhitalizimin e arkivave dhe regjistrave të administruara nga DPPM.

Në vitin 2015 DPPM ka publikuar 15 Buletine të Pronësisë Industriale, 10 prej të cilëve për patentat dhe modelet e përdorimit dhe 5 për markat tregtare, disenjot industriale dhe treguesit gjeografikë, konkretisht si më poshtë:

- Buletini i Pronësisë Industriale
(Patenta) 1/2015/ Dt. 13 Mars 2015
- Buletini i Pronësisë Industriale
(Patenta) 2/2015/ Dt. 01 Prill 2015
- Buletini i Pronësisë Industriale
(Patenta) 3/2015/ Dt. 04 Maj 2015
- Buletini i Pronësisë Industriale
(Patenta) 4/2015/ Dt. 01 Qershor 2015
- Buletini i Pronësisë Industriale
(Patenta) 5/2015/ Dt. 01 Korrik 2015
- Buletini i Pronësisë Industriale
(Patenta) 6/2015/ Dt. 03 Gusht 2015
- Buletini i Pronësisë Industriale
(Patenta) 7/2015/Dt. 01 Shtator 2015
- Buletini i Pronësisë Industriale
(Patenta) 8/2015/Dt. 01 Tetor 2015
- Buletini i Pronësisë Industriale
(Patenta) 9/2015/Dt. 02 Nëntor 2015
- Buletini i Pronësisë Industriale
(Patenta) 10/2015/ Dt.01 Dhjetor 2015
- Buletini i Pronësisë Industriale
(Marka) Nr.1/2015/Dt.19.03.2015
- Buletini i Pronësisë Industriale
(Marka) Nr.2/2015/Dt.04.05.2015
- Buletini i Pronësisë Industriale
(Marka) Nr.3/2015/Dt.01.07.2015
- Buletini i Pronësisë Industriale
(Marka) Nr.4/2015/Dt.01.09.2015
- Buletini i Pronësisë Industriale
(Marka) Nr.5/2015/Dt.02.11.2015

Informacioni elektronik është menaxhuar në mënyrë efektive, duke e konsideruar atë si një aset shumë të rëndësishëm në funksion të zbatimit të aktivitetit të DPPM.

Çdo aplikim dhe dokument i depozituar në DPPM, është pranuar në sistemin SAPI duke siguruar që këto të dhëna të jenë në formë elektronike. Gjithashtu, të gjitha veprimet e kryera nga DPPM janë të ruajtura në këtë sistem duke bërë të mundur gjithashtu ruajtjen e historikut të aplikimeve.

Janë importuar në IPAS të gjitha të dhënat për markat nga Marrëveshja dhe Protokoli i Madridit për regjistrimin ndërkombëtar të markave. Vlen të theksohet se këtë vit përfundoi skanimi i i arkivës së patentave, e cila bëri të mundur krijimin e dosjes elektronike për të gjitha patentat e aplikuara në DPPM që prej krijimit të saj.

TIK në DPPM është përdorur maksimalisht gjatë vitit 2014 për qëllim promovimin dhe edukimin në fushën e PI në vënd.

Faqja zyrtare e DPPM është mirëmbajtur dhe përditësuar më të dhëna të plota dhe kohë reale me qëllim informimin e institucioneve, grupeve të interesit dhe publikut në lidhje me PI dhe procedurave të regjistrimit. Në axhendë të trajnimeve me universitetet, bizneset dhe dhomat e tregtisë, ka qënë edhe trajnimi i tyre se si ti përfitojnë këto shërbime sa më mirë dhe më shpejt.

Gjatë vitit 2014 janë përgatitur rregullisht të dhëna statistikore në lidhje me aplikimet e depozituara dhe volumin e punës proceduar nga DPPM.

Qëllimi këtyre masave është krijimi i një mjedisi nxitës dhe lehtësues për regjistrimin dhe zbatimin e të drejtave të PI në Shqipëri duke shkurtuar në këtë mënyrë procedurat dhe duke rritur cilësinë e shërbimeve që DPPM ofron.

X. AKTIVITETE TË DPPM

Ndërgjegjësimi i publikut në lidhje me vlerat e pronësisë industriale është çelësi që shpie në rrugën e suksesit. Një njohje më e mirë e të drejtave të pronësisë industriale do të thotë respektim dhe mbrojtje më e mire, duke e bërë atë më dinamike në treg dhe në jetën e përditshme.

Gjatë vitit 2015 DPPM ka organizuar mbi 10 aktivitete me punonjësit e QKR-së në rrethe në kuadër të forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional i cili do t'i shërbejë edhe rritjes së numrit të aplikimeve duke qenë se QKR është porta e parë e hyrjes së biznesit.

Sesione informuese dhe trajnuese janë organizuar me universitetet, bizneset dhe institucionet e përfshira në sistem. Më 22 Prill 2015 në Tiranë, u organizua një konferencë kombëtare ku morën pjesë përfaqësues nga institucione vendase, Delegacion i KE në Shqipëri, Ambasada e SHBA-ve në Shqipëri, biznese vendase, universitete etj.

Janë organizuar 2 trajnime me punonjësit e doganave dhe 1 me punonjësit e zyrës së tatim- taksave. Janë organizuar 6 aktivitete ku janë trajnuar mbi 100 studente, 113 përfaqësues të bizneseve, si dhe 9 doganierë. Në 14 Prill 2015 në bashkëpunim me Policinë e Shtetit kemi marrë pjesë në trajnime me punonjësit e Policisë së Shtetit ku janë trajnuar 36 punonjës.

Një përshkrim konkret i aktiveve të DPPM vijon më poshtë:

NË BERAT

Përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave në vazhdim të fushatës së sensibilizimit të shtrirë në të gjithë territorin e Shqipërisë si dhe mbështetur në Marrëveshjen e bashkëpunimit të nënshkruar me Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit organizuan në datat 19 dhe 20 Shkurt 2015 në qytetin e Beratit dy ditë trajnimi. Ditën e parë trajnimi u zhvillua me punonjësit e QKR-së Berat. Atyre iu prezantuan informacione në lidhje me procedurat e regjistrimit të patentave të shpikjeve dhe markave tregtare dhe të shërbimit.

Ndërsa në ditën e dytë punonjësit e DPPM, informuan bizneset që paraqiteshin pranë QKR-së në lidhje me procedurat e aplikimit, rëndësinë që ka për kompanitë e tyre regjistrimi i një patente dhe/apo markave, si dhe te drejtat që burojnë nga regjistrimi i tyre. Aty u theksua se tarifat për regjistrimin e objekteve janë të ulta. Rregjistrimi i objekteve të Pronësisë Industriale i krijon mundësinë kompanive të mbrohen nga konkurrenca e pandershme, të ndalojnë kompanitë e tjera të përdorin marka të ngjashme apo identike me markën e tyre të regjistruar më parë.

Gjithashtu, përfaqësuesit e DPPM shpërndanë materiale promovuese për bizneset.

NË LUSHNJE

Më datë 26 Shkurt 2015, përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave ndaluan në qytetin e Lushnjes. Ato zhvilluan me punonjësit e QKR-së së këtij qyteti një trajnim mbi rëndësinë dhe mënyrën e aplikimit për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale. Duke qenë se QKR është ndalesa e parë për bizneset, ky informacion do t'u shërbejë atyre që të informojnë biznesin, ku duhet të drejtohen për të regjistruar markat dhe patentat e tyre. Përfaqësuesit e DPPM shpërndanë materiale promovuese për bizneset që paraqiteshin pranë QKR-së.



NË POGRADEDEC

Në vijim të rritjes së ndërgjegjësimit të bizneseve vendase për të regjistruar pronën e tyre industriale, Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave në bashkëpunim me projektin “Mbrojtja e Markave të Produkteve nga Bashkëpunimi Ndërkufitar”, u takuan në datën 20 Mars 2015 me përfaqësues të bizneseve në qytetin e Pogradecit. Tryeza e rrumbullakët me temë “Pronësia Industriale – Rëndësia e saj në zhvillimin e ekonomik”, kishte për qëllim informimin e bizneseve të këtij qyteti, rreth objekteve të Pronësisë Industriale dhe DPPM, si edhe shërbimeve që ofron DPPM dhe procedura për regjistrimin e këtyre objekteve pranë DPPM.



NË TIRANË

Më datë 22 Prill 2015 u organizua Konferenca Kombëtare e Pronësisë Intelektuale me temë; “Mbrotja e Pronësisë Intelektuale ndihmon kulturën, integritetin dhe ekonominë e një Kombi”

Drejtorja e Përgjithshme e Patentave dhe Markave nën kujdesin e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik Turizmit Tregëtisë dhe Sipërmarjes si dhe në bashkëpunim me Zyrën Shqiptare të së Drejtës së Autorit mbledhi në datën 22 Prill 2015, në Tirana International Hotel, në konferencën kombëtare të Pronësisë Intelektuale me moton *“Mbrotja e Pronësisë Intelektuale ndihmon kulturën, integritetin dhe ekonominë e një Kombi”*, përfaqësues të lartë nga institucionet qeveritare, ambasada e SHBA në Shqipëri, delegacioni i BE në Shqipëri, universitete, biznese vendase, shoqëri të artisteve dhe përfaqësues të grupeve të interesit, për të festuar Ditën Botërore të Pronësisë Intelektuale, si edhe për të diskutuar për arritjet dhe sfidat në sistemin e të drejtave të pronësisë intelektuale në Shqipëri.

Në këtë konferencë përshëndetën dhe shprehen qëndrimin e tyre në lidhje me të drejtat e PI:

Z. Ervin Mete, Zv.Ministër i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregëtisë dhe Sipërmarjes,

Z. Henry V. Jardine, Zv. Ambasador i Shteteve të Bashkuara të Amerikës,

Z. Yngve Engstrom, Shef i Operimeve të Delegacionit të Bashkimit European në Shqipëri,

Znj. Elira Kokona, Sekretare e Përgjithshme, Ministrria e Kulturës,

Z. Elvin Lako, Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave

Z. Evien Dako, Drejtor i Zyrës së të Drejtës së Autorit.

“Qeveria Shqiptare dhe veçanërisht Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregëtisë dhe Sipërmarjes është e angazhuar maksimalisht në reforma, të cilat synojnë një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm të vendit dhe në të njëjtën kohë krijimin e kushteve për aderimin e Shqipërisë në BE. Në këtë prizëm, duke qenë të ndërgjegjshëm se ekonomia shqiptare duhet të maksimizojë benefitet, të cilat gjenerohen nga inovacioni e aktiviteti krijues, nga tërheqja e investimeve të huaja e nga krijimi i partneriteteve me kompani të vendeve të zhvilluara, një rëndësi të dorës së parë merr edhe zhvillimi i Pronësisë Intelektuale”- u shpreh Z. Mete, në fjalën e tij përshëndetëse, pasi falenderoi DPPM në iniciativën e marë, për organizimin e kësaj konference.

Ai vijoi, me shprehjen e rëndësisë që MZHTTS i ka dhënë dhe vazhdon ti japë PI në kuadër të forcimit të këtij sistemi në shërbim të shtetasve dhe bizneseve vendase dhe të huaja të cilët operojnë në tregun shqiptar.

Zëvendës ministri Mete shprehu se inspektorati i tregut të brendshëm ka qënë një nga prioritetet e ministrisë dhe theksoi se ky inspektorat është në proces krijimi dhe pritet shumë shpejt të jetë funksional.

Në cilësinë e organizatorit të konferencës Drejtori i Përgjithshëm i DPPM, Z. Elvin Lako, përshëndeti panelin dhe të ftuarit, për interesin dhe rëndësinë që i dhanë kësaj konference.

“Kjo konferencë kombëtare e cila ka moton “Mbrotja e Pronësisë Intelektuale ndihmon kulturën, integritetin dhe ekonominë e një Kombi”, hap siparin e javës së pronësisë intelektuale e cila kulmon më 26 prill si dita ndërkombëtare e pronësisë intelektuale, dhe ka për qëllim rritjen e ndërgjegjësimin të publikut në lidhje me pronësinë intelektuale në Shqipëri.

Kjo konferencë do të pasohet me një sërë aktiviteteve të organizuara nga DPPM si fushata publicitare, trajnime promovuese si një mundësi e mirë për të kujtuar kontributin që Pronësia Intelektuale jep në kërkimin shkencor, në krijimin e një mjedisi konkurrues e të ndershëm në treg, si dhe në zhvillimin dhe mbrojtjen e krijimtarisë kulturore, duke luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendit” – tha Z. Lako, duke shprehur rëndësinë që DPPM i ka dhënë regjistrimit, informimit dhe edukimit të Pronësisë Industriale.

Zv. Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri, Z. Jardine, përshëndeti konferencën duke vlerësuar iniciativën e institucioneve shqiptare për forcimin e sistemit të regjistrimit dhe mbrojtjes së PI në Shqipëri.

“Shtetet e Bashkuara të Amerikës e shohin me interes zhvillimet në sistemin e PI në Shqipëri si edhe ndihmon në përmirësimin e këtij sistemi nëpërmjet programeve të ndryshme në bashkëpunim edhe me dhomën amerikane të tregëtisë” – tha Z. Jardine

Z. Yngve Engstrom, shef i operimeve të Delegacionit të Bashkimit European në Shqipëri, pasi falenderoi dhe përshëndeti iniciativën e organizimit të kësaj konference theksoi se ka shumë sfida dhe punë për t'u bërë nga institucionet shqiptare në rrugën e gjatë dhe të vështirë të antarësimit të Shqipërisë në BE. BE ka mbështetur dhe do vazhdojë të mbështesë institucionet shqiptare dhe pret rezultate në forcimin e këtij sistemi.

Znj. Elira Kokona, Sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Kulturës, pranoi se sfidat e përmendura nga Z. Engstrom janë reale dhe kërkojnë punë serioze.

“Më lejoni të shpreh vullnetin e plotë dhe konsistent të Ministres Kumbaro për t’i dhënë vëmendjen e duhur progresit në këtë fushë, nëpërmjet një kuadri të ri legjislativ, rritjes së vazhdueshme të kapaciteteve njerëzore, shpërndarjen e zyrave rajonale për mbulim në të gjithë territorin e vendit, mbylljen e një kapitulli informaliteti të së shkuarës që nuk mund të kthehet tani më në një rregull sjelljeje dhe hapjen e një etape të re edhe në kuadër të detyrimeve tona me partnerët ndërkombëtarë, për mënyrën e menaxhimit kolektiv, nivelit të zbatimit të ligjit, monitorimit dhe sensibilizimit të opinionit publik, nëpërmjet mekanizmave kontrolluese që na jep ligji etj. ”

Z. Lako prezantoi rolin dhe rëndësinë që DPPM-së në sistemin e Pronësisë Industriale në Shqipëri. Ai theksoi edhe njëherë se PI ka një rol shumë të madh në zhvillimin ekonomik të një vendi dhe konkurrencën e ndershme.

Viti 2014 për DPPM ka shënuar arritje sa i përket, përmirësimit të bazës ligjore dhe cilësisë së ekzaminimit të objekteve të PI, forcimit të bashkëpunimit me institucionet vendase dhe të huaja me qëllim mbrojtjen e të drejtave që rrjedhin nga rregjistrimi, forcimit të kapaciteteve administrative dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve që DPPM ofron, promovimit të PI në të gjithë territorin e Shqipërisë.

“DPPM ka ndërmarë një iniciativë për të reformuar sistemin e PI në Shqipëri, DPPM dhe synon të realizojë në një periudhë afatmesme angazhimet e mëposhtme:

- Hartimin e Strategjisë së re Kombëtare të PI për periudhën 2016-2020.
- Përmirësimin e mëtejshëm të rregjistrimit të objekteve të PI. Për këtë qëllim, DPPM ka në plan të propozojë përmirësimin e ligjit egzistues të PI për sa i përket :
- Përcaktimin e një strukture organizative dhe financiare më elastike; përfshirë këtu edhe ndryshimin e strukturës dhe funksionimit të Bordit të Apelit;
- Hartimin e kriterëve për përcaktimin e markave të mirënjohura dhe të ekspertëve që do të përdoren nga gjykata dhe prokuroria në fushën e PI-së;
- Forcimin e sistemit në lidhje me ekzaminimin dhe zbatimin e të drejtave të Pronësisë Industriale;
- Rregullimi i kompetencave të DPPM –së për ç’rregjistrim të markave si edhe për iniciativa ex-officio;
- Rishikimi i bazës ligjore për përfaqësuesit e autorizuar.
- Ofrimi i shërbimeve elektronike të reja dhe konkretisht aplikimin on line, si edhe integrimin e rregjistrimit on line të DPPM me ato të WIPO, EPO dhe OHIM.
- Forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit me institucionet e përfshira në PI (dogana, prokuroria, tatimet, gjykata, policia e krimit ekonomik etj.)
- Nxitja inovacionit dhe e regjistrimit të shpikjeve vendase nëpërmjet forcimit të bashkëpunimit me universitete, qendra kërkimore dhe biznese.
- Trajnimi aktorëve të përfshirë në sistemin e mbrojtjes së PI.
- Promovimin e PI në të gjithë Shqipërinë duke nxitur regjistrimin e produkteve dhe shërbimeve vendase nëpërmjet rregjistrimit të markave dhe treguesëve gjeografikë. Këtu përfitoj edhe njëherë nga rasti të falenderoj Delegacionin e Bashkimit Evropian në Shqipëri për ndihmën që po jep aktualisht nëpërmjet projektit “Mbrojtja e Markave të Produkteve nga Bashkëpunimi Ndërkufitar”, për qarkun e Dibrës dhe të Korçës, dhe besoj që ky bashkëpunim do të jetë i frytshëm edhe në të ardhmen.” – u shpreh Z. Lako.

Z. Evien Dako, Drejtor i ZSHDA, prezantoi situatën aktuale të të drejtave të autorit në Shqipëri. Ndër të tjera ai theksoi

“ Vazhdimi në mënyrë konstante i përhapjes së informacionit me synim rritjen e ndërgjegjësimit, si dhe mbi të gjitha vullnetit e përgjegjshmërisë nga të gjithë për të zbatuar me përpikmëri ligjin, besojmë do të jenë një garanci më shumë që Shqipëria ta hedhë prapa krahëve problemin e mbrojtjes së të drejtave të Autorit dhe të Drejtave të tjera të lidhura me të, në të nëëjtin nivel me atë të BE-së.”

Konferencën e PI në fund e përshëndetën edhe përfaqësues të grupeve të interesit Znj. Albana Laknori në emër të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, Z. Krenar Loloçi në emër përfaqësuesëve të autorizuar, dhe Z. Elton Deda në emër të artistëve shqiptarë.

Në fjalën e tyre ata vlerësuan punën e institucioneve shtetërore dhe kërkuar këtyre institucioneve të bashkëpunojnë me grupet e interesit më qëllim të vetëm, atë të garantimit të të drejtave që rrjedhin nga regjistrimi i pronës së tyre intelektuale.

Në përfundim, drejtori i përgjithshëm i DPPM, Z. Lako falenderoi të gjithë pjesmarrësit dhe i siguroi ata që sfidat e indentifikuara do të merren me seriozitet dhe se takime të tjera do të vijonin për të diskutuar konkretisht rezultatet në përmirësimin e sistemit të PI, dhe realizimit të detyrimeve të BE me qëllim të vetëm, antarësimin e Shqipërisë në BE.



NË KORÇË

Korçë, 14-15 Maj 2015. Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave në bashkëpunim me Projektin “Mbrotjtja e Markave të Produkteve nga Bashkëpunimi Ndërkufitar” organizuan një Takim me bizneset në qytetin e Korçës me temë “Mbrotjtja e Markave dhe Patentave për Bizneset në Zonat Ndërkufitare”. Ky trajnim organizohet në kuadër të projektit “Mbrotjtja e Markave të Produkteve nga Bashkëpunimi Ndërkufitar”, i cili implementohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave dhe financohet nga Bashkimi Europian.

Znj.Elvida Meçe, Drejtore e Ekzaminimit, Trajnimit dhe Koordinimit pranë DPPM hapi trajnimin, për të vazhduar më pas me Znj. Xheni Rusi, Pedagogë pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti I Ekonomisë dhe Z. Helios Reveli, Analist pranë Zyrës së Kryeministrit, Njësia e Kërkimit dhe Zhvillimit të Politikave.

Znj.Xheni Rusi shpjegoi çfarë janë markat, patentat, treguesit gjeografik, disenjot industriale, shembuj kombëtarë/ndërkombëtarë për suksesin e regjistrimit të tyre. Ndërsa Z.Helios Reveli shpjegoi rolin e institucioneve shtetërore në pronësinë industriale dhe instrumentat e mbrotjtjes së markës, patentës, treguesit gjeografik dhe disenjos industriale. Ekspertet pranë DPPM-së, Znj.Milena Memsuri, Znj.Erjola Hajdari dhe Znj.Rezarta Rajta që shpjeguan në mënyrë të detajuar normat ligjore, procedurat e regjistrimit të patentave dhe markave, të drejtat dhe detyrimet që lindin nga regjistrimi i tyre.



NË ELBASAN

Në zbatim të marrëveshjes me QKR dhe mbështetur në angazhimet e ndërmarra nga DPPM për rritjen e numrit të aplikimeve shqiptare, në datë 30 Prill 2015, përfaqësues të DPPM trajnuan punonjësit e QKR-së dhe bizneset që paraqiteshin pranë saj në qytetin e Elbasanit, në lidhje me procesin e aplikimit për marka, mbi mënyrën e plotësimit të formularëve dhe kërkimin on-line në faqen zyrtare të saj <http://www.dppm.gov.al>.

Gjithashtu, përfaqësuesit e DPPM shpërndanë materiale promovuese për biznesin dhe vendosën postera në ambientet e QKR-së.



NË KRUJË

Në datë 27 Prill 2015, në qytetin e Krujës, përfaqësues të DPPM trajnuan punonjësit e QKR-së dhe bizneset që pasqariteshin pranë saj në lidhje me procesin e aplikimit për marka, mbi mënyrën e plotësimit të formularëve dhe kërkimin on-line në faqen zyrtare të saj <http://www.dppm.gov.al/>. Ato shpërndanë materiale promovuese për biznesin dhe vendosën postera në ambientet e QKR-së.

NË GJIROKASTËR

Në datat 10-13 Maj 2015, përfaqësues të DPPM morën pjesë në panairin e artizanatit “Made in Albania” që u zhvillua në qytetin e Gjirokastrës. Megapanairi i megavlerave mirëpriti rreth 160 sipërmarrës. Panairi i produkteve shqiptare është aktiviteti më i rëndësishëm që zhvillohet rregullisht në Shqipëri.

Panairi i Produkteve Shqiptare ka filluar me datë 10 Maj dhe zgjati deri më 16 Maj 2015, në Qendrën Historike Gjirokastrë, “Odeoni”. Përfaqësuesit e DPPM informuan pjesëmarrësit në panair dhe personat e tjerë të interesuar që paraqiteshin pranë stendës së saj në lidhje me rëndësinë e regjistrimit të logove dhe produkteve të prodhuara prej tyre si tregues gjeografik.

NË TIRANË

DPPM mori pjesë në Forumin Triple Helix

Në 19 Maj 2015, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes me mbështetjen e OECD (Organizata për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik) dhe Komisionit Evropian organizuan Forumin Triple Helix në ambientet e Hotel Tirana. Qëllimi i këtij seminari ishte prezantimi i draft-politikave të inovacionit, në kuadër të projektit Triple Helix. Përfaqësues nga DPPM morën pjesë në këtë forum.

DPPM nëpërmjet këtij bashkëpunimi në kuadër të këtij projekti do të ofrojë mbështetje SME-ve për zhvillimin e ideve të tyre, duke konkluduar në përfundim për regjistrimin e këtyre ideve/shpikjeve si patenta pranë saj. Pjesë e forumit ishte dhe lançimi i konkursit Triple Helix. Ky konkurs përfshin trinomin qeveri-biznes-akademi. Projekte pilote në fakultetet kryesore apo në nivel universiteti, nevojiten për të rritur ndërgjegjësimin ndërmjet kërkuesve mbi rëndësinë e mbrojtjes së shpikjes apo idesë së tyre.



NË PESHKOPI

Më 01/06/2015 DPPM në bashkëpunim me projektin “Mbrojtja Markave të Produkteve nga Bashkëpunimi Ndërkufitar” organizoi takimin prezantues të projektit.

Takimi u hap nga Znj. Elvanda Meçe (Menaxhere e Projektit dhe Drejtore e Ekzaminimit Trajnimit dhe Koordinimit pranë DPPM), e cila bëri një prezantim mbi Markat dhe Patentat, rëndësinë e mbrojtjes së tyre, për të vazhduar më tej me Z.Vilson Duka, i cili prezantoi projektin, qëllimin dhe objektivat, fazat e projektit, çfarë është bërë deri tani dhe çfarë do të bëhet në të ardhmen, rëndësinë e mbrojtjes së markave tregtare dhe treguesve gjeografike të produkteve shqiptare dhe ndikimin e saj të madh në nxitjen e konkurrencës së ndershme dhe në zhvillimin e turizmit. Një prezantim mbi legjislacionin e pronësisë industriale u bë nga Znj.Milena Memsuri, Specialiste në Departamentin Juridik pranë DPPM. Znj. Memsuri dha informacion në lidhje me ligjet Shqiptare dhe ndërkombëtare që mbrojnë markat tregtare.



NË TIRANË

Në datë 29.06.2015 në ambientet e MZHETTS u organizua mbledhja e Grupit Ndërinstitucional të Punës për monitorimin e realizimit të objektivave të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare të PI. Në takim morën pjesë Zv/ministra, përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Kulturës, të Ministrisë së Mbrojtjes, përfaqësues të institucioneve të përfshira në fushën e Pronësisë Industriale si ZSHDA, DPD, DPPSH, AMA. Takimi u drejtua nga Zv/ministrja e MZHETS, Znj. Brunilda PASKALI.

Mbledhja diskutoi progresin e arritur në 6-mujorin e I/2015 në lidhje me zbatimin e objektivave të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare të PI (2010-2015). Në përfundim të takimit u caktuan detyra konkrete për institucionet e përfshira në strategji me qëllim realizimin e të gjitha objektivave brenda vitit 2015.



NË TIRANË

Takim me Shkollën e Magjistraturës

Në datën 03 Qershor 2015, në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve, DPPM dhe ZSHDA organizuan një takim me z. Sokol SADUSHI drejtor i Shkollës së Magjistraturës. Në takim ishin të pranishëm dhe z. Ador Koleka dhe pjesmarrës të tjerë të kësaj Shkolle. Takimi u organizua në kuadër të forcimit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve. Aty u diskutuan çështje me rëndësi si trajnimi i gjyqtarëve dhe studentëve të shkollës së Magjistraturës, përmirësimi dhe shtimi i kurrikulave në lidhje me lëndën e Pronësisë Intelektuale etj.

Shkolla e Magjistraturës ka hartuar prej vitesh botim të veçantë për lëndën e Pronësisë Intelektuale. Ky program është në azhurnim të vazhdueshëm me sjelljen në seancat mësimore të konflikteve gjyqësore në gjykatat tona si dhe bërjen e analizave krahasimore me përvojat ndërkombëtare në këtë fushë, duke i pasuruar këto me jurisprudencën e gjykatave të rëndësishme Evropiane. Shkolla ka zhvilluar dhe zhvillon periodikisht aktivitete trajnuese për gjyqtarët dhe prokurorët.

Aktivitetet e zhvilluara përmbajnë tematika si më poshtë:

- E drejta e autorit, procedurat administrative për mbrojtjen dhe administrimin e të drejtave të autorëve dhe procedurat gjyqësore. Praktika gjyqësore që lidhet konfliktet që burojnë nga shkelja e të drejtave që burojnë nga ligji për të drejtën e autorit.
- Pronësia Industriale, kuadri ligjor, institucionet e përfshira dhe aktivitetet e tyre, praktika e gjykatës në lidhje me konfliktet që burojnë nga shkelja e të drejtave të markave, patentave dhe dizenjove industriale, duke përfshirë juridiksionin e ECJ-së. Legjislacioni për doganat në lidhje me piraterinë e mallrave dhe produkteve.
- Legjislacioni i BE-së në lidhje me pronësinë intelektuale dhe të drejtën e autorit, vendimet e OHIM-it, Gjykatës së Përgjithshme dhe ECJ-së në këtë fushë.

Takim me AMA

Në datën 08 Qershor 2015, 2 (dy) përfaqësues të DPPM u takuan me drejtorin juridik të AMA-s, z. Enkelejd Lamaj. Ky takim u organizua në kuadër të zbatimit të detyrimeve të parashikuara në Strategjinë Kombëtare të PI (2010-2015). Në takim përfaqësuesi i AMA-s u angazhua që do të bashkëpunojë me ZSHDA dhe do të realizojë objektivat e caktuara në Strategjinë Kombëtare të PI (2010-2015).

NË PESHKOPI

Trajnimit "Mbrojtja e Markave dhe Patentave për Bizneset në Zonat Ndërkufitare"

Më 15-16 Shtator 2015, DPPM në bashkëpunim me Projektin "Mbrojtja e Markave të Produkteve nga Bashkëpunimi Ndërkufitar" organizuan Trajnimin "Mbrojtja e Markave dhe Patentave për Bizneset në Zonat Ndërkufitare".

Ky trajnim organizohet në kuadër të projektit "Mbrojtja e Markave të Produkteve nga Bashkëpunimi Ndërkufitar", i cili implementohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave dhe financohet nga Bashkimi Europian.

Z.Vilson Duka, Koordinator i Projektit, hapi trajnimit, për të vazhduar më pas me Znj. Xheni Rusi, *Pedagoge pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë dhe Z. Helios Reveli, Analist pranë Zyrës së Kryeministrit, Njësia e Kërkimit dhe Zhvillimit të Politikave.*

Znj.Xheni Rusi shpjegoi çfarë janë Markat, Patentat, Treguesit Gjeografik, Disenjat Industriale, shembuj kombëtarë/ndërkombëtarë për suksesin e regjistrimit të tyre. Ndërsa Z.Helios Reveli shpjegoi rolin e institucioneve shtetërore në pronësinë industriale dhe instrumentat e mbrojtjes së markës, patentës, treguesit gjeografikë dhe disenjos industriale.

NË TIRANË

Pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave përfunduan praktikën e punës në datën 30 Shtator 2015, 8 studentët e përzgjedhur në kuadrin e Programit Kombëtar të Praktikave të Punës në Administratën Shtetërore dhe Institucionet e tjera Publike.

DPPM u angazhua seriozisht në këtë iniciativë të Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, dhe ka bindjen që kjo praktikë i shërbeu studentëve në zhvillimin e aftësive profesionale si dhe të punës praktike në administratën publike. Praktika 3 mujore përfundoi me sukses dhe praktikantët dhe stafi i DPPM-së bashkëpunuan për të realizuar të gjitha objektivat e marra. Drejtori i Përgjithshëm i DPPM-së, z. Lako në fjalën e tij përshëndetëse falënderoi këta praktikantë duke i uruar suksese të mëtejshme në formimin e tyre profesional si dhe i ftoi ata të bëhen pjesë e procedurave të vazhdueshme përzgjedhëse të Administratës Publike, me qëllim kontributin në forcimin e shtetit.



Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave (DPPM)

Adresa: Bulevardi “Zhan D’Ark”, Prona nr.33, ish “Shtëpia e Ushtarakëve”,
Tirana, Albania

www.dppm.gov.al

E-mail: mailinf@alpto.gov.al

Tel: +335(0)42236288

  Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave

Fund.

Regjistri i realizimeve të prokurimit publik për katër mujin e parë të vitit 2016.
Autoriteti Kontraktor :Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave

Objekti i prokurimit	Fondi Limit (pa TVSH)	Vlera e kontratës (me TVSH)	Lloji i procedurës së prokurimit	Koha e zhvillimit të procedurës	Operatori ekonomik i kontraktuar
Riparimi i pajisjeve kompjuterike	98.000 lekë	98.000 lekë	Prokurim me vlerë të vogël	22.01.2016	Altin Minja
Sherbim i përkthimit të: -Memorandumi i bashkëpunimit ndërmjet DPPM dhe Organizatës Botërore të Pronësive Intelektuale, në kuadër të bashkëpunimit teknik në fushën e Pronësive Industriale nga gjuha angleze në gjuhën shqipe. - Projektligji dhe relacioni shpjegues në kuadër të ndryshimeve të ligjit 9947, datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale” nga gjuha shqipe në gjuhën angleze. - Analiza e Raportit të Monitorimit Janar- Dhjetor	155.400 lekë	155.400 lekë	Prokurim me vlerë të vogël	11.02.2016	Gerta Hasmuça

2015, per Strategjine Kombetare dhe matrices se performances bazuar ne rezultate. - Raporti i Monitorimit te Progresit per Strategjine Kombetare, Janar- Dhjetor 2015 -Minutat e takimit te Grupit Nderinstitucional te punes per drejtimin dhe monitorimin e zbatimit te Strategjise Kombetare per Pronesine Intelektuale dhe Industriale (2010-2015), per periudhen Janar-Dhjetor 2015, nga gjuha shqipe ne gjuhen angleze.					
Blerje e nje bilete avioni me destinacion Tirane-Alikante-Tirane dhe akomodim ne hotel me 3 yje, per pjesemarrjen ne “Takimin nderlidhes per Bashkepunimin Teknik” te organizuar nga Zyra per	140.000 leke	123.015 leke	Prokurim me vlerë të vogël	24.02.2016	Aurel Saraçi

Harmonizimin e Tregut te Brendshem Evropian (Marka dhe Disenjo Industriale), ne Alikante, Spanje					
Blerje 2 bileta avioni me destinacion Tirane-Gjeneve-Tirane dhe akomodim ne hotel me 3 yje, per pjesemarrjen e dy perfaqesuesve te DPPM, ne “Komiteti I Standarteve te WIPO-s”, te organizuar nga Organizata Boterore e Pronesise Intelektuale, ne Gjeneve, Zvicer.	450.000 lekë	381.900 lekë	Prokurim me vlerë të vogël	15.03.2016	ITRAVEL-ALBANIA EXPRESS
Blerje e 1 bilete avioni dhe destinacion Tirane-Alikante-Tirane, akomodim ne hotel me 3 yje, per pjesemarrjen e perfaqesuesve te DPPM“Mbledhjen 15 per Markat Tregtare”, te organizuar nga Zyra e Pronesise Intelektuale e Bashkimit Evropian, Alikante, Spanje.	110.000 lekë	87.987 lekë	Prokurim me vlerë të vogël	06.04.2016	Aurel Saraci

Regjistri i realizimeve të prokurimit publik për vitin 2015.**Autoriteti Kontraktor :Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave**

Objekti i prokurimit	Fondi Limit (pa TVSH)	Vlera e kontratës (me TVSH)	Lloji i procedurës së prokurimit	Koha e zhvillimit të procedurës	Operatori ekonomik i kontraktuar
Blerje bilete avioni dhe rezevim hoteli	100.000 lekë	91.560 lekë	Prokurim me vlerë të vogël	24.03.2015	Albtours “D”
Shërbim përkthimi i analizës së Raportit të monitorimit Korrik-Dhjetor 2014 për Strategjinë Kombëtare dhe matrices së performances bazuar nërezultate,Raporti i Monitorimit të Progresit për Strategjinë Kombëtare Korrik-Dhjetor 2014, minutave te takimit te grupit nderinstitucional te monitorimit te strategjise kombetare te IP dhe Raporti për nënkomitetin e tregut të brendshëm të PI.	79.300 leke	79.300 leke	Prokurim me vlerë të vogël	24.02.2015	Shoqeria “ALBA GLOBAL GROUP”

Vlerësimi i demit të shkaktuar në pajisjet:një UPS HP 5500 dhe një QNAP Turbo NAS për arsye të paqëndrueshmërisë së tensionit të energjisë elektrike në ambientet e DPPM-së	8.000 lekë	9.600 lekë	Prokurim me vlerë të vogël	23.03.2015	Shoqeria “INFOSOFT SYSTEM GROUP”
Pas vlerësimit të demit të një UPS HP 5500 dhe një QNAP Turbo NAS kërkohet riparimi i tyre në mënyrë urgjente, për arsye të rëndësisë në funksionimin e Sreverave dhe Sistemit IPAS të DPPM-së.	46.000 lekë	55.200 lekë	Prokurim me vlerë të vogël	10.04.2015	Shoqeria “INFOSOFT SYSTEM GROUP”
Blerje e një bilete avioni me destinacion Tiranë-San Diego, Kaliforni (SHBA)-Tiranë	250.000 lekë	135.000 lekë	Prokurim me vlerë të vogël	03.04.2015	Albtours “D”
Prodhim i materialeve për konferencën kombëtare të PI më 22 Prill 2015	80.000 lekë	96.000 lekë	Prokurim me vlerë të vogël	13.04.2015	PUBLICITA Shpk
Akomodim në Hotel me 4 yje, San Diego, Kaliforni (SHBA)	200.000 lekë	218.400 lekë	Prokurim me vlerë të vogël	27.04.2015	Albtours “D”
Blerje tonerash për printer	200.000 lekë	136.500 lekë	Prokurim me vlerë të	26.05.2015	Eldi Qafmolla

			vogël		
Blerje Kompjutera Desktop	415.000 lekë	443.760 lekë	Prokurim me vlerë të vogël	10.06.2015	FASTECH
Blerje e një bilete avioni me destinacion Tiranë-Paris-Tiranë dhe akomodim ne hotel me 4yje	130.000 lekë	148.800 lekë	Prokurim me vlerë të vogël	08.06.2015	ALBANIA EXPRESS
Blerja e dy bileta avioni me destinacion Tiranë-Mynih-Tiranë dhe akomodim ne hotel me 4 yje	280.000 lekë	330.000 lekë	Prokurim me vlerë të vogël	16.06.2015	Albtours “D”
Përkthim i Raportit Vjetor 2014 të DPPM në gjuhën angleze dhe përkthim në gjuhën shqipe të Direktivës 99/47	38.460 lekë	32.691 lekë	Prokurim me vlerë të vogël	22.06.2015	Ermal Celi
Blerje bilete avioni me destinacion Tiranë-Romë-Tiranë dhe akomodim për një dhomë në hotel me 3 yje,si dhe blerje 2 bileta avioni me destinacion Tiranë-Gjenevë-Tiranë dhe akomodim për dy dhoma në hotel me 3 yje	650.000 lekë	538.800 lekë	Prokurim me vlerë të vogël	23.06.2015	AMADEUS TRAVEL AND TOURS

Redaktim Korrektim i tekstit në gjuhën shqipe i Raportit Vjetor 2014, Dizajn i Raportit Vjetor si dhe Botim i Raportit Vjetor	90.000 lekë	108.000 lekë	Prokurim me vlerë të vogël	24.07.2015	PUBLICITA Shpk
Botim i raportit vjetor 2014	90.000 lekë	108.000 lekë	Prokurim me vlerë të vogël	31.07.2015	PUBLICITA Shpk
Realizimi i preventivit dhe projektit për rikonstruksionin e zyrave në ambjentet ku DPPM do të ushtrojë aktivitetin	55.000 lekë	66.000 lekë	Prokurim me vlerë të vogël	01.08.2015	Arkonstudio
Rikonstruksioni i ambjenteve të reja ku do të zhvendoset DPPM, në pronën NR.33, me emërtim “Shtëpia e Ushatrakëve”	500.000 lekë	382.800 lekë	Prokurim me vlerë të vogël	04.08.2015	Majlind Lamce
Blerje të rafteve metalike për arkivën e DPPM	422.000 lekë	348.000 lekë	Prokurim me vlerë të vogël	13.08.2015	FRAL-2000

Përkthim e 49.5 faqeve kompjuterike nga gjuha shqipe në gjuhën angleze:- Analiza e Raportit të Monitorimit Janar-Qershor 2015 për Strategjinë Kombëtare dhe matricës së performancës bazuar në rezultate -Raporti i Monitorimit të Progresit për Strategjinë Kombëtrare Janar-Qershor 2015 -Minutat e takimit të Grupit Ndërinstitucional të punës për drejtimin dhe monitorimin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Pronësinë Insuatriale dhe Intelektuale (2010-2015) për periudhën Janar-Qershor 2015	64.350 lekë	54.698 lekë	Prokurim me vlerë të vogël	11.08.2015	Gerta Hasmuca
Transferim i zyrave të DPPM	302.000 lekë	240.000 lekë	Prokurim me vlerë të vogël	26.08.2015	ARKONSTUDIO
1.Vlerësimi i preventivit të cmontimit, instalimit dhe vënien në punë: -sistemit të kamerave të sigurisë -sistemit të akses	40.000 lekë	48.000 lekë	Prokurim me vlerë të vogël	09.09.2015	ALEN- CO sh.p.k

kontrollit -sistemit telefonik të brendshëm për zyrat dhe arkivat e DPPM. 2.Transferim i rack dhe pajisjet të përfshira në të pranë AKSHI-it.					
Përkthim i: 1. Marrëveshjes ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave (DPPM) dhe Zyrës për Harmonizimin e Tregut të Brendshëm (OHIM) 2. Marrëveshjes ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave (DPPM) dhe Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (WIPO)	200.000 lekë	218.400 lekë	Prokurim me vlerë të vogël	27.04.2015	Albtours “D”
	7200 lekë	7200 lekë	Prokurim me vlerë të vogël	16.09.2015	Gerta Hasmuca
Blerje kancelarie për DPPM	99.800 lekë	119.544 lekë	Prokurim me vlerë të vogël	25.09.2015	Eldi Qafmolla
Blerje Printer Laser me ngjyra standart	44.846 lekë	22.680 lekë	Prokurim me vlerë të vogël	1.10.2015	ALBAMEDIA

Cmontimi, instalimi dhe venia ne pune : - sistemit te kamerave te sigurise -sistemit te akses kontrollit - sistemit telefonik te brendshem oer zyrat dhe arkivat e DPPM	650.000 lekë	683.436 lekë	Prokurim me vlerë të vogël	13.10.2015	ADVANCE BUSINESS SOLUTION-ABS
Blerja e dy bileta avioni me destinacion 1.Tiranë- Budapest-Tiranë 2.Mynih-Budapest-Tiranë dhe akomodim per dy dhoma ne hotel me 3 yje	230.000 lekë	244.800 lekë	Prokurim me vlerë të vogël	13.10.2015	Aurel Saraci
Blerja e dy bileta avioni me destinacion Tiranë- Gjenevë-Tiranë dhe akomodim per dy dhoma ne hotel me 3 yje	260.000 lekë	300.000 lekë	Prokurim me vlerë të vogël	15.10.2015	Aurel Saraci
Blerje Printer Laser me ngjyra standart	28.000 lekë	22.800 lekë	Prokurim me vlerë të vogël	06.11.2015	ALBAMEDIA
Blerje tonerash per printerat e DPPM	685.000 lekë	360.000 lekë	Prokurim me vlerë të vogël	20.11.2015	Endrit Uligaj

Blerje dhe montim perde te brendshme per dritaret e DPPM	99.495 lekë	119.394 lekë	Prokurim me vlerë të vogël	27.11.2015	BOLT sh.p.k
Përkthim i: 1. Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave (DPPM) dhe Zyrës për Harmonizimin e Tregut të Brendshëm (OHIM) 2.Memorandumit të bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave (DPPM) dhe Zyrës Serbe të Pronësisë Intelektuale	8.300lekë	8.300lekë	Prokurim me vlerë të vogël	25.11.2015	Gerta Hasmuca
Riparim i printerave të DPPM	194.000 lekë	183.600 lekë	Prokurim me vlerë të vogël	4.12.2015	Endrit Uligaj
Furnizim, montim dhe venia ne pune e panelit elektrik ne mjediset e punes se DPPM	380.000 lekë	387.600 lekë	Prokurim me vlerë të vogël	17.12.2015	ADVANCE BUSINESS SOLUTION- ABS

Blerje tabela sinjalistike, kartolina urimi dhe kartevizita per DPPM	200.000 lekë	222.600 lekë	Prokurim me vlerë të vogël	17.12.2015	PUBLICITA
Blerje materiale/pajisje sanitare per DPPM	99.180 lekë	119.016 lekë	Prokurim me vlerë të vogël	16.12.2015	Majlind Lamce
Blerje 2 skaner Tipi 4	351.964 lekë	297.600 lekë	Prokurim me vlerë të vogël	28.12.2015	JUPITER GROUP
Blerje 3 komputera desktop	307.920 lekë	286.680 lekë	Prokurim me vlerë të vogël	24.12.2015	PC STORE



STRATEGJIA KOMBËTARE E PRONËSISË INTELEKTUALE

2016 - 2020

- PROPOZUAR NGA:** Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes;
Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave;
- PËRGATITUR NGA:** Grupi i punës i ngritur me urdhrin nr.112, datë 26.08.2015, të Kryeministrit, “Për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional të punës për bashkërendimin, hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të dokumentit strategjik për Pronësinë Intelektuale 2016-2020", nën drejtimin e zëvendësministrit të MZHETTS, **Z. Ervin METE**;
- ASISTUAR NGA:** Ekspertët e Organizatës Botërore e Pronësisë Intelektuale;
- NË KONSULTIM ME:** Delegacionin e Komisionit Evropian në Shqipëri;
- PËRSHTATI FORMATIN:** Dokumenti u përshtat në formatin zyrtar të Strategjive nga Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave.

Tiranë, më 31 Mars 2016

Grupi ndërinstitucional i Punës

Nr.	Emri Mbiemri	Institucioni
1	Ervin METE	Kryetar i Grupit Ndërinstitucional të Punës - MZHETTS
2	Elvin LAKO	Kryetar i Sekretariatit Teknik - DPPM
3	Rudina BOLLANO	DPPM
4	Elvanda MEÇE	DPPM
5	Lindita MENERI	DPPM
6	Erjola HAJDARI	DPPM
7	Milena MEMSURI	DPPM
8	Klotilda NEZIRI	MZHETTS
9	Ekflodia LESKAJ	MZHETTS
10	Evien DAKO	MINISTRIA E KULTURËS, DDA
11	Sonila MEKA	MINISTRIA E KULTURËS, DDA
12	Julia ÇELA	DPZHFNH KRYEMINISTRI
13	Edmond AHMETI	MINISTRIA E KULTURËS
14	Iliriana TOPULLI	MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
15	Arba BEKTESHI	MINISTRIA E INTEGRIMIT EUROPIAN
16	Julia HOXHAJ	MINISTRIA E FINANCËS
17	Enkelejda PIPA	DPT
18	Gloria CARKAXHIU	MINISTRIA E DREJTËSISË
19	Arbër HABILI	DPD
20	Rezarta ELTARI	DPD
21	Lutfi MINXHOZI	DPSH
22	Çezar KEÇI	DPSH
23	Sevada GUÇO	AMA
24	Borana MUSTAFARAJ	SHKOLLA E MAGJISTRATURËS
25	Ador KOLEKA	SHKOLLA E MAGJISTRATURËS
26	Astrit DAUTAJ	IZHA
27	Flovia SELMANI	IZHA
28	Vilma TOMÇO	MINISTËR PËR INOVACIONIN DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE
29	Alma TIRANA	MINISTËR PËR INOVACIONIN DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE
30	Geron KAMBERI	AKTI
31	Rajna SPAHO	AKTI

Ekspertët e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale

Nr.	Emri Mbiemri	Institucioni
1	Tamara Nanayakkara	Përgjegjëse e Sektorit të Politikave të Inovacionit, Departamenti i Vendeve të Zhvilluara dhe në Tranzicion, Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale
2	Christian Helmers	Asistent Profesor, Departamenti i Ekonomisë, Santa Clara University,

Lista e përfaqësuesve nga grupet e interesit pjesëmarrës në takimet e organizuara nga DPPM dhe ekspertët e OBPI në misionin e tyre në datat 30 Nëntor- 04 Dhjetor 2015, në Tiranë dhe lista e të ftuarve në Grupin Ndërinstitucional të Punës (GNP).

Nr.	Emri Mbiemri	Institucioni
Të ftuar në GNP		
1	Ledia Muço	Delegacioni i KE në Tiranë
2	Anula Guda	Delegacioni i KE në Tiranë
3	Elisabeta Katiaj	Unioni Sipërmarrësve të Rinj Shqipërisë
Përfaqësues nga grupet e interesit pjesëmarrës në takimet e organizuara nga DPPM dhe ekspertët e OBPI në datat 30 Nëntor- 04 Dhjetor 2015		
1	Majlinda Saraci	Unioni i Dhomave të Tregtisë
2	Ines Muçostepa	Unioni i Dhomave të Tregtisë
3	Edlira Prenga	Dhoma Amerikane e Tregtisë
4	Pëllumb Qoseja	AIDA
5	Blerina Raça	GIZ Albania
6	Zhenihen Zana	GIZ Albania
7	Marjana Shegani	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë
8	Ylli Pulaj	ABCOM , Dhoma Amerikane e Tregtisë
9	Albana Lakonori	Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë
10	Sevada Guço	Autoriteti i Mediave Audiovizive
11	Ilo Bodi	Universiteti Politeknik i Tiranës
12	Artiona Laze	Universiteti Bujqësor i Tiranës
13	Altin Maliqi	Universiteti Luarasi
14	Diturije Ismaili	Universiteti Epoka
15	Ali Omar Topal	Universiteti Epoka
16	Ador Koleka	Shkolla e Magjistraturës
17	Mirlinda Çollaku	AKDIE – Shoqëri e Menaxhimit Kolektiv

18	Erlir Puto	ALBAUTOR- Shoqëri e Menaxhimit Kolektiv
19	Esat Musliu	FMAA - Shoqëri e Menaxhimit Kolektiv
20	Sokol Vladi	Microsoft Corporation
21	Marko Kavçiç	Microsoft Corporation
22	Eriola Çollaku	Tring platform
23	Altin Roshi	Ardeno
24	Elsa Balteza	Beba Cosmetics
25	Brisida Ademi	Birra Korca (Hysenbelliu Group)
26	Majlinda Manushi	DAST
27	Ergest Zika	Kantina Zika
28	Median Qibini/Bishaj	Kantina Zika
29	Sonila Meco	Sheldia
30	Fioralba Trebicka	Përfaqësues i autorizuar
31	Eni Kalo	Përfaqësues i autorizuar
32	Mirela Malka	Përfaqësues i autorizuar
33	Ela Shomo	Përfaqësues i autorizuar
34	Vjollca Shomo	Përfaqësues i autorizuar
35	Sonila Elezi	Përfaqësues i autorizuar

STRATEGJIA KOMBËTARE E PRONËSISË INTELLEKTUALE (2016-2020)		
	PËRMBAJTJA	5
	AKRONIMET	6
	HYRJE	7
KAPITULLI I	SITUATA AKTUALE	9
	<i>Rolet dhe Përgjegjësitë e Institucioneve</i>	10
1.1	<i>Pronësia Industriale - Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave</i>	10
1.2	<i>E drejta e Autorit – Drejtoria për të Drejtën e Autorit</i>	22
1.3	Sistemi i Administrimit Kolektiv	30
1.4	<i>Institucionet Mbështetëse</i>	40
1.4.1	Drejtoria e Policisë së Shtetit	40
1.4.2	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	43
1.4.3	Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut	47
1.4.4	Shkolla e Magjistraturës	48
1.4.5	Autoriteti i Mediave Audiovizive	50
1.4.6	Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Instituti i Zhvillimit të Arsimit	51
1.4.7	Ministria e Drejtësisë	52
1.4.8	Universiteti Politeknik	52
1.4.9	Prokuroria	52
1.4.10	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	53
1.4.11	Autoriteti i Konkurrencës	53
1.4.12	Dhomat e Tregtisë / Unioni i Dhomave të Tregtisë/ Dhoma Amerikane e Tregtisë	54
1.4.13	Agjencia e Kërkimit Teknologjisë së Inovacionit	55
1.4.14	Avokatët dhe Përfaqësuesit e Autorizuar	55
KAPITULLI II	VIZIONI, POLITIKAT DHE QËLLIMET STRATEGJIKE	56
2.1	Vizioni i Strategjisë	56
2.2	Politikat	56
2.3	Qëllimet Strategjike	56
KAPITULLI III	OBJEKTIVAT E POLITIKËS DHE PRODUKTET MADHORE	57
3	Objektivat (2016-2020)	57
KAPITULLI IV	BURIMET FINANCIARE	65
KAPITULLI V	LLOGADHËNIA, MONITORIMI DHE ANALIZA VLERËSUESE	66
	Monitorimi i Strategjisë. Strukturat përkatëse	66
	Treguesit e parashikuar në SKPI (2016-2020)	67
ANEKS I:	PLANI I VEPRIMIT I STRATEGJISË SË PRONËSISË INTELLEKTUALE	74
ANEKS II	TABELA E TREGUESVE/INDIKATORËVE PËR MONITORIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE TË PI	95

AKRONIMET

STRATEGJIA KOMBËTARE E PRONËSISË INTELEKTUALE (2016-2020)

AAK	Agjencitë e Administrimit Kolektiv
AKTI	Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit
AKKSHI ¹	Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit
BE	Bashkimi Evropian
DPPM	Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
DPPI ²	Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale
DPSH	Drejtoria e Policisë së Shtetit
DDA ³	Drejtoria për të Drejtën e Autorit
ECJ	Gjykata Evropiane e Drejtësisë
EPD	Dokumenti i Partneritetit Evropian
FZ	Fletorja Zyrtare
IZHA	Instituti i Zhvillimit të Arsimit
KE	Komisioni Evropian
KEP	Konventa Evropiane e Patentave
AMA	Autoriteti i Mediave Audiovizive
LAN	Rrjet lokal
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MK	Markë Komunitare
MSA	Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit
MIE	Ministria e Integrimit Evropian
NVM	Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme
OEP	Organizata Evropiane e Patentave
PATLIB	Qendrat e Informacionit për Patentat
PI	Pronësia Intelektuale
PKIE	Plani Kombëtar për Integrimin Evropian
RSH	Republika e Shqipërisë
TIK	Teknologjia e informacionit dhe e komunikimit
TRIPS	Aspektet Tregtare të të Drejtave të Pronësisë Intelektuale
OBPI	Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale
SAPI	Sistemi i Administrimit të Pronësisë Industriale
SHM	Shkolla e Magjistraturës
ZPIBE	Zyra e Pronësisë Intelektuale e Bashkimit Evropian
ZEP	Zyra Evropiane e Patentave
ZSHDA	Zyra Shqiptare për të Drejtën e Autorit

¹ AKKSHI është emërtimi i ri i AKTIT pas 30 qershorit 2016.

² DPPI është emërtimi i DPPM pas hyrjes në fuqi të ndryshimit të Ligjit 9947, datë 07.07.2008, 'Për Pronësinë Industriale', i ndryshuar.

³ DDA është emërtimi i ri i ZSHDA.

Pronësia Intelektuale sot është një ndër çështjet e rëndësishme të zhvillimeve të së drejtës, të drejtave të njeriut, të tregtisë, të administratës publike dhe të kriminalitetit. Mbrojtja e të drejtave të Pronësisë Intelektuale nuk përbën më vetëm një çështje të një vendi, por është pjesë përbërëse dhe e pandarë e zhvillimeve rajonale e ndërkombëtare.

Anëtarësimi në Bashkimin Evropian është prioritet i Qeverisë së Republikës së Shqipërisë prej dy dekadash. Vendi paraqiti aplikimin e tij për anëtarësim në vitin 2009 dhe iu dha statusi i vendit kandidat në vitin 2014. Shqipëria është një hap më pranë Bashkimit Evropian, një tjetër gur kilometrik i rëndësishëm në rrugën drejt BE-së. Dhënia e statusit të vendit kandidat është një rrjedhojë logjike e përpjekjeve të Shqipërisë për reforma. Në të njëjtën kohë duhet parë si një nxitje për të vazhduar me reformat ekzistuese dhe ndërmarrjen e reformave të reja, të nevojshme për ta përgatitur Shqipërinë për nisjen më pas të negociatave të anëtarësimit⁴. Hapja e negociatave në kuadër të marrjes të Statusit të vendit kandidat për anëtarësim në BE shtron para vendit një sërë detyrimesh dhe angazhimesh. Qeveria ka miratuar me VKM nr. 330, datë 28 maj 2014, “Për miratimin e udhëzimit për pesë përparësitë e rekomanduara nga Komisioni Evropian, 2013” udhëzuesin për përmbushjen e 5 prioritetëve, konkretisht:

- reforma e administratës publike;
- pavarësia, efikasiteti dhe llogaridhënia e institucioneve të gjyqësorit;
- lufta kundër korrupsionit;
- lufta kundër krimit të organizuar;
- mbrojtja e të drejtave të njeriut.

Në këtë udhëzim të drejtat e PI përfshihen në prioritetin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Duke pasur statusin e vendit kandidat për anëtarësim në BE në vitin 2014, objektivi kryesor i Shqipërisë për momentin është që të fillojë bisedimet e pranimit me BE-në për të arritur anëtarësimin. Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) e nënshkruar me BE-në në vitin 2006, përcakton drejtimin strategjik për vendin dhe objektivat e politikës së saj afatshkurtër dhe afatmesme.

Në 01 shtator të vitit 2010, u miratua me VKM nr. 760, Strategjia Kombëtare për Zbatimin e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale 2010-2015. Pas përfundimit të Strategjisë Kombëtare të PI (2010-2015), disa aktivitete të përfshira në objektivat e saj mbetën të parealizuar. Gjithashtu, mjedisi ku zbatohen të drejtat e Pronësisë Intelektuale duhej zhvilluar më tej; kjo bëri që DPPM nëpërmjet MZHETTS të iniciojë hartimin e një Strategjie të re për Pronësinë Intelektuale 2016-2020.

Kjo Strategji është dokument ndërsektorial, i cili konkretizon një nga përpjekjet e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për vendosjen e dialogut gjithëpërfshirës ndërmjet aktorëve të ndryshëm, për të krijuar kushte të përshtatshme për respektimin dhe mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale. Implementimi i Strategjisë 2016-2020 do të përbëjë një element thelbësor në progresin e mëtejshëm social ekonomik, në rritjen e konkurrencës së ndershme, krijimin e besueshmërisë në treg, dhe integrimin evropian. Dokumenti është hartuar mbi bazën e detyrave të parashikuara dhe të parealizuar në Strategjinë e mëparshme 2010-2015, zbatimin e detyrave të lëna nga Raportet e Progresit të BE-së, përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në Nenin 73 të MSA-së dhe Kapitullin 7 “Pronësia Intelektuale”, si dhe mbi bazën e një analize të detajuar të nevojave dhe problemeve të identifikuar në praktikë nga institucionet e përfshira në sistem gjatë kësaj periudhe.

⁴ Fjalimi i Stefan Fule “Statusi i vendit kandidat në BE për Shqipërinë (24/06/2014)”

Ajo në mënyrë specifike synon nxitjen e ekonomisë shqiptare drejt një ekonomie inovative të bazuar në dije. Pjesë përbërëse e kësaj strategjie janë sigurimi i të drejtave të Pronësisë Intelektuale, mirëfunksionimi i sistemit gjyqësor, si dhe modernizimi i institucioneve të përfshira në sistem. Strategjia sugjeron që sistemi i PI duhet të inkurajojë transferimin e teknologjisë përmes tregut të transferimit të teknologjisë, në veçanti me shitjen dhe blerjen e teknologjisë së mbrojtur me patentë. Ajo gjithashtu i jep prioritet fushatave të ndërgjegjësimit në publik mbi rëndësinë e PI.

Disa nga objektivat e parashikuara në këtë strategji janë pjesë e dokumentit Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020. Duke qenë se Pronësia Intelektuale është një fushë shumë e gjerë dhe përfshin institucione që i takojnë sektorëve të ndryshëm, ajo nuk mund të ishte pjesë e SKZHI (2015-2020), prandaj u vendos hartimi i një Strategjie të veçantë që i takon kësaj fushe.

Misioni i kësaj strategjie është stimulimi i rritjes ekonomike dhe zhvillimit kulturor dhe shkencor në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet forcimit të ndikimit të sistemit të PI në zhvillimin ekonomik të vendit. Kjo strategji nuk përqendrohet në zbatimin e të drejtave të Pronësisë Intelektuale, si një qëllim në vetvete. Fokusi i saj është përmirësimi i funksionimit të sistemit të Pronësisë Intelektuale me qëllim, nxitjen dhe mbështetjen e inovacionit nëpërmjet nxitjes së punës kërkimore, në veçanti nga kompanitë shqiptare, universitetet vendase dhe individët, për të asistuar ekonominë shqiptare dhe qytetarët në rrugën drejt zhvillimit ekonomik dhe drejt standardeve më të larta. Në mënyrë specifike ajo do të mund të shërbejë si një mjet i politikës për të inkurajuar investimet në kërkim dhe zhvillim, si dhe garanton suksesin në treg.

Kjo Strategji synon rritjen e ndërgjegjësimit, si dhe forcimin e sistemit të regjistrimit, administrimit dhe mbrojtjes së të drejtave që rrjedhin nga Pronësia Intelektuale, si të drejta që ushtrojnë një ndikim të fuqishëm në zhvillimin dhe mirëfunksionimin e ekonomisë. Ajo gjithashtu synon të vendosë një numër objektivash në lidhje me R & D (kërkim dhe zhvillim) dhe forcimin e kërkimit shkencor në sektorin privat dhe publik në vend. Shpërndarja e subvencioneve qeveritare për R & D apo krijimi i fondeve publike për institutet kërkimore shkencore janë politika që synojnë të japin drejtpërdrejt kontribut në risi duke ofruar stimuj për të investuar në punë kërkimore.

Ky dokument është hartuar me kontributin e ekspertëve të grupit ndërinstitucional të punës të ngritur me urdhrin e Kryeministrit nr. 112, datë 26.08.2015 “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për bashkërendimin, hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të dokumentit strategjik për Pronësinë Intelektuale 2016-2020” me asistencë të ekspertëve të Organizatës Botërore për Pronësinë Intelektuale dhe të Komisionit Evropian në Shqipëri.

Dokumenti gjatë hartimit dhe në përfundim të tij është konsultuar dhe me grupet e interesit dhe në hartimin e tij kanë dhënë kontribut mbi 10 institucione.

Raporti i përgatitur nga ekspertët e delegacionit të OBPI-s u hartua mbështetur në analizën e bazës së të dhënave të DPPM, në intervistat e organizuara me institucionet e përfshira në sistem si dhe me grupet e interesit. Në takime morën pjesë 30 institucione dhe grupe interesi, të cilët u përfaqësuan nga 43 përfaqësues.

KAPITULLI I

SITUATA AKTUALE

Komisioni Evropian në kapitullin 7, të raportit të vitit 2015 për Republikën e Shqipërisë është shprehur se:⁵

“Shqipëria ka një nivel përgatitjeje në lidhje me të drejtën e Pronësisë Intelektuale. Në vitin 2015, ka pasur disa përparime. Megjithatë, Shqipëria akoma nuk ka përmbushur detyrimet e saj sipas Nenit 73 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit mbi mbrojtjen e të drejtave të Pronësisë Intelektuale dhe industriale.”.

Detyrat që caktoi Komisioni Evropian në këtë raport ishin:

- Adaptimi i ligjit për të drejtën e autorit sipas standardeve evropiane;
- Përmirësimi i funksionimit të agjencive të administrimit kolektiv dhe pagesës së honorareve ndaj mbajtësve të të drejtave;
- Rritja e ndërgjegjësimit e aktorëve kryesorë, përfshirë edhe gjyqtarët;
- Shtimi i kapaciteteve administrative.

Shqipëria është një vend me traditë afro 100 vjeçare në fushën e Pronësisë Intelektuale. Gjurmët e para datojnë rreth viteve 1920 me regjistrimin e markës "Hobdari". Janë burimet arkivore ato që na mundësojnë të mësojmë se Shqipëria mund të renditet denjësisht krahas vendeve të rajonit e më gjerë si një vend ku marka dhe rëndësia e mbrojtjes së saj nuk i kanë fillesat tani, por qysh në fillimet e shekullit të njëzetë.

Gjithmonë e hapur për harmonizimin e standardeve ndërkombëtare të mbrojtjes së pronës intelektuale, Republika e Shqipërisë ka aderuar në një numër të madh të konventave ndërkombëtare në këtë fushë.

Gjatë viteve të fundit janë ndërmarrë një sërë iniciativash për përmirësimin e bazës ligjore në fushën e Pronësisë Intelektuale të parashikuara në PKIE për periudhën afatshkurtër dhe afatmesme me qëllim zbatimin e MSA, si:

- Harmonizimi i ligjit nr. 9947, datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale” dhe ligjit Nr. 8488, datë 13.05.1999 “Për mbrojtjen e topografisë së produkteve gjysëmpërçuese”, me direktivat e BE-së në fushën e Pronësisë Industriale,
- Miratimi i ligjit nr. 35/2016, datë 31.03.2016 “Për të drejtën e Autorit dhe të drejtat e lidhura me të”,
- Miratimi i VKM nr. 36 datë 20.01.2016 “Për Krijimin, Organizimin dhe Funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut”,
- Miratimi i ligjit nr. 108/2014, datë 31.07.2014 “Për Policinë e Shtetit”,
- Miratimi i ndryshimeve në Ligjin nr. 135/2015, datë 05.12.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,
- Miratimi i VKM nr. 1090, datë 28.12.2015 “Për disa ndryshime në VKM nr. 205, datë 13.04.1999 “Për miratimin e dispozitave zbatuese të kodit doganor”, të ndryshuar”.

Strategji të tjera të miratuara si "Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve për vitet 2014-2020", njohin mbrojtjen e të drejtave të Pronësisë Intelektuale si një faktor kyç për përmirësimin e klimës së biznesit, për thithjen e investimeve të huaja, zhvillimin e biznesit inovativ dhe përmirësimin

⁵ http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_report_albania.pdf

e konkurrueshmërisë së NVM-ve nëpërmjet inovacionit, por nuk kanë të parashikuar ndonjë politikë specifike rreth Pronësisë Intelektuale apo ndonjë bashkëpunimin konkret me DPPM-në.

ROLET DHE PËRGJEGJËSITË E INSTITUCIONEVE

1.1 PRONËSIA INDUSTRIALE - DPPM

Kuadri ligjor i Republikës së Shqipërisë ofron një mbrojtje të pronësisë industriale gjerësisht të përafruar me Acquis Communautaire, duke përmblusur një prej angazhimeve të nenit 73 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit dhe Kapitullit 7 “E drejta e pronësisë intelektuale”, e PKIE.

Ligji nr. 9947, datë 07/07/2008 “Për pronësinë industriale” ndryshuar me ligjin nr.10/2013, datë 14.02.2013, dhe ligjin nr. 55/ 2014 datë 29/05/2014 solli përmirësime për sa i përket përafrimit me direktivat e BE, ngritjes së Inspektoratit të Mbikëqyrjes së Tregut, duke bërë rregullimet e nevojshme për implementimin e marrëveshjeve në fushën e patentave, si dhe duke saktësuar dhe reflektuar problemet dhe gabimet e identifikuara gjatë zbatimit të ligjit në praktikë.

Në vijim u ndryshuan aktet nënligjore përkatëse për patentat dhe modelet e përdorimit, ndryshime në tarifat e regjistrimit të patentave, markat tregtare dhe të shërbimit, treguesit gjeografikë dhe disenjot industriale. Gjatë vitit 2015 u miratuan 6 akte nënligjore në zbatim të ligjit nr. 9947, datë 07/07/2008 “Për Pronësinë Industriale” të ndryshuar me ligjin 55/2014 datë 29/05/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9947, datë 07.07.2008 “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar”. Ndryshimet e akteve nënligjore përmirësuan shërbimet, procedurat e regjistrimit dhe përcaktuan lehtësime për aplikimet për patenta kombëtare.

Ligji nr. 66, datë 26. 06. 2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8488, datë 13.5.1999, “Për Mbrojtjen e Topografisë së Produkteve Gjysmëpërçues” e përafroi atë plotësisht me legjislacionin e BE-së.

Ligji nr. 9947 “Për Pronësinë Industriale”, i ndryshuar, edhe pse konsiderohet si i përafruar me *acquis communautaire*, nuk përmblus disa nga rekomandimet e raportit të misionit vlerësues për fushën e të drejtave të PI të Komisionit Evropian të nëntorit 2013⁶, i cili shprehet mbi një sërë çështjesh të rëndësishme të ngritura nga mbajtësit e të drejtave, të tilla si hartimi i kriterëve për markat e mirënjohura, hartimi i kriterëve për ekspertët e PI-së në gjykata, përmirësimi i cilësisë së ekzaminimit, aplikimet online si dhe forcimi i kapaciteteve administrative të drejtorisë.

Për këtë arsye DPPM-ja ka ndërmarrë iniciativën e hartimit të një projektligj për ndryshime të ligjit aktual të pronësisë industriale dhe ka si qëllim përmblusjen e detyrave të lëna në raportet e Komisionit Evropian, përmblusjen e angazhimeve dhe synimeve të Qeverisë Shqiptare të cilat kanë të bëjnë me shkurtimin e afateve dhe rritjen e cilësisë së shërbimit, rregullime dhe saktësime të problemeve të hasura nga zbatimi i ligjit aktual në praktikë, si dhe përshtatjen me eksperiencat dhe praktikat e zyrave homologe ndërkombëtare. Konkretisht, objektivat që synohen të arrihen nëpërmjet këtij projektligji janë:

- Lehtësimi i procedurave të ekzaminimit, si dhe krijimi i një mjedisi ligjor për përmirësimin e shërbimeve elektronike dhe të komunikimit. Krijimi i mundësisë së aplikimit online në funksion të lehtësimit të procedurave.
- Krijimi i bazës ligjore për sigurimin e objekteve të PI-së, si dhe për përdorimin e tyre si kolateral, me qëllim që objektet e PI-së të marrin në treg vlerën që u takon.

⁶ <http://www.integrimi.gov.al/al/dokumenta/dokumente-strategjike/rekomandimet-e-nenkomiteteve-2014&page=1>

- Rregullimi i disa procedurave dhe kompetencave të DPPM, bazuar në praktikën e kombëtare dhe atë ndërkombëtare të zbatimit të ligjit në fushën e PI-së.
- Përcaktimi ligjor i kritereve për markat e mirënjohura.
- Krijimi i bazës ligjore për licencimin e ekspertëve të PI nga DPPM për nevojat e proceseve gjyqësore dhe të hetimit.
- Krijimi i bazës ligjore për krijimin e dhomës së shqyrtimit të kërkesave për pavlefshmëri dhe shfuqizim, si një strukturë e re brenda DPPM-së.
- Përcaktimi i kompetencave *ex officio* të Zyrës për çregjistrim ose fshirjen nga regjistri të objekteve të PI-së të regjistruara në DPPM.
- Rikompozimi i Bordit të Apelit, dhe ndryshimi i kompetencave.
- Rishikimi i kritereve për licencimin e përfaqësuesve të autorizuar.
- Ndryshimi i emërimit dhe strukturës administrative të DPPM-së nga një institucion publik buxhetor në një Agjenci Autonome në bazë të neneve 10 e 20 të Ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore,” me qëllim forcimin e kapaciteteve administrative dhe financiare, si element kryesor i realizimit të misionit të saj.

Shqipëria është anëtare e shumë marrëveshjeve ndërkombëtare të fushës së Pronësisë Industriale. Në vitin 2013, ajo ratifikoi Marrëveshjen e Londrës për Zbatimin e Nenit 65 të Konventës për Patentat Evropiane. Ratifikimi i saj thjeshtoi procedurat e mbrojtjes së patentave Evropiane në Shqipëri.

Megjithatë, edhe pse Shqipëria është anëtare e shumë marrëveshjeve ndërkombëtare të fushës së Pronësisë Industriale, ajo ende nuk ka ratifikuar Marrëveshjen e Vjenës për klasifikimin ndërkombëtar të elementëve figurativë të markave, Marrëveshjen e Lokarnos për klasifikimin ndërkombëtar të disenjove industriale, si dhe Marrëveshjen e Lisbonës dhe Aktin e Gjenevës për Marrëveshjen e Lisbonës në lidhje me treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës (Akti i Gjenevës për Marrëveshjen e Lisbonës, hyn në fuqi në 20 maj 2016) për mbrojtjen ndërkombëtare të treguesve gjeografikë dhe emërtimeve të origjinës.

Në përputhje me detyrimet e TRIPS, janë përmirësuar dispozitat e Kodit Penal për shkeljet e të drejtave të pronësisë industriale me ndryshimet ligjore të Kodit Penal të vitit 2012 (Ligji nr. 144/02.05.2012). Si rrjedhojë e këtyre ndryshimeve kanë hyrë në fuqi dy nene të veçanta (149/a dhe 149/b) të cilat i hapën rrugën Policisë së Shtetit (Drejtorisë për Krimin Ekonomik e Financiar) në kryerjen e veprimeve procedurale kryesisht, në goditjen e aktivitetit kriminal të shkeljes së të drejtave të pronësisë industriale.

DPPM përfaqëson Shqipërinë në Organizatën Evropiane për Patentat dhe Organizatën Botërore për Pronësinë Intelektuale dhe ka nisur procedurat për anëtarësimin në Zyrën e Pronësisë Intelektuale të Bashkimit Evropian.

Në vitin 2015, DPPM nënshkroi dy marrëveshje bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtare dhe dy aneks marrëveshje me institucionet vendase, konkretisht:

- Marrëveshje e bashkëpunimit me ZPIBE, nënshkruar më 27 Korrik 2015. ZPIBE është agjencia e vetme e Bashkimit Evropian, përgjegjëse për regjistrimin e markave dhe disenjove industriale të vlefshme në 28 vendet e Bashkimit Evropian. Kjo marrëveshje vjen në vijim të plotësimit të kushteve për anëtarësimin në Shqipërisë në BE, pas marrjes së statusit kandidat në Qershor 2014, dhe shpreh edhe njëherë gatishmërinë e të dy institucioneve për të forcuar bashkëpunimin ndërmjet tyre, i cili mund të drejtojë në krijimin e një partneriteti strategjik në tregun Evropian për sa i përket mbrojtjes së markave tregtare dhe të shërbimit dhe disenjove industriale. Bashkëpunimi me këtë zyrë në harmonizimin e procedurave të regjistrimit me atë të BE, do të bëjë të mundur

forcimin e kapaciteteve të zyrës, duke arritur të njëjtin standard me zyrat homologe anëtarë të BE me qëllim përmirësimin e sistemit të regjistrimit dhe mbrojtjes së markave dhe disenjove industriale në Republikën e Shqipërisë.

- Marrëveshje e bashkëpunimit me Zyrën Evropiane të Patentave. DPPM nënshkroi në 12 Gusht 2015, marrëveshjen për Planin e Bashkëpunimit dypalësh me ZEP. Plan i afatmesëm përfshin periudhën 2015-2018, dhe është në kuadër të bashkëpunimit me ZEP, anëtare e së cilës Shqipëria është që prej muajit Maj 2010. Aktivitetet e parashikuara në këtë plan do të ndikojnë në forcimin e kapaciteteve administrative të zyrës në rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit për Patentat e Shpikjeve në Shqipëri si dhe do të ndikojnë në forcimin e sistemit të mbrojtjes së Patentave Evropiane në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- Marrëveshje bashkëpunimi teknik DPPM ka nënshkruar edhe me OBPI dhe ZPI për zbatimin e planeve të përbashkëta me qëllim forcimin e sistemit, rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit dhe modernizimin e zyrës.
- Me qëllim forcimin e bashkëpunimit me zyra homologe në rajon dhe më gjerë DPPM ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me zyrën e Kosovës, Turqisë, Serbisë dhe Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë.
- Në Qershor dhe Korrik 2015 u nënshkruan aneks marrëveshje me QKR-në dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për hartimin e një kalendarit të përbashkët për trajnime ku u përfshinë dhe degët në rrethe të QKR-ve dhe pikave doganore. DPPM mori një sërë masash kryesisht në organizimin e takimeve të shumta me biznese si dhe mori pjesë në panairë në të gjithë vendin. Në vijim të marrëveshjes së bashkëpunimit me Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, DPPM gjatë vitit 2015 ka vijuar me trajnimin e stafit të QKR-së në rrethe me qëllim që ata të informojnë bizneset për regjistrimin e pronës së tyre industriale, si edhe ka nisur trajnimin e stafit të doganës në pikat kufitare. Sesione informuese janë organizuar edhe në Universitetin Politeknik të Tiranës, Universitetin e Tiranës dhe Universitetin Fan Noli në Korçë. Në 22 Prill 2015 në Tiranë, u organizua një konferencë kombëtare ku morën pjesë përfaqësues nga institucione vendase, Delegacion i KE në Shqipëri, Ambasada e SHBA-ve në Shqipëri, biznese vendase, universitete etj.

Në funksion të nxitjes së regjistrimit të shpikjeve vendase, në VKM 883, datë 13.05.2009, "Për Miratimin e Tarifave për Regjistrimin e Objekteve të Pronësisë Industriale", i ndryshuar, të miratuar në shkurt të këtij viti, u vendos që për personat me aftësi të kufizuara, pensionistët dhe studentët tarifa e aplikimit dhe e regjistrimit të një patente të bëhej 100 lek. Si pasojë gjatë 10 muajve në vazhdim për herë të parë gjatë funksionimit të kësaj zyre, u aplikuan 2 patenta nga studentë dhe një patentë nga një pensionist.

Në Konventën e Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale Neni 1(3) thuhet:

“Pronësia Industriale duhet kuptuar në sensin e gjerë dhe duhet zbatuar jo vetëm në industri dhe tregti, por dhe në bujqësi, në industrinë nxjerrëse dhe në të gjithë artikujt e prodhuar në mënyrë artizanale apo produktet natyrore”.

Objektet e Pronësisë Industriale që regjistrohen pranë DPPM janë si vijon:

a) Patentat e shpikjeve dhe modelet e përdorimit

Ka tre mënyra për regjistrimin e patentave në Shqipëri:

- Aplikime për patenta që paraqiten drejtpërdrejt në DPPM si një aplikim kombëtar;

- Aplikime për patenta nëpërmjet marrëveshjes bashkëpunimit për patentat PCT;
- Patenta të lëshuara nga ZEP dhe që kërkojnë mbrojtje në Shqipëri.

Pothuajse të gjitha patentat, të cilat janë të vlefshme në Shqipëri janë patenta të grantuara në ZEP dhe janë në fuqi në Shqipëri në bazë të marrëveshjes me ZEP ose në bazë të KEP. Kompanitë vendase, universitetet dhe shpikësit nuk janë aktivë në përdorimin e patentave për shpikje për tre arsye:

- a) Kompanitë vendase dhe universitetet nuk kanë aplikime apo patenta për shpikje të regjistruara në DPPM,
- b) risk i ulët për imitimin e shpikjeve,
- c) nivel i ulët i njohurive në lidhje me sistemin.⁷

Rreth 97.5% e të gjitha patentave të regjistruara në DPPM janë patenta të lëshuara nga ZEP dhe janë shtrirë ose janë bërë të vlefshme në Shqipëri. Kjo do të thotë se gati të gjitha patentat në fuqi në Shqipëri janë dhënë nga ZEP dhe janë pjesë e një familjeje të madhe patentash të cilat janë mbrojtur edhe në vende të tjera anëtare të KEP.

Nga viti 1997 deri në vitin 2015, janë paraqitur vetëm 68 aplikime për patenta drejtpërdrejt në DPPM nga aplikantë shqiptarë, që përbën 1.16% të aplikimeve në total. Kjo tregon përdorimin jashtëzakonisht të ulët të patentave kombëtare, dhe gjithashtu justifikon faktin e mungesës së ekzaminimit në substancë të patentave nga DPPM pasi pjesa më e madhe e tyre vjen e ekzaminuar nga ZEP.

Në listën me 20 të parët, e mbajtësve të të drejtës për patentë në Shqipëri gjatë periudhës 1997-2015 janë kompani shumëkombëshe të huaja farmaceutike dhe kimike. Këto kompani zotërojnë gati 40% të totalit të patentave të regjistruara në Republikën e Shqipërisë. Është e paqartë se në çfarë shkalle shpikjet e patentuara përdoren në vendin tonë.

Aplikimet nga Universitetet dhe institucionet kërkimore përbëjnë pak më shumë se 2% të e aplikimeve për patenta në DPPM. Numri i ulët i aplikimeve për patenta nga universitetet ka mbetur konstant me kalimin e kohës. Universitetet dhe institutet kërkimore të cilat aplikojnë për mbrojtjen e patentave në Shqipëri janë të vendosura kryesisht në vendet e BE dhe SHBA dhe këto aplikime përqendrohen kryesisht në aplikime për patenta farmaceutike dhe kimike. Nuk ka asnjë aplikim për patentë të paraqitur nga një universitet apo institute kërkimore shqiptare.

Ashtu si dhe universitetet edhe shpikësit individuale shqiptare nuk luajnë asnjë rol në sistemin e patentave shqiptare.

Shumica e kompanive të huaja, të cilat i kanë të mbrojtura patentat e tyre në Shqipëri, nuk i kanë të regjistruara markat e tyre në DPPM. Nisur nga ky fakt mund të themi se shpikjet e patentuara nuk përdoren në Shqipëri.

Shumica e patentave mbahen në fuqi për të gjithë afatin ligjor të parashikuar nga ligji (20 vite). Kjo për faktin se shumica e patentave të mbrojtura farmaceutike janë pronë e kompanive të mëdha shumëkombëshe farmaceutike dhe rritja e tarifave të rinovimit të patentave pothuajse është e papërfillshme për këto kompani.

Për sa i takon aplikimeve për modele përdorimi janë vetëm tre aplikime të tilla në DPPM deri në fund të vitit 2015.⁸

Kompanitë vendase, universitetet, dhe shpikësit individuale pothuajse nuk janë prezent në sistemin e mbrojtjes së patentave për shpikje. Arsyet për këtë situatë janë si më poshtë:

- kompanitë dhe universitetet shqiptare nuk gjenerojnë shpikje të patentueshme;


⁷ Raporti i ekspertëve të OBPI.

⁸ Baza e të dhënave DPPM

- patentat shqiptare kanë nivel të ulët përdorimi nga kompanitë, universitetet dhe shpikësit për shkak të rrezikut të ulët të perceptuar të imitimit, si dhe mungesës së një tregu aktiv për teknologjitë ku shpikjet e patentuara mund të liçencohen apo të shiten;
- niveli i ulët i ndërgjegjësimit në universitete dhe kompani për sistemin e mbrojtjes së patentave për shpikje.

Në vitin 2015 në DPPM janë depozituar 534 aplikime për patenta në krahasim me 423 aplikime të depozituara gjatë vitit 2014, pra kemi një rritje prej 22.8 % të numrit të aplikimeve për patenta. Nga këto 2 aplikime për patenta vijnë nga Traktati i Bashkëpunimit në fushën e patentave, 17 aplikime për patenta janë aplikime kombëtare me aplikantë nënshtetas Shqiptarë, dhe 515 aplikime për patenta, janë patenta të lëshuara nga Zyra Evropiane e Patentave të cilat kërkojnë mbrojtje në Shqipëri. Tabela dhe grafiku i mëposhtëm tregojnë numrin e aplikimeve për patenta në pesë vitet e fundit.


	Aplikime për patenta kombëtare	EP	PCT	Total
2010	2	338	1	341
2011	5	342	6	353
2012	5	342	4	351
2013	4	340	4	348
2014	12	409	2	423
2015	17	520	2	539
Total	45	2291	19	2355



Patenta të regjistruara nga DPPM në periudhën 2010-2015

Viti	Numri i patentave të dhëna
2010	340
2011	439
2012	352
2013	414
2014	392
2015	478
Totali	2415

Vlen për t'u përmendur së gjatë këtij viti është rritur ndjeshëm numri i aplikimeve për patenta kombëtare nga 12 në 17, e përkthyer në 41.7% më shumë. Nga këto 2 aplikime janë studentë dhe një nga pensionist.



b) Markat tregtare dhe të Shërbimit


Ka dy mënyra për regjistrimin e markave në Shqipëri:

- Aplikimet për marka që paraqiten drejtpërdrejt në DPPM-së si një aplikim kombëtar.
- Aplikime ndërkombëtare për marka nëpërmjet sistemit të Madridit.


Në vitin 2015, ka pasur 937 aplikime për marka. Pjesa e markave tregtare të aplikuara nga aplikantë shqiptarë direkt në DPPM është rritur dukshëm.

Tabela dhe grafiku i mëposhtëm tregon numrin e kërkesave nga aplikantë shqiptarë, numrin e kërkesave nga aplikantë të huaj dhe numrin e kërkesave për regjistrim nga Marrëveshja dhe Protokolli i Madridit në 5 vitet e fundit.

	Aplikime Shqiptare	Aplikime në rrugë Kombëtare nga aplikantë të huaj	Aplikime nga Marrëveshja dhe Protokolli i Madridit	Total
2010	238	372	2897	3507
2011	257	463	2776	3496
2012	276	410	2697	3383
2013	377	398	2507	3282
2014	420	485	2414	3319
2015	509	428	2555	3492
Total	2077	2556	15846	20479



Viti	Numri i markave të regjistruara
2010	590
2011	567
2012	721
2013	563
2014	498
2015	763
Totali	3702



Edhe pse një pjesë e madhe e aplikimeve për marka vjen nga BE dhe SHBA ka edhe një numër të madh aplikimesh për marka nga vendet e tjera të rajonit, mbi të gjitha nga Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Serbia.


Megjithatë, në listën me 20 të parët e mbajtësve të të drejtës për markë në Shqipëri për periudhën 1995-2015 është vetëm një kompani Maqedonase. Shumica e kompanive të tjera në këtë listë janë kompani shumëkombëshe të njohura në Amerikë dhe Evropë. Vetëm një kompani në listën e 20 mbajtësve të më shumë patentave është gjithashtu në mesin e listës së 20 mbajtësve të më shumë markave.

Aplikimet për marka janë më pak të përqendruara se aplikimet për patenta. Kështu kompanitë e top listës me 20 mbajtësit e të drejtës për markë kanë vetëm 17% të aplikimeve për marka në total nga 40% që zotërojnë kompanitë e top listës me 20 mbajtësve të të drejtës për patentë.

Ka një mungesë të dukshme të aplikimeve për markë nga universitetet në Republikën e Shqipërisë. Përjashtime bëjnë Universiteti i Biznesit të Tiranës dhe Universiteti Ismail Qemali në Vlorë. Kjo tregon mungesën e strategjive mes universiteteve shqiptare.

Markat tregtare përdoren gjerësisht në të gjithë aktivitetet ekonomike. Pjesa më e madhe e markave janë për produkte farmaceutike/kozmetikë dhe produkte bujqësore dhe ushqim/pije.

Vetëm rreth 20% e markave tregtare mbulojnë shërbime, e cila qëndron në kontrast me faktin se pjesa më e madhe e PBB-së është gjeneruar nga shërbimet dhe jo nga mallrat. Këtë krahasim e tregon edhe grafiku i mëposhtëm.



Shumë pak kompani të cilat kanë pronare të patentave në Shqipëri janë mbajtëse të së drejtave për markat e regjistruara. Ky fakt hedh dyshime mbi pjesën e patentave të shpikjeve (kryesisht farmaceutike) që në fakt tregtohen në Shqipëri.⁹

Ka një tendencë nga kompanitë të regjistrojnë si markë vetëm emrin e tyre tregtar dhe jo emrat e produkteve të veçanta që shiten në treg.¹⁰

c) Disenjt industrialë

Ka dy mënyra për regjistrimin e disenjove industriale në Shqipëri:

- Aplikimet për diseno industriale që paraqiten drejtpërdrejt në DPPM si një aplikim kombëtar.
- Aplikime ndërkombëtare për diseno industriale nëpërmjet Marrëveshjes së Hagës.

Në vitin 2014 janë depozituar 14 diseno nga 5 aplikantë, ndërsa në vitin 2015 janë aplikuar vetëm 5 aplikime për diseno nga të cilat 3 janë nga aplikantë shqiptarë.¹¹ Gjatë këtyre viteve kanë aplikuar 28

⁹ Raporti i ekspertëve të OBPI.

¹⁰ Raporti i ekspertëve të OBPI.

¹¹ Baza e të dhënave DPPM.

kompani dhe 2 individë me një total prej 71 depozitimesh. Ka nivel të ulët të njohurive në lidhje rëndësinë e regjistrimit dhe mbrojtjes së disenjove.¹²


Para vitit 2010, të gjitha aplikimet për disenjo janë aplikuar nga jo-rezidentë. Nga viti 2010, pjesa më e madhe e aplikimeve për disenjo janë aplikuar nga subjektet shqiptare.

Top kompanitë pronare të disenjove ofrojnë një gamë shumë të larmishme të produkteve në treg. Nuk ka universitete apo institute kërkimore që kanë aplikuar për regjistrim disenjosh industriale në DPPM.

Shpesh kompanitë që kanë të regjistruara marka kanë aplikime edhe për disenjo industriale duke krijuar mbivendosje të mundshme të të drejtave në përdorimin e njëkohshëm të tyre.

Në të kaluarën, të gjitha depozitimet janë paraqitur nga subjektet e huaja. Megjithatë, që nga viti 2010 shumica e aplikimeve vijnë nga aplikantë shqiptarë.¹³

	Aplikime ne faze kombëtare	Aplikime nga Marrëveshja e Hagës
2010	6	183
2011	17	170
2012	25	171
2013	8	272
2014	15	214
2015	5	191
Totali	76	1201



c) Treguesit gjeografikë, markat certifikuese dhe markat kolektive.

Ka një mënyrë për regjistrimin e treguesve gjeografikë në Shqipëri:

- Aplikime për tregues gjeografikë që paraqiten drejtpërdrejt në DPPM si aplikim kombëtar.


Mbrojtja e treguesve gjeografikë fillon me regjistrimin pranë DPPM-së, me efekt nga data e depozitimit të aplikimit. E drejta për të përdorur treguesin gjeografik të regjistruar mund të rinovohet

¹²Raporti i ekspertëve të OBPI.

¹³ Raporti i ekspertëve të OBPI.

pa kufizim çdo 5 vjet me kërkesë të mbajtësit të së drejtës. Aplikimi bëhet vetëm për një tregues gjeografik dhe për një lloj produkti. Gjatë gjithë viteve janë paraqitur 11 kërkesa për regjistrim të treguesit gjeografik, nga të cilat 2 janë aplikuar në vitin 2015. Tregues gjeografikë të regjistruar janë vetëm 5 nga të cilat 4 janë me aplikantë shqiptarë.¹⁴ Ka nivel të ulët të njohurive në lidhje rëndësinë e regjistrimit dhe mbrojtjes së Treguesve Gjeografikë.

Nr. i aplikimeve	
2010	1
2011	0
2012	0
2013	2
2014	2
2015	2
Totali	7



Vërejmë që numri i treguesve gjeografikë është i papërfillshëm dhe identifikimi dhe regjistrimi i tyre është emergjent.

d) Topografia e produkteve gjysmë përçues

DPPM jep të drejtën dhe mbrojtjen e Topografisë. DPPM jep vendime sipas procedurës administrative për dhënien e së drejtës dhe mbrojtjen e Topografisë. Një topografi mbrohet nëse është origjinale. Në DPPM nuk ka asnjë aplikim për regjistrim të topografisë së produkteve gjysmë përçues.

Numrin më të madh të aplikimeve për regjistrimin e objekteve të PI-së në DPPM e zënë aplikimet për mbrojtjen e patentave Evropiane, dhe aplikimet për regjistrimin e markave. Numri i aplikimeve për patenta kombëtare, modele përdorimi, tregues gjeografikë dhe diseno industriale është i ulët në krahasim me objektet e tjera të pronësisë industriale dhe nuk ka aplikime për topografi të produkteve gjysmë përçues.

Aktualisht DPPM është një institucion publik buxhetor me mjete financiare, logjistike dhe administrative shumë të kufizuara. Kjo formë organizimi e bën DPPM-në jofleksibël në realizimin e

¹⁴ Baza e të dhënave DPPM

misionit të saj, si dhe në përmbushjen e kërkesave të tregut për arritjen e standardeve ndërkombëtare në shërbimet që ofron. DPPM gjeneron të ardhura nga regjistrimi i objekteve të PI-së. Këto të ardhura derdhen 100% në buxhetin e shtetit, nga të cilat një pjesë shumë e vogël përdoret për mbajtjen e sistemit të PI-së në vend. Vlera tjetër e siguruar nga DPPM përdoret në fusha të tjera, duke lënë të paplotësuara nevojat në këtë fushë. Ky problem është kapur dhe trajtuar edhe në raportet dhe vlerësimet e Komisionit Evropian për Shqipërinë, si dhe nga ekspertët e OBPI-s të cilët në raportin e tyre shprehin se: “Një nga kufizimet e tanishme institucionale është mungesa e autonomisë institucionale të DPPM-së. Përfshirja e Zyrës Shqiptare të Drejtave të Autorit në strukturën e DPPM-së mund të jenë të dobishme”.¹⁵

Legjislacioni ynë njih disa forma të organizimit të institucioneve. Në këtë kontekst për institucionet, që plotësojnë tre kriteret ligjore që parashikohen në pikën 2 të nenit 10 të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, mund të organizohen si agjenci autonome. DPPM i plotëson kriteret për kthimin e saj në agjenci autonome sipas këtij ligji.

Arsyetimi i ndryshimit të strukturës administrative të DPPM-së vjen nga fakti se përmbushja e detyrave të DPPM-së dhe detyrat e ekspertëve të saj, nuk kërkojnë mbikëqyrje të vazhdueshme dhe të drejtpërdrejtë politike. Ndryshimi i statusit të DPPM-së do të krijonte kushte të favorshme për forcimin e ekspertëve të DPPM-së dhe infrastrukturës së saj, duke e pajisur DPPM me mjetet më moderne teknike, e cilat janë të nevojshme që ajo të kryejë misionin e vet.

Ndryshimi i formës së organizimit të DPPM do të ndikonte konkretisht në:

- fleksibilitet në marrjen e vendimeve për përmbushjen e detyrave të saj;
- mjete logjistike dhe administrative në përputhje me kërkesat e kohës;
- investimin e të ardhurave që krijohen nga PI në po këtë fushë.

Për shkak se teknologjia përparon dhe organizatat ndërkombëtare janë dinamike për t’u përshtatur këtyre teknologjive në sistemet e tyre, atëherë kërkohet që edhe DPPM-ja të jetë në të njëjtin ritëm me qëllim plotësimin e detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare. Kjo patjetër kërkon investime në infrastrukturë dhe trajnime të specialistëve në DPPM-së dhe institucioneve të tjera të përfshira. Ekspertët e fushës së PI-së janë aktorët themelorë për mbarrëvajtjen dhe fuqizimin e sistemit të PI-së. DPPM duhet të jetë më fleksibël për shtimin e numrit të shërbimeve që ofron si dhe në përmirësimin e cilësisë së tyre.

Si rezultat i rritjes së numrit të aplikimeve, gjatë vitit 2015 të ardhurat e arkëtuara nga aktiviteti kryesor i DPPM-së ishin 81.108.236 lekë duke shënuar rritje me rreth 13.753.576 lekë në krahasim me vitin 2014 dhe 17.463.945 lekë në krahasim me vitin 2013.

Të ardhurat nga sistemi i markave për regjistrimin ndërkombëtar të markave të administruara nga DPPM për vitin 2015 janë 529.538,03 Franga Zvicerane (aplikimet bëhen në OBPI me seli në Gjenevë të Zvicrës, dhe administrohen nga DPPM). Të ardhurat që gjenerohen nga DPPM i kalojnë tre deri në katër herë shpenzimet e saj.

Duke rritur cilësinë e ekzaminimit si dhe nivelin e ndërgjegjësimit të publikut në lidhje me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga regjistrimi i objekteve të PI-së, DPPM do të ndikojë ndjeshëm në përmirësimin e klimës konkurruese, si dhe do të shërbejë si një shtysë për krijimin e një klime inovative në vend. Njëkohësisht do të luajë një rol të rëndësishëm në luftën kundër konkurrencës së padrejtë dhe praktikave të gabuara dhe të deformuara në treg që lidhen me PI.

¹⁵ Raporti i ekspertëve të OBPI faqe 2

Që nga viti 2006, DPPM-ja përdor sistemin e bazës së të dhënave për pronësinë industriale SAPI (Industrial Property Automated System), të instaluar nga OBPI. Zbatimi i SAPI ka përsheptuar përpunimin e aplikimeve dhe ka përmirësuar saktësinë e të dhënave në lidhje me subjektet e pronësisë industriale. Ai mundëson gjithashtu një qarkullim elektronik të të dhënave në mbështetje të botimit të Buletinit në version elektronik në faqen e internetit të DPPM-së. Mundësia e aplikimit online për përmirësimin e shërbimeve elektronike dhe të komunikimit është një sfidë e punës së DPPM. Ofrimi i mundësisë për të aplikuar online do të rriste cilësinë dhe shpejtësinë e shërbimeve të ofruara nga DPPM, si dhe do të ulte e kostot e aplikimit.

Për rritjen e cilësisë dhe shpejtësisë së shërbimeve, DPPM ka ndërmarrë masa si më poshtë

- Ka nisur ekzaminimi i markave ndërkombëtare që vijnë nga sistemi i Madridit. Aktualisht, për mungesë stafi, pjesa më e madhe e këtyre aplikimeve regjistroheshin automatikisht duke mos u ekzaminuar dhe, në shumë raste, kanë krijuar probleme dhe konfuzion në treg. Në vitin 2015, DPPM filloi të ekzaminojë këto marka dhe ka marrë angazhim që në vitin 2016 të bëhet ekzaminim më i plotë për to.
- Hartimi i një udhërrëfyesi për ekzaminimin e markave tregtare dhe të shërbimit (aktualisht nuk ka një udhërrëfyes të tillë, por hartimi i tij dhe vënia në praktikë do të standardizonte procesin e ekzaminimit të markave).
- Shkurtimi i afateve të ekzaminimit, nëpërmjet publikimit më të shpeshtë të buletinit të markave (aktualisht publikohen 6 buletine dhe parashikohet të jenë minimalisht 12, duke shkurtuar 1-2 muaj kohëzgjatjen e ekzaminimit) dhe ekzaminimit më të shpejtë të aplikimeve pas depozitimit të tyre (aktualisht ekzaminohen në muajin e tretë pas aplikimit, parashikohet të ekzaminohet menjëherë).
- Ka përfunduar skanimi i arkivës së patentave dhe ka nisur skanimi i arkivës së markave tregtare, disenjove industriale dhe treguesve gjeografikë.
- Ka nisur saktësimi në sistemin SAPI i të dhënave bibliografike të markave dhe është parashikuar që të përfundojnë në fund të vitit 2016.
- Shtimi i numrit të publikimeve të buletineve të markave.

Qëllimi këtyre masave është krijimi i mjedisi nxitës dhe lehtësues për regjistrimin dhe zbatimin e të drejtave të PI në Shqipëri duke shkurtuar në maksimum procedurat dhe rritur cilësinë e shërbimeve që DPPM ofron.

Masat e marra dhe aktivitetet e shumta të organizuara nga DPPM në funksion të nxitjes dhe ndërgjegjësimi për rëndësinë e regjistrimit të objekteve të PI-së, u konkretizuan me një rritje të aplikimeve shqiptare me 19% në krahasim me vitin 2014, duke shënuar rekord në numrin e aplikimeve në vite. DPPM ka marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin Politeknik të Tiranës në të cilën është hapur edhe një qendër informacioni dhe ku DPPM organizon shpesh aktivitete informuese dhe trajnuese me qëllim informimin dhe nxitjen e studentëve në punë kërkimore. Në funksion të nxitjes së regjistrimit të shpikjeve vendase u vendos që për personat me aftësi të kufizuara, pensionistët dhe studentët tarifa e aplikimit dhe e regjistrimit të një patente të bëhet 100 lek. Si pasojë, gjatë 10 muajve në vazhdim për herë të parë gjatë funksionimit të kësaj zyre, u aplikuan 2 patenta nga studentë dhe një patentë nga një pensionist. DPPM do të vazhdojë punën informuese në universitete si dhe në arsimin parauniversitar si dhe fushatat ndërgjegjëse me bizneset.

Sfidë për të ardhmen mbetet

- *Miratimi i ndryshimeve të ligjit të pronësisë industriale, ka si qëllim përmbushjen e detyrave të lëna në zbatim të rekomandimeve të raportit të vlerësimit të Komisionit Evropian të nëntorit*

2013¹⁶, (hartimi i kriterëve për markat e mirënjohura dhe hartimi i kriterëve për ekspertët e PI-së në Gjykatë, shkurtimi i afateve dhe rritja e cilësisë së shërbimit, si dhe saktësime të problemeve të hasura nga zbatimi i ligjit aktual në praktikë dhe përshtatja me eksperiencat dhe praktikat e zyrave homologe ndërkombëtare).

- *Krijimi i një Akademie për PI-në brenda strukturës së saj, e cila do të bëjë trajnimin e vazhdueshëm të të gjithë aktorëve në sistem, si dhe do të hartojë tekste informuese në këtë fushë.*
- *Forcimi i kapaciteteve administrative*
- *Rritja e ndërgjegjësimit në publik për regjistrimin dhe respektimin e të drejtave të objekteve të PI, trajnimin e palëve të përfshira në sistem, etj.*

1.2 E DREJTA E AUTORIT DHE TË DREJTAT E LIDHURA ME TO

MINISTRIA E KULTURËS/DDA

Ligji i ri për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me to është miratuar nga Parlamenti shqiptar më datë 31 mars 2016, pas një pune gati 2-vjeçare të grupit të punës të ngritur nga Ministria e Kulturës dhe e konsultuar me grupe të ndryshme interesi dhe institucionet përkatëse shtetërore, që janë pjesë e zbatimit të legjislacionit për të drejtën e autorit në Republikën e Shqipërisë.

Ky ligj i ri për të drejtën e autorit së pari, sjell harmonizim, në shkallën më të lartë të mundshme në juridiksionin shqiptar, të legjislacionit për të drejtën e autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të, me *direktivat e Bashkimit Evropian* në këtë fushë, me qëllim garantimin dhe mbrojtjen e respektimit të të drejtave të autorit në të njëjtin nivel, nga pikëpamja juridike, me ato të vendeve të Bashkimit Evropian, detyrim që buron drejtpërsëdrejti nga neni 73 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Ky ligj synon, gjithashtu, një fuqizim, intensifikim dhe diversifikim të masave shtrënguese, kontrolluese dhe monitoruese, si dhe vendosjen e filtrave, kjo është shumë e rëndësishme, për masa më efektive për importuesit, eksportuesit, prodhuesit, përdoruesit apo shfrytëzuesit e veprave kulturore, artistike dhe shkencore. Ligji i ri, në një mënyrë shumë të rishikuar, rrit dhe forcon sistemin garantues të procedurës, duke përforcuar standardin evropian për kategorinë vulnerabel, sepse të tillë vazhdojnë ta konsiderojnë krijuesin dhe i tillë është, sipas të cilit autori që ankohet për shkelje të së drejtës nuk e ka barrën e provës.

Ligji i ri siguron gjithashtu, një mbulim më të gjerë të rasteve që përfshijnë kundravajtje administrative apo penale, si dhe rrit sanksionet shtrënguese. Krahas këtij ligji të ri për të drejtën e autorit, janë bërë edhe të gjitha sugjerimet, ndryshimet dhe propozimet e Ministrisë së Kulturës në Kodin e Procedurës Penale dhe në Kodin Penal, që lidhen drejtpërsëdrejti me figurat e kësaj fushe.

Objekt i këtij ligji janë:

- a) mbrojtja e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to për veprat e natyrës letrare, artistike dhe shkencore;
- b) mbrojtja e të drejtave të lidhura me të drejtat e autorit, në vazhdim të drejtat e lidhura, të tilla si: të drejtat e interpretuesve/ekzekutuesve në lidhje me interpretimet/ekzekutimet e tyre; prodhuesve të regjistrimeve fonografike të tyre; prodhuesve të fiksimeve (regjistrimeve) të para të filmave të tyre; organizatave transmetuese për transmetimet e tyre; botuesve në lidhje me botimet e tyre; prodhuesve të bazës së të dhënave në lidhje me bazën e të dhënave të tyre;
- c) mbrojtja e të drejtave të parashikuara në dispozitat e veçanta për programet kompjuterike dhe veprat audiovizuale të përcaktuara në këtë ligj;

¹⁶ <http://www.integrimi.gov.al/al/dokumenta/dokumente-strategjike/rekomandimet-e-nenkomiteteve-2014&page=1>

- ç) administrimi individual dhe kolektiv i të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura me to;
- d) mbrojtja “*suigeneris*” e të drejtave të krijuesve të bazës së të dhënave;
- dh) mbrojtja e të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura me to në rastet e cenimit të këtyre të drejtave;
- e) mbrojtja e çdo të drejte tjetër të parashikuar për veprat e së drejtës së autorit dhe ato të lidhura me të në këtë ligj.

Qëllimi i këtij ligji është garantimi i mbrojtjes së të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to.

Ligji mbron, mbështet dhe garanton një kategori vulnerabël, që është ajo e krijuesve, e autorëve që, për hir të së vërtetës, asnjëherë nuk kanë përfituar mbrojtjen e merituar dhe njohjen me të drejta të plota të së drejtës së tyre në fushën e pronësisë intelektuale, artistike dhe shkencore. Po qartësojmë në mënyrë të përkufizuar dukshëm për të gjithë aktorët që, në fakt, tagrat e së drejtës së autorit, ndryshe nga sa mund të mendohet në perceptimin kolektiv, i ka vetë autori dhe këto i lindin atij që në momentin e krijimit apo të publikimit të krijimit.

Kjo do të thotë se këtë të drejtë autorit nuk ia jep ligji, ai ia njeh, ia mbron dhe ia garanton dhe kjo është filozofia e këtij ligji, e cila na mundëson që ta përkufizojmë qëllimin e ligjit, që është garantimi i një niveli më të mirë mbrojtjeje për autorët, artistët dhe titullarët e të drejtave të autorit në përgjithësi.

Ky ligj garanton, gjithashtu, një ambient të përshtatshëm për respektimin e këtyre të drejtave, duke siguruar, në mënyrë të plotë, balancën midis të drejtave private të titullarëve të të drejtave dhe interesit publik për informim, sikundër edhe krijimin e një klime të përshtatshme për biznesin.

Veprat letrare, artistike, publike dhe të tjera vepra për mbrojtjen e autorit jepen automatikisht. Megjithatë, ekziston mundësia për të regjistruar material të kopjuar në zyrën shqiptare të drejtave të autorit. Ekziston edhe një kërkesë ekskluzive regjistrimi për ri-caktimin e të drejtave ekonomike të mbrojtura nga të drejtat e autorit. Të drejtat ekonomike të punimeve të mbrojtura nga të drejtat e autorit mbrohen gjatë jetës së autorit plus 70 vjet.¹⁷

Mbrojtja e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të në Shqipëri ushtrohet në përputhje me Instrumentet kombëtarë dhe ndërkombëtarë të mëposhtëm:

- 1) Kushtetuta (neni 58)
- 2) Konventat/ Marrëveshjet/ Traktatet ndërkombëtare ku aderohet RSH-ja;
- 3) Ligji Nr. 35/2016“Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”.

Aktet ligjore dhe nënligjore, të cilat do të miratohen brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, si më poshtë:

- 4) Procedurat e regjistrimit, organizimi, klasifikimi dhe tarifat e regjistrimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave;
- 5) Lista e pajisjeve, si dhe tarifat përkatëse përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave;
- 6) Procedura dhe mënyra e shpërblimit të drejtë për huadhënien publike, në kuptim të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave;
- 7) Mënyra e funksionimit, shpërblimit dhe e organizimit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave;
- 8) Tarifat e shërbimeve që kryhen nga DDA-ja dhe ministria përgjegjëse për të drejtat e autorit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave;

¹⁷ Raporti i OBPI-s faqe 7- 8.

- 9) Mënyra e hartimit dhe miratimit të kodeve të standardeve e të konformitetit, si dhe e publikimit të tyre përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave;
- 10) Organizimi dhe funksionimi i Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me ligjin për inspektimin;

Ligji i ri konsideron se u jep zgjidhje këtyre prioriteteve:

- Në radhë të parë, zbaton skemat e reja të shpërblimit të së drejtës së autorit, duke shtrirë edhe situatat, duke e zgjeruar fushën e veprimit dhe duke ju dhënë kështu më shumë mundësi përdoruesve, agjencisë dhe autorëve që të gjejnë përgjigje të drejtpërdrejtë edhe për situata, të cilat janë të reja, të krijuara me teknologjitë e reja, në të gjitha fushat e përcjelljes së veprave krijuese.
- Gjithashtu, ky ligj merr përsipër zhvillimet teknologjike dhe shumëllojshmëritë e formave të shfrytëzimit të veprave letrare, artistike apo shkencore në epokën digjitale dhe garanton mekanizmat rregullatorë për të mos lejuar cenimin e titullarëve të së drejtës.
- Garanton dhe ofron sigurinë juridike që ka çdo artist, çdo autor apo çdo titullar tjetër i të drejtave të lidhura me to, të cilat do të përdoren në territorin e Republikës, të shpërblehet për veprën e tij. Aplikon sistemin vullnetar të regjistrimit të së drejtës së autorit, duke garantuar, në këtë formë, parimin e përgjithshëm të Konventës së Bernës që është mbrojtje pa formalitet, e cila nuk dilte qartë në ligjin ekzistues, duke ia dhënë këtë plotfuqishmëri vetëm agjencive.
- Përmirësimi i zbatimit të së drejtës së autorit është evident në secilin nga nenet dhe kapitujt, për të cilët mund të diskutojmë më pas me më teknikalitet.
- Gjithashtu, specifikohet statusi dhe detyra e Drejtorisë për të Drejtat e Autorit, që është një çlirim shumë i madh për vetë punonjësit, të cilët tashmë e dinë se cila është referenca e tyre ligjore, kur shkojnë në përballje apo në komunikim me të tre aktorët që përmenda pak më sipër.
- Përcaktimi i detyrave dhe procedurave administrative ligjore për institucionet shtetërore janë, gjithashtu, një tjetër risi, një përcaktim më i qartë i këtij ligji. Janë një seri instancash administrative dhe ligjore që përfshihen në zinxhirin institucional të zbatimit të legjislacionit për të drejtat e autorit. Duhet thënë se ky aspekt ka qenë shumë i zbehtë, shumë i vakët dhe shumë evaziv, duke lënë gropa për interpretim, për keqinterpretim, pse jo, edhe për abuzim, duke e vështirësuar punën në terren të Zyrës Shqiptare të të Drejtave të Autorit apo të Ministrisë së Kulturës ndër vite, me këtë ligj të ri ky problem merr zgjidhje.
- Gjithashtu, ligji i ri qartëson fushën e veprimit në këtë kuptim dhe rolet e qarta të instancave publike, kryesisht të asaj që në ligj e quajmë **Drejtoria e të Drejtave të Autorit (DDA)**, e cila është një transformim i asaj që ishte Zyra Shqiptare e të Drejtave të Autorit, që do të ketë detyra të përcaktuara qartë.

DDA do të jetë një drejtori e dedikuar politikash dhe me një gamë të gjerë kompetencash në rritje të profesionalizmit, bashkëpunimit më efikas në dhënien e mendimit të specializuar dhe shumë më eficiente në bashkëpunimin e saj me inspektoratin dhe publikun në rastet e cënimit të të drejtave. Kompetenca të reja për mbikëqyrjen e agjencive dhe bashkëpunim me aktorët e tjerë dhe organeve tatimore. Kompetenca hierarkike brenda Ministrisë së Kulturës dhe e orientuar shumë qartë drejt ndërgjegjësimit publik të të drejtave pasurore të krijuesve dhe fushatave të edukimit dhe aktiviteteve të arsimimit publik. Kurrikula e re në 13 gjimnaze do të implementohet në zbatim të ligjit të ri në njohjen

e gjeneratës së re me potencialet e reja në një ekonomi digjitale. DDA me një konceptim të ri më eficient dhe me rezultativ për zbatimin e këtij ligji.

Nga ana tjetër, ky ligj sjell një instancë të re, që futet për herë të parë, **Këshilli Kombëtar i të Drejtave të Autorit (KKDA)**, organ i ri i specializuar për vendosjen e tarifave tëshpërblimit. KKDA do të jetë organ me vendimmarrje që certifikon metodologjinë e tarifave, të cilat do të jenë të kolauduara përçdopërdorues dhe të botuara një kanalet e komunikimit publik. Tarifat do të jenëtransparente, konkurruesepër subjektet, jo arbitrare, çka do të ndikojë nëmënyrë tëdrejtpërdrejtë në formalizimin e tregut. KKDA garanton konkurrencëtë lirë dhekundër abuzimit disa vjeçar. Tarifat do të jenë të shkallëzuara, me procedurë të qartëtëpërcaktuar nëkëtë ligj, gjithëpërfshirëse dhe konturon edhe subjektet përdorues në shoqata përfaqësuesish tëpërdoruesve, sipas nivelit dhe shkallës sëpërdorimit dhe qëllimit dhe shfrytëzimit të produkteve intelektuale. Ligji i ri i jep fund kontestimit të tarifave nga palët dhe ndihmon artistet tëpërfitojnë më shumë. Kjo do të realizohet edhe me bashkëpunimin e shtuar të organeve të tjera shtetërore që kanë rol shtrëngues ndaj informalitetit.

Është pikërisht detyrë e këtij Këshilli që të zhblllokojë situatën dhe të bëjë të mundur komunikimin midis tre aktorëve në fushë, që janë: krijuesi, si autor, që ka edhe të drejtën, Agjencia e Administrimit Kolektiv, që është hallka ndërmjetëse e krijuar për të mbrojtur dhe për të përfaqësuar të drejtat e krijuesit dhe përdoruesit, i cili, në fakt, është ai që nxjerr përfitimin, por ka edhe detyrimin për të bërë shpërblimin e kësaj të drejte.

KKDA-ja dhe DDA-ja (Këshilli Kombëtar i të Drejtës së Autorit dhe Drejtoria e të Drejtave të Autorit), e përforcojnë rolin ndërhyrës në funksion të mbrojtjes së të drejtës së autorit, por edhe në mbrojtje të përdoruesve, gjithashtu. Është shumë e rëndësishme që të shmanget një klimë tashmë e acaruar, që ekziston herë pas here midis të tre aktorëve, të cilët duhet të jenë bashkë dhe ky ligj e krijon këtë terren juridik, por krijon edhe mekanizmat për instancat publike që të jetë një marrëdhënie komunikimi midis të tre aktorëve dhe jo marrëdhënie konfliktuale.

Krahas përpjekjeve që kanë bërë vetë autoritetet në Shqipëri për të punuar në përmirësimin e gjendjes sa i takon respektimit të së drejtës së autorit, vitet e fundit ka pasur mbështetje të veçantë nga BE dhe OBPI me projekte konkrete, e cila ka konsistuar në vizita studimore në zyrat homologe respektive të vendeve të zhvilluara të BE por dhe me workshope dhe seminare mbi të drejtën e autorit, duke trajnuar kështu dhe autoritetet e tjera shtetërore të cilat kanë detyrimet e tyre në përmbushje të misionit të strategjisë kombëtare.

Kjo mbështetje e fut Shqipërinë në rrugën e standardeve që kanë dhe vendet e tjera anëtare të BE, sepse synimi është të sigurojmë përafrimin ligjor me standardet e BE-së dhe me praktikat më të mira përmes transpozimit të duhur të direktivave të BE dhe për të përmirësuar ligjet si të dobishme dhe të përshtatshme në fusha specifike në përputhje me praktikat më të mira evropiane.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstucional dhe zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Zbatimin e të Drejtave të PI-së, ZSHDA do të vijojë detyrat e saj funksionale që i njeh ligji deri në ngritjen e strukturave të tjera të përcaktuara në ligjin e ri për të drejtën e autorit. Për sa më lart ZSHDA ka pasur këtë bashkëpunim si më poshtë:

Është nënshkruar Memorandumi i Përbashkët me Autoritetin e Konkurrencës dhe Zyrës Shqiptare për të Drejtën e Autorit si dhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Më datë 19 Nëntor 2015 midis Zyrës Shqiptare për të Drejtën e Autorit dhe Zyrës Rumune për të Drejtën e Autorit u nënshkrua memorandumi i Bashkëpunimit për të forcuar bashkëpunimin në të ardhmen në fushën respektive të të drejtës së autorit dhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta si

dhe me **16 nëntor 2016** u nënshkrua Memorandumi i bashkëpunimit midis ZSHDA, DPPM dhe Zyrës Serbe të Pronësisë Intelektuale.

ZSHDA ka nënshkruar memorandume bashkëpunimi me Universitetin Luarasi (3 qershor 2015), me Rektoratin e Universitetit të Tiranës (15 qershor 2015), dhe Universitetin "Marin Barleti" (16 korrik 2015).

ZSHDA ka vijuar të bëjë rolin e saj promotor të ndërgjegjësimit dhe të informimit të kategorive të ndryshme të subjekteve/përdorues të produktit artistik dhe jo vetëm, por dhe me të gjitha institucionet shtetërore të cilat janë pjesë e zbatimit të legjislacionit në fuqi. Vëmendje të veçantë i kushtohet monitorimit të tregut të PI si dhe ndërgjegjësimit të subjekteve për detyrimet që u burojnë nga Ligji në fuqi.

Një nga funksionet themelore të ZSHDA ka qenë inspektimi i tregut në raste shkeljesh si dhe monitoron të gjitha agjencitë e administrimit kolektiv në RSH. Me miratimin e Ligjit të Ri për Drejtën e Autorit, pjesa e trupës inspektuese do t'i bashkohet ISHMT dhe ky funksion i ZSHDA nuk do të kryhet më nga stafi ekzistues.



Në lidhje me shërbimet e ndërgjegjësimit në ZSHDA, ky institucion është përpjekur në mënyrë maksimale për të bërë ndërgjegjësimin dhe informimin e publikut dhe të komunitetit në tërësi në lidhje me konceptet e të drejtës së autorit dhe të drejtat e lidhura, dhe jo vetëm në kuadër të strategjisë, por kjo është dhe një nga detyrat kryesore të ZSHDA-së. Është raportuar në mënyrë kronologjike për fushatat dhe tryezat e përbashkëta që janë zhvilluar sa i takon fushës. Këtë funksion do të vijojë ta kryejë dhe DDA.

Një pjesë shumë të rëndësishme të cilën ZSHDA e klasifikon dhe si proces ndërgjegjësimi dhe informimi është monitorimi dhe inspektimi i Tregut të Pronësisë artistike, pjesë e cila është kryer nga inspektorët e ZSHDA.

Për vitin 2015, janë kryer gjithsej dhe janë vendosur 218 masa administrative në kategori të ndryshme subjektesh, përdorues të pronësisë artistike.

Subjekti	Masa Administrative
Televizion Valor+Kabllor	84
Fotokopje	11
Call Center	7
Videoteka	1
Radio	18
Bar, Kafe, Restorant, Hotel	93
Gazeta	3
Subjekti Sig Ship	1

Një krahasim ndër vite në lidhje me inspektimet dhe masat administrative të vendosura është e ilustruar më poshtë në mënyrë grafike:



Aktualisht në nenet 147, 148, 149, 149/a dhe 149/b të Kodit Penal, pasqyrohen veprat penale të Pronësisë Intelktuale (IP Crimes). Sipas Kodit Penal në fuqi, të gjitha veprat penale të Pronësisë Intelktuale janë parashikuar si krime dhe kundërvajtje penale. Ato kanë masa dënimi të lehta dhe fillojnë me gjobë apo me burgim në maksimum deri 1 vjet; deri në 2 vjet dhe deri 4 vjet.

Sipas Kodit të Procedurës Penale të RSH (Neni 59), ai që është dëmtuar nga veprat penale të parashikuara nga nenet 148 dhe 149 të Kodit Penal, ka të drejtë të paraqesë kërkesë në gjykatë dhe të marrë pjesë në gjykim si palë për të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit.

Ligji i ri siguron, gjithashtu, një mbulim më të gjerë të rasteve që përfshijnë kundërvajtje administrative apo penale, si dhe rrit sanksionet shtrënguese. Ministria e Kulturës ka bërë edhe të gjitha sugjerimet, ndryshimet dhe propozimet e saj në Kodin e Procedurës Penale dhe në Kodin Penal, që lidhen drejtpërsëdrejti me figurat e kësaj fushe, në zbatim të Strategjisë Kombëtare të Pronësisë

Intelektuale 2010-2015, por të Strategjisë së Re për zbatimin e të drejtave të PI (2016-2020) , Planit Kombëtar për Integrimin European si dhe Kapitullit 7 “Të Drejtat e Pronësisë Intelektuale”

Qeveria shqiptare ka një sërë detyrimesh të tjera ligjore për të përmbushur në mënyrë që t’i bashkohet BE-së : Dokumenti i Partneritetit Evropian; Marrëveshja e Asociim –Stabilizimit. Këto detyrime kanë çuar dhe vazhdojnë të çojnë drejt një numri të konsiderueshëm ndryshimesh të ligjeve që administrojnë PI në RSH.

Prioritet objektiv mbetet *rritja e ndërgjegjësimit mbi të drejtat e autorit dhe të drejtat e lidhura* me to përmes përdoruesve të veprave të mbrojtura me të drejtë autori, ose të drejtat e lidhura, mbajtësit e të drejtës, përfaqësuesit e tyre dhe komunitetit në përgjithësi.

Ndërgjegjësimi i shoqërisë shqiptare vijon të mbetet në vëmendjen dhe prioritetin e Ministrisë së Kulturës dhe të DDA-së, me qëllim informimin dhe edukimin e gjeneratave që rriten.

Për shumë njerëz, lidhja që ekziston midis pronësisë intelektuale dhe krijimtarisë nuk është aspak e qartë. Fjala krijimtari në vetvete nënkupton një botë artistësh, krijuesish muzikore apo te çdo lloj zhanri tjetër si dhe poetë e artistë.

Mbrojtja e produkteve intelektuale është një sistem i mirë-organizuar, i cili i sjell dobi të madhe çdo shoqërie të çdo vendi, si dhe sjell dobi dhe përfitime në zhvillimet ekonomike, sociale e kulturore te tij.

Respektimi i produktit të mendjes së tjetrit, përdorimi i drejtë i tij dhe jo në mënyrë pirate, por në bazë të ligjeve të cilat veprojnë në një vend të caktuar, është një tregues i qartë i nivelit të civilizimit të një shoqërie.

Misioni i çdo qeverie të çdo vendi të botës është që kultura dhe prodhimtaria intelektuale vendase të zhvillohet, përhapet, promovohet e stimulohet, nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të politikave efikase në funksion të respektimit të mbrojtjes së produktit intelektual.

Në vitin 2000, shtetet anëtare të WIPO-së caktuan 26 prill - dite në të cilën Konventa e WIPO hyri në fuqi në vitin 1970 - si Ditën Botërore të pronësisë Intelektuale me qëllim rritjen e të kuptuarit të përgjithshëm të pronësisë intelektuale.

Që atëherë, Dita Botërore e IP ka ofruar një mundësi unike çdo vit për t’u bashkuar me të tjerët rreth globit për të marrë në konsideratë se si IP kontribuon në lulëzimin e muzikës dhe arteve dhe udhëheq drejt risive teknologjike që ndihmon ti japim formë botës tonë.

Kudo që ne hedhim sytë, ne shohim imazhe të pronësisë intelektuale në veprim. Çdo gjë e jetës sonë të përditshme është e lidhur në mënyrë parësore apo sekondare më të drejtat e pronësisë intelektuale.

Vetëdija e shoqërisë dhe e institucioneve të shtetit për kompleksitetin e rëndësisë që mbartin të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të, në zhvillimet kulturore, sociale, ekonomike e politike të një vendi e shoqërie, mund të thuhet se sot është në rrugë të mbarë në Shqipëri.

Pronësia Intelektuale shqiptare, si pjesë e qenësishme e kulturës dhe e trashëgimisë sonë kombëtare, është dhe do të jetë në fokusin e Qeverisë Shqiptare dhe të Ministrive përkatëse për të përmbushur misionin dhe objektivin e saj, atë të vendosjes së kulturës, në shërbim të mirëqenies, zhvillimit dhe integritetit evropian të Shqipërisë dhe shqiptarëve.

Shumë shtete të Bashkimit Evropian kanë një platformë ku shpjegohet rëndësia jetësore e së drejtës së autorit në ekonominë e një shteti. Qeveri të shumë vendeve të zhvilluara sigurojnë në shkolla paketa të caktuara dhe materiale informative që ato i përdorin për të mësuar nxënës dhe të rinj rreth të drejtës së autorit dhe të mirat dhe përfitimet që burojnë nga kjo e drejtë. Duhet lobuar fuqishëm, që e drejta e autorit të futet në kurrikul, si një lëndë më vete, që në klasat e para të shkollimit. Kjo mbetet një sfidë për Institucionet përgjegjëse.

Edukimi i brezave për kultivimin e shëndetshëm të kësaj kulture do të sjellë vetëm rezultate pozitive në vitet që do të vijnë për shoqërinë shqiptare.

Për vetë specifikën që ka kjo fushë, mbart sigurisht dhe vështirësitë e veta si në të kuptuar e perceptuar nga pjesa më e madhe e opinionit publik, por ZSHDA në qëllimet e saj prioritare ka pasur ndërgjegjësimin dhe kultivimin e kulturës tek brezat që rriten me koncepte të të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura. Një brez i mirë-edukuar me çështjet e pronësisë intelektuale është një mundësi e mirë për të ulur nivelet e piraterisë dhe të kundravajtjeve në një vend të caktuar. Këto janë praktika botërore në vende të zhvilluara që janë treguar mjaft produktive.

Për dy vite me radhë, 2014-2015 ZSHDA ka organizuar dy konkurse kombëtare me sistemin e arsimit para-universitar dhe arsimit universitar, në fushën e të drejtës së autorit. Këto konkurse kombëtare ku janë përfshirë 12 Drejtoritë Rajonale Arsimore dhe Universitetet publike dhe private, në shkallë vendi janë organizuar në kuadër të Ditës Botërore të Pronësisë Intelektuale me temën “Të Mbrojmë dhe të respektojmë të Drejtat e Autorit në RSH”. Pritshmëritë nga këto konkurse kanë qenë maksimale dhe numri i pjesëmarrësve ka qenë i konsiderueshëm. Aktivitete të këtyre përmasave lënë impaktin e tyre në shoqëri, duke përfshirë një numër të madh nxënësish dhe studentësh por dhe stafet akademike.

Në kuadër të ditës Botërore të Pronësisë Intelektuale – 26 prill 2016, Ministria e Kultures dhe Zyra Shqiptare për të Drejtën e Autorit në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë e Përgjithshme të Patentave dhe Markave dhe Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes organizuan Konferencën Kombëtare me sloganin **“Reforma në sistemin e Pronësisë Intelektuale – Sfidë, angazhim për Integrimin Evropian si dhe zhvillimin ekonomik të vendit.**

Pjesë e kësaj konference ishin përfaqësues të institucioneve të larta shtetërore të cilat janë pjesë e zbatimit të të drejtave të pronësisë intelektuale në Republikën e Shqipërisë, përfaqësues të Trupit Diplomatik në Tiranë, sipërmarrja e lirë, autorë, krijues, grupe të caktuara interesi, Institucione të Arsimit të lartë.

Po në kuadër të kësaj dite MK dhe ZSHDA organizuan ngritjen e një stendë në një nga rrugët kryesore të Tiranës, me materiale të ndryshme promocionale, broshura, fletëpalosje të ndryshme me përmbajtje të thjeshtë për sa i takon të drejtës së autorit. Pjesë e kësaj stende ishin dhe përfaqësues të DPPM.

Një spot televiz u realizua, me mbështetjen e AAK-ve, nga autorët më të shquar të vendit të fushave të ndryshme të artit, me qëllim sensibilizimin e shoqërisë. Njoftime në shtyp, intervista të ndryshme u pasqyruan në editoriale të ndryshme.

Postera me sloganin e aktivitetit u vendosën në rrugët kryesore të Tiranës. Të gjitha këto aktivitete u pasqyruan në rrjetet sociale dhe faqet zyrtare të MK dhe të ZSHDA, si dhe u botuan në revistën javore të Ministrisë së Kulturës.

ZSHDA ka bërë pjesë të planit të saj të punës, edukimin e brezave dhe të shoqërisë në tërësi, si një mënyrë efikase për të ndërgjegjësuar të rinjtë. ZSHDA ka vijuar për dy vite radhazi dhënien e leksioneve të hapura në auditorët e Universiteteve të ndryshme, ku pritshmërisë kanë qenë maksimale

si nga ana e studentëve ashtu dhe e stafit akademik. Këto praktika pune do të vijnë dhe në harkun kohor të kësaj strategjie 2016-2020, duke i përfshirë të rinjtë në çështjet e edukimit përmes kulturës dhe artit. Të gjithë e dimë dhe biem dakord se mbrojtja dhe respektimi i të drejtave të autoritmbrobron kulturën, trashëgimi, identitetin dhe integritetin e një kombi.

Aktivitetet të tilla do të ndërmerren nga Ministria e Kulturës dhe nga DDA sipas një grafiku të caktuar, me qilim prezantimin e ligjit të ri për të drejtën e autorit tek subjekte të ndryshme përdoruesish, grupe të ndryshme interesi si dhe institucione të tjera shtetërore. Leksionet në auditore do të jenë pjesë e planit të punës së përditshme të DDA-së, konkurset nëpër shkolla do të kthehen në tradita si një mënyrë edukimi për gjithë shoqërinë shqiptare

Vazhdimi në mënyrë konstante i përhapjes së informacionit me synim rritjen e ndërgjegjësimit, si dhe mbi të gjitha vullnet e përgjegjshmëri nga të gjithë për të zbatuar me përpikmëri ligjin, do të jenë një garanci më shumë që Shqipëria ta kapërcejë problemin e mbrojtjes së të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të, duke arritur në një nivel mbrojtje të njëjtë me atë të BE-së.

Përveç kësaj, zhvillimi i teknologjisë së informacionit dhe internetit ka ndryshuar mënyrat e mësimdhënies, ndërkohë që gjithnjë e më shumë materiale bëhen të disponueshme në mjedisin digjital, me kosto të ulët ose pa kosto fare, dhe shembuj të rinj mësimdhënieje, si të mësuarit nëpërmjet internetit dhe të mësuarit në distancë, bëhen të mundshme dhe të aksesueshme.

Si vendet e zhvilluara, ashtu edhe ata në zhvillim, vlerësojnë rëndësinë e vazhdueshme për të pasur një nivel të lartë disponueshmërie dhe aksesueshmërie të njohurive për qëllime arsimore, meqë kjo ka rëndësi jetësore për mbështetjen dhe zhvillimin social dhe ekonomik të një vendi.

1.3 SISTEMI I ADMINISTRIMIT KOLEKTIV

Agjencia e administrimit kolektiv të të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura, është organizatë jofitimprurëse (OJF), e cila është krijuar mbi bazën e ligjit “Për OJF-të”, por që merr funksionet e një agjencie të administrimit kolektiv vetëm pasi Ministri i Kulturës, është shprehur me Urdhrin e tij për licencimin e saj në bazë të nenit 108, 109 të Ligjit Nr. 9380, datë 28.04.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të” (LDA).

Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale (OBPI) përkufizon administrimin kolektiv si “ushtrimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të, nga organizatat që veprojnë në interes dhe në emër të titullarëve të së drejtës”.

Pra, agjencitë janë përfaqësuese të titullarëve të së drejtës për administrimin e të drejtave të titullarëve kundrejt përdoruesve. Ndaj dhe të drejtat e një agjencie janë ato që burojnë nga tagri i përfaqësimit që titullarët i japin asaj, bazuar në Konventat/Traktatet ndërkombëtare si dhe legjislacionin kombëtar të fushës.

Në Republikën e Shqipërisë operojnë 4 agjenci të administrimit kolektive të të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura, një për çdo degë arti, si më poshtë:

1. Albautor – Agjencia e administrimit kolektiv e të drejtave të autorit;
2. FMAA – Agjencia për Mbrojtjen e Veprave Audiovizuale;
3. AKDIE - Agjencia për mbrojtjen e të drejtave të Interpretuesve dhe Ekzekutuesve;
4. AMP -Agjencia për Mbrojtjen e Producentëve.

Forcimi i sistemit të administrimit kolektiv mbetet një tjetër pikë ku DDA do të bëjë përpjekjet maksimale për të përmirësuar sistemin, me anë të rritjes së besueshmërisë dhe transparencës së AAK kundrejt subjekteve përdorues si dhe shpërblimin e drejtë të titullarët e të drejtës.

Të drejtat e autorit mund të administrohen në mënyrë individuale për çdo vepër të autorit ose sipas parashikimeve të ligjit nr. 35/2016 mund të administrohen në mënyrë kolektive, nëpërmjet agjencive të administrimit kolektiv, për një numër veprash të disa autorëve në të njëjtën kohë.

AAK-të, për llogari të mbajtësve të të drejtave dhe në bazë të kompetencave që u janë dhënë dhe sa parashikohet në ligjin nr 35/2016, kanë këto funksione:

a) t'u japin përdoruesve, në vijim të kërkesave të tyre, kontrata në formën joekskluzive për përdorimin e veprave ose objekteve të të drejtave të lidhura, në këmbim të një shpërblimi, me kontratë të shkruar, brenda tagrave të përcaktuar në licencën e agjencisë;

b) të mbledhin shpërblimin për përdorimin e veprave ose objekteve të të drejtave të lidhura;

c) të shpërndajnë, në bazë të rregullave të shpërndarjes, shpërblimin e mbledhur nga përdoruesit në mënyrë të drejtë dhe të përpjesëtuar me vlerën dhe përdorimin aktual të veprave e të objekteve të të drejtave të lidhura. Parimet e shpërndarjes së shpërblimit përcaktohen në statutin e agjencisë dhe do të përjashtohet çdo mundësi arbitrariteti;

ç) të përfaqësojnë mbajtësit e të drejtave, të drejtat e të cilëve ata administrojnë, në procedurat gjyqësore ose administrative dhe të kryejnë çdo veprim tjetër ligjor të nevojshëm për mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të administruara nga ato;

d) të kryejnë çdo veprim tjetër, në përputhje me tagrat e tyre ligjorë dhe të organeve të veta vendimmarrëse, për kompetencat e marra nga mbajtësit e të drejtave;

dh) të hartojnë metodologji të negociueshme për përcaktimin e nivelit të tarifave që subjektet përdoruese duhet të paguajnë, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

e) të realizojnë në emër të autorit ose të mbajtësit të së drejtës së autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me të ose në bazë të kontratës së reciprocitetit me agjenci të huaja të ngjashme marrëveshjet e përgjithshme me organizatorët e shfaqjeve, me ofruesit e shërbimit 60 mediatik audioviziv, me operatorët e rrjetit numerik, që kanë si objekt autorizimin e shfaqjes dhe shpërndarjes për veprat që administron;

ë) të përfaqësojnë interesat e anëtarëve për shfrytëzimin e të drejtave, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke nënshkruar kontratat e reciprocitetit me agjenci të huaja të ngjashme;

f) të informojnë, sipas kërkesës, mbajtësit e të drejtave të autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me to për mënyrën e shfrytëzimit të të drejtave të tyre, për raportin vjetor financiar dhe atë të kontrollit të të ardhurave financiare, brenda kohës së parashikuar në statut;

g) të sigurojnë transparencën e veprimtarisë së agjencisë së administrimit kolektiv, në lidhje me autoritetet publike të kontrollit, sipas ligjit;

gj) për të ardhurat e mbledhura nga përdoruesit dhe që u paguhet në formë shpërblimi mbajtësve të të drejtave, këto agjenci detyrohen të mbajnë dhe të paguajnë për llogari të administratës tatimore tatimin në burim, në përputhje me legjislacionin në fuqi për tatimin mbi të ardhurat;

h) për efekt të përcaktimit të saktë të detyrimeve tatimore, kanë detyrimin të vënë në dispozicion të administratës tatimore, sipas formateve të miratuara, informacionin mbi të ardhurat e mbledhura nga përdoruesit e veprave të të drejtave të autorit/të lidhura me to, si dhe shpërndarjen e këtyre shpërblimeve të mbajtësit e të drejtave. Agjencitë e administrimit kolektiv administrojnë të drejtat e autorëve vetëm në bazë të një kontrate të lidhur me autorin. Kontrata do të përfshijë, në veçanti, autorizimin e autorit për administrimin e të drejtave të tij, llojin e veprave dhe të drejtave për t'u administruar dhe kohëzgjatjen e kontratës, e cila nuk duhet të kalojë tre vite, e rinovueshme.

Licencimi i një agjencie të administrimit kolektiv akordohet kur subjekti përmbush disa karakteristika si:

- a) regjistrohet si organizatë jofitimprurëse, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi;
- b) ka miratuar statutin e saj, që plotëson kushtet e parashikuara në këtë ligj dhe që duhet të përfshijë në mënyrë specifike: i) emërtimin e agjencisë së administrimit kolektiv, objektivat dhe qëllimet, të drejtat e administruara, kategoritë e mbajtësve të të drejtave që agjencia përfaqëson, kriteret për humbjen ose fitimin e anëtarësisë, të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve, rregullat e zgjedhjes dhe funksionimit të organeve drejtuese, kapitalin e saj fillestar dhe burimet e planifikuara ekonomike, rregullat e përcaktuara për realizimin e mbledhjes dhe shpërndarjes së të ardhurave, mënyrën e mbikëqyrjes së administrimit ekonomiko-financiar të agjencisë, ngritjen e komisionit të posaçëm, në kuptim të nenit 153, pika 6, të këtij ligji, mënyrën e përdorimit të kapitalit ose aseteve të tjera, në rast likuidimi të shoqërisë, rregullat për modalitetet e hartimit të metodologjisë që duhet të negociohet me përdoruesit dhe rregullat e përfaqësimit në negociata, si dhe çdo dispozitë tjetër që është e detyrueshme sipas legjislacionit në fuqi; ii) dispozitat statutores të agjencive të administrimit kolektiv duhet të marrin parasysh parimin e transparencës, parimin e konfliktit të interesit në organet e tyre drejtuese, si dhe parimin e mosdiskriminimit midis anëtarëve, anëtarëve dhe joanëtarëve, si dhe midis përdoruesve të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to; iii) asambleja e përgjithshme e anëtarëve të agjencisë duhet të mbledhet të paktën një herë në vit; vendos për ndryshimet në statutin e agjencisë për emërimin ose shkarkimin e organeve ekzekutive, rishikon performancën e tyre të përgjithshme dhe miraton shpërblimin e tyre, si dhe përfitimet e tjera, të tilla si përfitimet monetare dhe jomonetare, dhënie pensionesh apo titujsh, të drejta dhe shpërblime të tjera ose të drejtat për pagesa kalimtare; vendos të paktën për politikën e përgjithshme për shpërndarjen e shpërblimeve ndaj mbajtësve të të drejtave dhe shpenzimeve të administrimit të të drejtave, si dhe miratimin e çdo blerjeje, shitjeje ose hipoteke të pasurisë së paluajtshme;
- c) ka selinë qendrore në Republikën e Shqipërisë; 58 ç) ka hapësirën dhe logjistikën e përshtatshme dhe mekanizma të mjaftueshëm për mbledhjen, shpërndarjen dhe pagesën e shpërblimit, shërbimin teknik, ekspertizën profesionale me të paktën një punonjës jurist dhe një punonjës financiar;
- d) administrimi kolektiv i të drejtave është aktiviteti i saj i vetëm, përveç rastit kur veprimtaritë e tjera të saj janë në fushën e artit dhe kulturës;
- e) paraqet mekanizma, të cilët garantojnë trajtim të barabartë si për mbajtësit e të drejtave, ashtu edhe për përdoruesit, kur kushtet objektive të trajtimit janë të njëjta.

Licenca e agjencive të administrimit kolektiv është e vlefshme për 3 vjet , e rinovueshme.

DDA ka kërkuar asistencën ndërkombëtare për të bërë të mundur trajnimin e stafëve të AAK në Shqipëri në mënyrë që të rrisin ekspertizën për të përballuar sfidat që paraqet sistemi.

Mbivendosja e të drejtave dhe zbatimi është kryesisht i vendosur në duart e Agjencive të Administrimit kolektiv. Grupet e interesit kanë raportuar se kanë probleme me mbivendosjen e të drejtave për shkak të kompetencave të mbivendosura të AAK-ve dhe rregullat e paqarta të tarifave (përmes ligjit të ri do të zgjidhet kjo çështje në pjesën që parashikon tarifa fikse për një periudhë tre-vjeçare).

Nga ana tjetër, AAK nxorën shqetësimin mbi aftësinë për të zbatuar të drejtën e autorit, në veçanti në mjedisin online, përse i përket mungesës së teknikës së njoftim-bllokimit. Grupet e interesit gjatë

intervistave të tyre me ekspertët e OBPI-s theksuan probleme me AAK-të. Problemet duken kryesisht në vitet e shkuara në lidhje me mbledhjen dhe shpërndarjen e të ardhurave të mbledhura nga AAK kundrejt subjekteve përdorues.

Intervistat e zhvilluara me grupet e interesit, gjatë takimit me ekspertët e OBPI që asistuan Shqipërinë në kuadër të hartimit të strategjisë së re, nxorën se problemet kryesore me sistemin e të drejtës së autorit në Shqipëri lidhen me zbatimin dhe mbivendosjen e të drejtave të autorit.

Sa i përket mjedisit online, si një shembull i një procedure gjysmë bashkë-rregulluese NTD (Notice and take down), vlen të përmendet ajo e nënshkrimit të një Memorandumi Mirëkuptimit për mbrojtjen e të drejtave të autorit në mjedisin digjital.

Marrëveshja mund të nënshkruhet nga subjektet publike dhe private, agjencitë mbikëqyrëse publike dhe mbrojtja e konsumatorëve, veçanërisht autoriteti rregullator për komunikimet elektronike (AKEP), përfaqësuesit e titullarëve të të drejtave, shoqatat e reklamuesve dhe agjencitë e reklamave, shoqatat për mbrojtjen e konsumatorit dhe subjekti përgjegjës për menaxhimin, regjistrimin dhe mirëmbajtjen e fushave të Top Level Domain (TLD).

Memorandumi përcakton një procedurë për bllokimin e faqeve që mund të shkelin ligjin e të drejtës së autorit.

Pra një bashkëveprim më i mirë ndër-institucional është një mënyrë e mirë pune për një zbatim sa më efektiv të ligjit për të drejtën e autorit. Ministria e Kulturës dhe Drejtoria e të Drejtës së Autorit nuk mund të punojnë të vetme në luftën kundër piraterisë dhe informalitetit në vend. Ekzistenca e institucioneve të tjera duhet të jetë me konkrete dhe bashkëpunuese për një ndarje të përgjegjësisë të secilit dhe llogaridhënie për çdo institucion i cili nuk përmbush detyrimet e veta që do i burojnë nga kjo strategji.

Sa i takon pjesës së administrimit kolektiv duhet të transformohet në mënyrë të tillë që organizatat private të përmbushin detyrimet dhe struktura e tyre duhet të jetë e tillë që të gjithë grupet e interesuara të jenë dukshëm të përfaqësuara; në të njëjtën kohë, duhet të merren masa që administruesit kolektivë të jenë eficientë në kushtet e reja të krijuara; dhe sistemi i zbatimit të këtyre të drejtave duhet të jetë më kompleks dhe eficient në mënyrë që të garantojë funksionimin e tyre.

Ministria e Kulturës me ligjin e ri të të drejtës së autorit ka ngritur njëkëshill apo një trupë të specializuar teknike për të vendosur tarifat e përdorimit në administrimin kolektiv, kjo në përputhje me modelet e vendeve të BE-së që kanë karakteristika relevante me vendin tonë.

Forcohen rregullat e funksionimit ndaj agjencive që marrin dhe shfrytëzojnë licencën e dhënë nga Ministria e Kulturës, rregulla këto që konsistojnë në mbrojtjen e të drejtave të anëtarëve artistë të këtyre agjencive, nëtransparencën e aktivitetit të tyre duke futur këtu në mënyrë të qartë edhe rolin më aktiv të organeve tatimore dhe financiare, dhe parashikimin e kostove të operimit të tyre nënjë vit kalendarik, në këtë aspekt vlen të përmendet parashikimi i tavanit të shpenzimeve deri në 30% tëshpërblimeve të shpërndara.

Për efekt të përcaktimit të saktë të detyrimeve tatimore, AAK-te kanë detyrimin të vënë në dispozicion të administratës tatimore, sipas formateve të miratuara, informacionin mbi të ardhurat e mbledhura nga përdoruesit e veprave të të drejtave të autorit/të lidhura me to, si dhe shpërndarjen e këtyre shpërblimeve të mbajtësit e të drejtave detyrim ky i përcaktuar qartazi në ligjin e ri të të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me to.

Këto shpenzime dhe shpërndarje parash me këtë ligj do të duhet të marrin fund duke vendosur nëqendër përfituesin legjitim që është autori i veprës.

Agjencitë kolektive do të duhen të operojnë me më shumë përgjegjësi, llogaridhënie dhe efikasitet në mënyrë që të sigurojnë jetesën e tyre funksionale. Tashmë ne nuk do të amnistojmë asnjë operator që vepron në tregun intelektual në dëm të interesave të mbajtësve të të drejtave të autorit dhe atyre të lidhura me to.

Administrimi kolektiv me këtë ligj ka mundësinë të zhvillohet dhe të krijohen agjenci të reja si rezultat i krijimit të skemave të reja të përfitimit.

Ekziston një perceptim në mesin e aktorëve të brendshëm që e drejta e autorit kryesisht gjeneron të ardhura për bartësit e të drejtave të huaj dhe nuk krijon asnjë nxitje pozitive të rëndësishme për krijimtarinë vendase. Ndërmjet problemeve të ndryshme me sistemin e të drejtave të autorit në Shqipëri, ka vështirësi nëqartësimin e të drejtave. Ka pasiguri të konsiderueshme rreth mbrojtjes së të drejtave të autorit dhe zbatimit të këtyre të drejtave në fushën dixhitale, e cila është deri tani pothuajse e parregulluar.¹⁸

Për sa i përket nivelit të efektivitetit, mekanizmat e rinj janë të parashikuar në ligj, për mbledhjen e të ardhurave nga përdorimi dhe shfrytëzimi i veprave, të cilat garantojnë një sistem rregullator, që sjell efektivitet dhe nuk shkakton konfuzion në treg, gjë që ka ndodhur shumë shpesh. Gjithashtu, aplikimi i kompensimit për importimin e pajisjeve të veçanta për riprodhim apo mbajtës të veprave artistike letrare, do të jetë një tjetër ndihmesë për titullarët e të drejtave në burim të teknologjisë që përdoret për riprodhim.

Konkretisht, janë disa mekanizma: nga njëra anë, ky ligj krijon disa mekanizma garantues për të rritur mundësitë e përdoruesve dhe për të qenë të qartë për sa, kujt, dhe kur duhet të paguajë, në kuadër të zbatimit të këtij ligji. Nga ana tjetër, qartëson të drejtat e mbajtësve të tyre dhe mundësinë e përfaqësimit nëpërmjet agjencive të administrimit kolektiv apo dhe përfaqësues të tjerë të çdo lloji. Kjo është një risi shumë e rëndësishme, si vullnet i vetëm i krijuesit dhe jo si imponim shtetëror.

Duke pasur parasysh se gjatë këtyre viteve procesi i shpërndarjes së shpërblimit ka qenë gati inekzistent, me anë të këtij ligji parashikohen mjete të qarta. Po të shikojmë të dhënat dhe shifrat e deklarimeve, që bëjnë vetë agjencitë në fund të vitit, është impresionant fakti se të katërta agjencitë që veprojnë në terren deklarojnë të ardhurat, deklarojnë shpenzimet e tyre për koston administrative që shkon deri në 50% të asaj çka kanë mbledhur, edhe 60% dhe 70%, madje ka vite të tëra kur nuk deklarohen shpërndarjet, që është një anormalitet shumë i madh.

Kjo shpjegon ankesat e panumërta që vijnë nga autorët, të cilët nuk marrin shpërblim nga paratë e mbledhura. Në këtë kontekst, ky ligj vendos kufij në kuotën me të cilën agjencia mbulon shpenzimet e saj, por nuk e kontrollon atë. Me këtë projektligj kuota e agjencisë llogaritet mbi vlerën e shpërndarë dhe jo në atë të mbledhur. Kjo është një nga pikat më revolucionare, e parashikuar në nenin 151, pika 9, të ligjit të ri, në të cilin bëhet e qartë që postat e administrimit të agjencive, ndryshe nga deri tani, që e merrnin nga paratë e mbledhura, do të duhet të dalin nga paratë e shpërndara, pra, nga paratë që shkojnë për shpërblim për artistët, çka do të thotë që është një mekanizëm që i nxit agjencitë të mbledhin sa më shumë, për të shpërndarë sa më shumë, për të siguruar koston e tyre administrative.

¹⁸ Raporti i OBPI, faqe 2.

Gjithashtu, ky ligj garanton transparencë në metodologjinë e vlerës së shpërblimit të autorit. Ndërmjetësi, me rregulla të qarta dhe me vendimmarrje efektive, pozicionon autoritetet shtetërore në role të qarta ndihmuese dhe garantuese të zbatimit të së drejtës.

Pra, ligji shkon edhe përtej, kur autori, si kategori vulnerabël, nuk i ka njohuritë e mjaftueshme për të kërkuar apo për t'u mbrojtur. Kështu, është ligji që e mbron. Po kështu, format e kontratave të botimit vijnë më të qarta në këtë ligj dhe krijohet një marrëdhënie e qartë midis autorit dhe punëdhënësit, për veprat e krijuara gjatë marrëdhënieve të punës.

Në lidhje me zbatimin e parashikimeve të këtij ligji, mendojmë se parashikimet dhe risitë që sjell ky ligj kanë nevojë për një periudhë transitore, derisa agjencitë e administrimit të të drejtave, por edhe aktorët e tjerë të fillojnë të aplikojnë me sukses zbatimin e këtij ligji, duke qenë se ai sjell ndryshime të mëdha.

Ky ligj parashikon, nga ana tjetër edhe lehtësira për subjektet përdoruese, të cilët tashmë do të paguajnë një tarifë të vetme, sepse është hapur mundësia e krijimit të një *one stop shop*, i cili paraprakisht do të negociohet nga palët dhe në rast mosdakordësie nga palët, do të negociohet përpara Këshillit Kombëtar të të Drejtave të Autorit, si dhe palët të kenë të drejtën e tyre në zbatimin e ligjit për ndërmjetësim.

Agjencitë e administrimit kolektiv janë një partner shumë i rëndësishëm dhe ky ligj krijon hapësirë për të krijuar agjenci të tjera në disa fusha të së drejtës së autorit, ku nuk ekzistojnë, siç është, për shembull, fusha e botimeve. Nuk kemi një agjenci të specializuar për këtë fushë të së drejtës së autorit, por ky ligj i krijon perspektivat dhe e jep këtë mundësi me mekanizmat e saj të rregullimit, të funksionit dhe të mirëqeverisjes së këtyre agjencive.

Një sistem efektiv i pronësisë intelektuale duhet të shqërohet me njetet e duhura dhe një sistem gjyqësor efikas, në kuadrin e të cilit shkeljet mund të jenë të ndjekur penalisht dhe gjykuar. Kjo gjë mund të arrihet përmes miratimit të standardeve të larta për zbatimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura me to në nivel ndërkombëtar së bashku me ngritjen e AA-ve funksionale për grumbullimin dhe shpërndarjen e shpërblimeve dhe honorarëve për titullarët e të drejtës.

Në vitin 1996, dy traktate të tjera janë miratuar në kuadër të OBPI, me qëllim për të rinovuar dhe për të plotësuar Konventat e Bernës dhe të Romës dhe në mënyrë të përshtatshme të përgjigjet në pyetjet e ngritura nga zhvillimi i teknologjive dhe formave të reja të shpërndarjes së veprave përmes internetit.

Traktati i të Drejtës së Autorit WIPO (WCT) si dhe Traktati i OBPI për Performancat dhe Fonogramet (WPPT) – zakonisht të referuara si Traktatet e Internetit, e cila ka hyrë në fuqi në vitin 2002, nuk parashikojnë një zgjatje të vërtetë të fushës së mbrojtjes, por kryesisht për të sqaruar zbatimin e normave ekzistuese dhe përshtatjen e tyre në mjedisin e ri dixhital.

Për sa i përket ushtrimit dhe zbatimit të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, në mjedisin online, traktatet kanë futur detyrime të reja në fushën e masave teknologjike dhe të menaxhimit të të drejtave të informacionit (TPMS/ DRMS)

Në mënyrë të vecantë, Palët e konventave do të sigurojnë një mbrojtje të përshtatshme ligjore dhe mjete efektive juridike kundër shmangies së masave teknologjike që janë përdorur nga autorët, interpretuesit, dhe prodhuesit e fonogramit në lidhje me ushtrimin e të drejtave.

Pjesa më e madhe e ligjeve kombëtare të Pronësisë Intelektuale në BE, parashikojnë sanksione penale për shkeljet e IPR përveç mjeteve juridike civile. Përkundër faktit se BE-ja (dhe shtetet anëtare të saj) janë të detyruara nga TRIPS që nga 1 Janar 1995, nuk kanë harmonizimin e ligjit dhe procedurave

penale brenda BE-së, dhe kështu marrëdhëniet brenda kornizës tregtare të IPRs dhe standardet për zbatimin penal mbeten të pazgjidhura.

Përfshirja, Regjimi, Përgjegjësia e ISP-ve në kuadër të direktivës E-Commerce

Direktiva e E-Commerce¹⁹ (ose ECD) parashikon një kuadër teknologjikisht neutral për ofrimin ndërkufitar të shërbimeve online në BE nëpërmjet një regjimi përgjegjësi të veçantë për lloje të caktuara të ndërmjetësve online, që kanë për qëllim arritjen e një ekuilibri mes të disa interesave në fjalë. Domethënë, ajo përcakton përjashtime nga detyrimi për ofruesit e shërbimeve të shoqërisë së informacionit (ISP), kur ata të shpërndajnë ose të transmetojnë përmbajtje të paligjshme që është dhënë nga një palë e tretë. ISP-të mund, nën kushte të caktuara, të përfitojnë nga këto përjashtime, kur ata japin një nga të ashtuquajturit shërbime ndërmjetës të përcaktuara në Nenin 12 deri 14 të Direktivës.

Për më tepër, Direktiva e E-Commerce inkurajon hartimin e kodeve të sjelljes në nivel të BE-së dhe marrëveshjeve vullnetare në mesin e industrisë, si dhe të ashtuquajturat "NTD" procedurat e bllokimit në mënyrë që ISP-të mund të veprojnë shpejt për të hequr ose çaktivizuar aksesin në përmbajtje të paligjshme.

Ky përcaktim (referuar edhe si "njoftimit dhe të veprimi") zakonisht përfshin procedurën sipas të cilit një ndërmjetës merr poshtë ose e pengon qasjen në informata apo aktivitet pas një njoftimi të shkeljes. Bllokimi mund të bëhet zgjidhja e vetme kur merr-poshtë nuk është e mundur për shkak se aktiviteti i paligjshëm ose informacioni është i ruajtur në një vend të ndryshëm nga ai ku serverat e të

Kjo është kështu për shembull në rastin e zbatimit të Direktivës, i cili parashikon që shtetet anëtare do të sigurojnë që titullaret e të drejtave janë në gjendje për të zbatuar për një vendim gjyqësor kundër ISP-ve të cilëve janë duke u përdorur nga një palë e tretë. Të drejtat themelore janë të rëndësishme kur bëhet fjalë për zbatimin e procedurave të NTD.

Ja vlen të përmendet në këtë aspekt se në BE, një zgjidhje e tillë e parashikuar me ligj, duke çuar në bllokimin e qasjes në internet për shkelësit përsëritës ishte refuzuar shprehimisht nga Komisioni në debatin mbi "Paketën Telekom", 2009 - e Kuadri rregullator i BE-së për komunikimet elektronike.

Edhe pse një numër i kodeve vullnetare, NTD dhe bllokimin e procedurave ligjore janë të zhvilluara në disa shtete anëtare, këto procedura janë ende shumë të fragmentuara në BE, e cila mund të krijojë paqartësi ligjore për ndërmjetësit. Për më tepër, siç përcaktohet në konsultim publik të mbajtur nga Komisioni në vitin 2010 për zbatimin e Direktivës për E-Commerce dhe të ardhmen e e-tregtisë, shumë pyetje mbeten të pavendosur në lidhje me zbatimin e këtyre procedurave

Në praktikë një numër i ndryshëm i procedurave ekziston dhe kjo nuk është e lehtë as për ISP-të apo për të demtuarit nga përmbajtja e paligjshme sesi duhet përcaktuar, si zbatohet dhe në çfarë mënyre.

Ekzistenca dhe përdorimi i NTD nuk parandalon përdorimin e mjeteve juridike të zbatimit të ofruara nga organet publike. Realiteti Evropian është shumë i shpërndarë, dhe përfshin procedurat administrative, me organet shtetërore, si në Spanjë, ose autoriteteve të pavarura, si në Francë, apo rregullatorët, si në Itali, dhe në raste të caktuara njësi të veçanta hetimore, si në Mbretërinë e Bashkuar, dhe procedurave gjyqësore, të cilat janë të parashikuara në cdo vend të tillë.

Pra, një bashkëveprim më i mirë ndërinstitucional është një mënyrë e mirë pune për një zbatim sa më efektiv të ligjit për të drejtën e autorit. Ministria e Kulturës dhe DDA nuk mund të punojnë të vetme në luftën kundër piraterisë dhe informalitetit në vend. Ekzistenca e institucioneve të tjera duhet të jetë më konkrete dhe bashkëpunuese për një ndarje të përgjegjësisë të secilit dhe llogaridhënie për cdo institucion, i cili nuk përmbush detyrimet e veta që do i burojnë nga kjo strategji.

Shembuj kombëtare që mund të merren parasysh në variantin final të kësaj strategjie

Për shkak të shumëllojshmëri të traditave ligjore që mbështesin sistemet e ndryshme të zbatimit kombëtare për shkelje të të drejtave të autorit online, çdo përpjekje për të siguruar një sistem uniform,

¹⁹ <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=CELEX:32000L0031&from=EN>

nuk do të kishte kuptim. Tashmë në vitin 2012, Komisioni Evropian ka theksuar ekzistencën e sistemeve të ndryshme ligjore.

Zbatimi i Direktives kryesisht fokusohet në sistemet gjyqësore, të cilat me siguri mbeten shtylla kryesore e zbatimit të së drejtës së autorit në nivel të brendshëm, dhe ka ruajtur një nivel minimal të garancive dhe mjetet Evropë gjerë.

Mbrojtja gjyqësore në fakt sigurohet në të gjitha shtetet anëtare dhe nuk ofron çështje të veçanta për diskutim, përveç atyre çështjeve shumë komplekse në lidhje me ligjin e zbatueshëm dhe juridiksionin kompetent në kontekst të përdorimit të paligjshëm në internet.

Përveç gjykatave, disa vende kanë filluar për të eksploruar mënyra të tjera për të siguruar mbrojtjen e autorit duke përfshirë organet administrative. Kohëzgjatja dhe kostoja e rëndësishme të procedurave gjyqësore janë ndër arsytet pse nevojat më të menjëhershme për mbrojtjen e të drejtave të autorit në mjedisin online janë të përkthyer në ngritjen e mënyrave të reja të ndërhyrjes. Seksionet e mëposhtme përqëndrohen në sistemet që janë shfaqur dhe që janë veçanërisht të reja në drejtim të përfshirjes organet administrative në luftën kundër shkeljes online. Ato identifikojnë tiparet kryesore të sistemeve të miratuara në Francë, Itali, Spanjë dhe Mbretërinë e Bashkuar.

Kombinimet e mjeteve janë shumë të ndryshme: me rregullatorë pavarur (Itali dhe Mbretërinë e Bashkuar), përfshirjen e gjyqësorit nën rrethana të caktuara (Francë, Spanjë dhe Mbretërinë e Bashkuar), veprimet ndaj përdoruesve fundorë (Francë dhe Britania e Madhe), veprimet kundër faqeve të internetit (Spanjë dhe Itali), përmendet qartë njoftimet dhe procedurat e bllokimit (Spanjë dhe Itali), dhe lista mund të vazhdojë. Të gjitha këto modele u janë nënshtruar debateve të forta me shoqërinë civile dhe kanë përfshirë edhe gjykatat kushtetuese, në rastin e Francës, Italisë dhe Spanjës, dhe të Gjykatës së Lartë të Drejtësisë në Mbretërinë e Bashkuar.

Franca

Pas një debati të gjatë dhe të nxehtë, ligji i parë "për të inkurajuar shpërndarjen dhe mbrojtjen e veprave krijuese në internet", i njohur si Hadopi 1, u miratua në qershor të vitit 2009 e kufizuar në pjesët e tekstit të cilat nuk ishin deklaruar jokushtetuese. Qëllimi ishte për të vendosur masa kundër shkarkimit të paligjshëm të punimeve të copyright-it, dhe në të njëjtën kohë për të nxitur shfrytëzimin në përputhje me ligjin.

Ligji gjithashtu krijoi **një autoritet të veçantë administrativ** për shpërndarjen dhe mbrojtjen e veprave krijuese në internet, Hadopi i ngarkuar për të monitoruar aktivitetet online e abonentëve individualë. Në rastin e shkeljeve, *Autoriteti mund të dërgojë paralajmërime, me anë të një qasje të shkallëzuar, në mënyrë që të bindë shkelësve individuale të përmbahen nga aktivitetet e paligjshme.* Pas një vendimit të ri të Këshillit Kushtetues, për mbrojtjen penale të veprave të mbrojtura letrare dhe artistike në internet" u miratua në tetor 2009 Hadopi 2, dhe la të kuptohet se pas dy paralajmërimeve për ripërhapjen e shkarkimeve të paligjshme, shkyçja nga Internet mund të vendoset me vendim të gjykatës. Sistemi u bë operativ në tetor të vitit 2010 dhe që atëherë ka raportuar për një sasi të konsiderueshme të paralajmërimeve. Pavarësisht shifrave të larta, diskutimet janë në vazhdim e sipër në Francë për mundësinë e ndryshimeve të tjera në ligj. Vlen të përmendet që në vetvete Hadopi sheh si metat e veprimtarisë së vet:

Nuk ka zgjidhje të vetme për përdorimet e paligjshme dhe shkarkimit të drejtpërdrejtë, por një grup i disa masave koherente dhe plotësuese që janë të dy efektive dhe në përputhje me liritë themelore të njeriut. Këto masa kanë parasysh kufizimet e mjeteve ekzistuese ligjore dhe të politikave publike që promovojnë pjesëmarrjen e ndërmjetësve në parandalimin ndalimin për shkeljet online. Prandaj, duhet të konsiderohen mundësitë që përfshijnë më shumë përgjegjësi për përmbajtjen dhe referencat në faqet e internetit, dhe gjithashtu bashkëpunimin e të gjithë ndërmjetësuesve në përdorimin dhe shkarkimin e veprave në internet. Me këtë arsyetim, **vetë-rregullimi nën mbikëqyrjen e autoriteteve publike është duke u inkurajuar, në vend se me zhvillimin e mekanizmave të reja dhe kufizuese.**

Në përgjigje konkrete të nevojave që dalin nga këto dy raporte dhe si një follow-up nga një kërkesë e veçantë e Qeverisë, janë sugjeruar katër mjete specifike:

- marrëveshje me reklamues dhe ndërmjetësve online,

- informimit publik në faqet e internetit që janë përgjegjëse për shkeljet massive
- monitorim i vazhdueshëm i vendimeve gjyqesore në lidhje me shkeljet masive.

Në mars të vitit 2015 qeveria shpalli planin e ri të veprimit. Plani ishte për të adresuar masa për uljen e financimit të siteve të specializuara që cenojnë të drejtën e autorit në veprat e shpërndara në internet; për të monitoruar efektivitetin e të gjitha sanksioneve, duke përfshirë vendosjen e bllokimeve mbi ndërmjetësit teknike.

Italia

Modeli Italian është frymëzuar pjesërisht nga zgjidhja franceze. ***Lufta kundër piraterisë në internet gjithashtu përfshin një organ administrativ, përkatësisht autoritetin e komunikimit, AGCOM (AUTORITA per le garanzie nelle comunicazioni), por me një qasje të ndryshme procedurale.***

Në vitin 1997 AGCOM u krijua si rregullator ***për të gjithë sektorin e komunikimeve*** dhe në vitin 2000 fitoi kompetenca në lidhje me të drejtën e autorit.

Kur në vitin 2003 Direktiva e E-Commerce është transpozuar në Itali, dhe me dekretin miratimit u deklarua se Gjykata ose organi administrativ që ka kompetenca të monitorimit mund të kërkojnë, edhe me anë të procedurave të përshpejtuara, që ofruesit e shërbimeve të ndërpresë ose të parandalojë shkeljen, në mënyrë që menjëherë të hequr ose çaktivizuar informacionin e paligjshëm.

Në vitin 2010, kur direktiva u zbatua, AGCOM përfshiu edhe kompetenca të veçanta rregullatore në këtë fushë. Për të ushtruar kompetencën e tij si rregullator, dhe duke pasur parasysh debatin që pasoi ligjin francez për zbatimin e të drejtave të autorit, AGCOM vendosi të nisë një konsultim të gjerë publik, i cili në fund mori më shumë se tre vjet.

Duke marrë parasysh komentet e dhëna nga palët e interesuara gjatë konsultimeve dhe nga Komisioni Europian, nga projektet rregulloren në bazë të Direktivës së “Transparency”, teksti final u miratua në dhjetor të vitit 2013.

Në mënyrë që të inkurajojë zhvillimin dhe mbrojtjen e veprave dixhitale, Rregullorja përcakton një Komitet të veçantë të përbërë nga përfaqësues nga industria, konsumatorët dhe organet publike kompetente në çështjet e të drejtës së autorit, me qëllim nxitjen e miratimit të kodeve vetë-rregulluese për procedurat e njoftimit bllokimit (Notice and Takedown) dhe iniciimin e “procedurave fillestare”.

Rregullorja gjithashtu përcakton një procedurë të ankesës, të kërkuar nga AGCOM për të siguruar zbatimin e të drejtave të autorit, duke bërë dallimin mes një procedure të zakonshme dhe një procedure të përshpejtuar, që zgjat 35 dhe 12 ditë respektivisht. Nga evidentimi i një shkeljeje të konstatuar në faqet e internetit nga ofruesit në Itali, AGCOM mund të urdhërojë ofruesit italianë hosting për të hequr përmbajtje të paligjshme nga serverat e tyre. Në rastin e serverave të vendosur jashtë Italisë, AGCOM mund të urdhërojë ofruesit e kanaleve italiane për të bllokuar qasjen në faqet e internetit në rastin e shkeljeve masive. Në rast të mosrespektimit të kësaj kërkesë, AGCOM mund të vendosë sanksione në para deri në 250.000 euro. Të gjitha vendimet e marra nga AGCOM janë të publikuara në mënyrë të plotë në një website të caktuar dhe mund të kundërshtohet para gjykatës.

Si edhe në Francë, Italia ka pasur një debat të fortë rreth legjitimitetit kushtetues të procedurave administrative të saj të zbatimit. Pas një sfidë të bërë nga shoqatat e konsumatorëve të ndryshme kundër Rregullores, më 25 qershor 2014, Gjykata Administrative (TAR) të Romës pezulloi procedurën dhe e dergoi këtë procedure në Gjykatën Kushtetuese. Më 20 Tetor 2015 Gjykata e deklaroi papranueshme me kushtetuten, për shkak të mungesës së qartësisë.

Spanja

I ashtuquajturi Ley Sinde u miratua në mars 2011 për të siguruar Spanjën me një mjet efektiv kundër shkeljeve online tecompyright, duke krijuar një komision të veçantë Pronësisë Intelektuale (Comisión de Propiedad Intelectual) nën Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Intelektuale të Ministrisë e Kulturës dhe Sportit. Komisioni vepron në dy pjesë, njëra përgjegjëse për ndërmjetësim dhe arbitrazh aktiviteve, ky i fundit i autorizuar për të detyrojë ISP për të bllokuar qasjen në faqet e internetit per rastet kur nuk kane të drejtat e nevojshme. Rregullorja për funksionimin e saj u miratua dhe siguron procedura të ngjashme me sistemin italian. Nëse Komisioni gjen kërkesat e paraqitura nga mbajtësit e te drejtave të provuara maksimalish me fakte dhe prova, kundërvajtësit duhet të heqin përmbajtje te tilla të paligjshme brenda 48 orëve, duke i degjuar ata me pare për justifikimet e tyre. ***Vendimi përfundimtar i Komisionit duhet të ratifikohet nga një vendim gjykatë në qoftë se vendimi urdheron bllokimin e sitit ne internet.***

Ashtu si në Francë dhe Itali, debati për një përplasje të mundshme me të drejtat e mbrojtura me kushtetutë çoi në një vendim gjyqësor në maj të vitit 2013. Përveç një dispozite të veçantë në lidhje me prezumimin e shkeljes në rast të largimit spontan të përmbajtjes, e cila ishte shpallur antikushtetuese, Rregullorja është konsideruar të jetë në përputhje me kushtetutën spanjolle. Pas akt-gjykimitte Gjykatës dhe duke pasur parasysh nivelin ende të lartë shkeljeve të internetit në Spanjë, kompetencat e Komisionit të Pronësisë Intelektuale janë zhvilluar më tej në nëntor të vitit 2014, nga i ashtuquajturi Ley Lassalle, e cila ka dhënë për gjoba deri në 600,000 euro. Në mars 2015, Parlamenti miratoi një ligj të paraqitur nga qeveria në tetor 2013 për të reformuar kodin penal edhe në lidhje me shkeljet e të drejtave të autorit online. Paralelisht me reformën e ligjit të pronës intelektuale, dispozitat e reja të kodit të ndryshuar Penal futur nocionin e "fitimit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë" për shkeljet e autorit online.

Anglia

Akti Digital Economy 2010 (DEA) ndryshoi Aktin e 2003 ***dhe futi detyra specifike për rregullatorin britanik në sektorin e komunikimit, Ofcom, në fushën e mbrojtjes së të drejtave të autorit.*** OFCOM ka miratuar një kod me qëllim të rregullimit të detyrimeve fillestare të ISP-ve për të dërguar njoftime dhe të sigurojë pronarët e autorit për shkeljet e te drejtave te tyre ne internet. Projekt-Kodi i është nënshtruar një konsultim publik për herë të parë në vitin 2010 dhe më pas, përsëri, në një version pakme te rishikuar, në vitin 2012, por ende nuk ka vendim përfundimtar për kete. ***DEA u kundërshtua nga dy ISP ne Gjykatën e Lartë të Drejtësisë, duke pretenduar shkelje të privatësisë dhe telekomit direktivat e BE.*** Në vendimin e saj të prill 2011, Gjykata e refuzoi kërkesën për të gjithë objektin e paraqitur për gjykim, përveç aspekteve që kanë të bëjnë me ndarjen e shpenzimeve për aktivitetet që do të kryhen nga ISP-te. Pas këtij vendimi, OFCOM ka nisur një konsultim shtesë publik mbi kodin e veçantë për ndarjen e shpenzimeve të zbatimit të të drejtave të autorit, por ende nuk ka marrë një vendim përfundimtar për këtë rast, pasi procedurat janë fuqi kumbajtesi i te drejtes mund të njoftojë ISP-të në lidhje me adresat e përdorura për shkelje të drejtave të autorit duke përcjellë për ta një raport provues për keto shkelje.

ISP-të do të njoftojë përdoruesit e tyre në lidhje me marrjen e një raporti te tille deri në tri herë: letra e parë do të pasohet nga një letër të dytë, në rast të shkeljes të përsëritur në gjashtë muaj, dhe me një letër të tretë duhet të ndodhë një shkelje e re gjatë muajit në vijim. ***Në pritje të hyrjes në fuqi të mekanizmit të reagimit të pershkillëzuar dhe procedurave te zakonshme, procedurat gjyqësore janë funksionale per zbatim.***

Sfidat për të ardhmen.

- Zhvillimi marramendës i teknologjive të reja të informacionit në epokën digjitale që jetojmë, ka sjellë jo vetëm përmirësime të jashtëzakonshme në jetën dhe ekonominë e vendeve të ndryshme, ka përmirësuar cilësisht në ofrimin e tejskajshëm të mundësive që ofron, por nga ana tjetër ka krijuar vështirësi shumë të mëdha në atë çka ne sot jemi të interesuar që është ***“Mekanizimi***

dhe balanca e duhur për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të autorit e të drejtat e tjera të lidhura me të”. Kjo është sfida e sotme.

- Zbatimi i të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura në Republikën e Shqipërisë;
- Trajnimi i mëtejshëm i institucioneve që merren me të drejtën e autorit në RSH
- Edukimi i gjeneratave dhe brezave që rriten, përmes kulturës, me anë të aktiviteteve promovuese dhe ndërgjegjësuere në fushën e të drejtës së autorit;
- Nxitja e krijimtarisë mbetet një sfida për shoqërinë shqiptare, si një element për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore;
- Hartimi i kurrikulave mësimore për ti integruar në tekstet shkollore të arsimit para-universitar dhe atij të lartë.
- Koordinimi efektiv ndër-institucional mbetet sfida për zbatimin e duhur të të drejtave të pronësisë intelektuale në Republikën e Shqipërisë.

1.4 INSTITUCIONET MBËSHTETËSE TË PI-SË

1.4.1. DREJTORIA E POLICISË SË SHTETIT (DPSH)

Struktura specifike e Policisë së Shtetit për ndjekjen e veprave penale të Pronësisë Intelektuale është Drejtoria për Hetimin e Krimit Ekonomik dhe Financiar, pjesë përbërëse e Drejtorisë të Përgjithshme për Hetimin e Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda.

Gjatë periudhës 2010-2015, përfaqësues nga policia e shtetit (Drejtoria për Hetimin e Krimit Ekonomik dhe Financiar) kanë marrë pjesë aktivisht në konferenca dhe aktivitete të ndryshme trajnuese organizuar nga OHIM, TAIEX, INTERPOL, EUROPOL, SELEC (Qendra për zbatimin e ligjit në vendet e Evropës Juglindore), IPLEC (U.S Department of Justice's/ Intellectual Property Law Enforcement Coordinator), Pharmaceutical Security Institute etj. Po ashtu në Akademinë e Sigurisë janë organizuar gjatë tre viteve të fundit trajnime të shkurtra (3-ditore) të specialistëve për hetimin e krimit ekonomik e financiar të strukturave vendore policore me tematikë nga shkelja e të drejtave të Pronësisë Intelektuale, trajnime këto të organizuara nga policia e shtetit në bashkëpunim me DPPM, ZSHDA, Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorinë për Parandalimin e Pastrimit të Parave.

Si rezultat i aktiviteteve të mësipërme trajnuese janë trajnuar plotësisht në fushën e Pronësisë Intelektuale rreth 50 specialistë.

Pas ndryshimeve ligjore të vitit 2012 në Kodin Penal, një numër i konsiderueshëm subjektësh i janë drejtuar strukturave për hetimin e krimit ekonomik e financiar në Policinë e Shtetit, duke bërë kallëzime penale kundër subjekteve të ndryshme që kanë shkelur të drejtat e pronësisë industriale të mallrave apo artikujve që ata prodhojnë apo tregtojnë, kryesisht për produkte industriale, pije energjike, produkte ushqimore, duhan dhe cigare, pije alkoolike pjesë këmbimi për automjete, pajisje mjekësore, shërbime të transmetimeve televizive, etj.

Si rezultat i këtyre kallëzimeve, trajnimit të vazhdueshëm të oficerëve të policisë për hetimin e krimit ekonomik dhe financiar, dhe veprimeve të tjera të kryera me iniciative nga policia e shtetit, është bërë e mundur që gjatë viteve 2012-2015 të rritet numri i hetimeve të rasteve të shkeljeve të të drejtave të Pronësisë Industriale (neni 149/a i Kodit Penal) të ndjekura nga DPSH

Nga policia e shtetit për vitin 2011 është referuar ndjekja penale në prokurori vetëm 1 (një) rast për “Shkeljen e të drejtave të pronësisë intelektuale”- nenet 149 apo 149/a të Kodit Penal; në vitin 2012

janë referuar 5 raste; në vitin 2013 janë referuar 25 raste; në vitin 2014 janë referuar 91 raste dhe në vitin 2015 është referuar ndjekja penale për 68 raste.

Gjithashtu gjatë operacioneve të përbashkëta të Policisë së Shtetit janë sekuestruar një sasi e konsiderueshme mallrash të falsifikuara si dhe mjetet dhe makineritë për prodhimin e tyre; një sasi e konsiderueshme aparaturash transmetimi televiziv (servera, dekodera, antena parabolike, aparate transmetimi satelitore dhe tokësore, karta televizive), etj.

Drejtoria për Hetimin e Krimit Ekonomik dhe Financiar në Drejtorinë e Policisë së Shtetit do të vazhdojë të jetë një hallke e rëndësishme në zbatimin e ligjit, për mbrojtjen e të drejtave të Pronësisë Intelektuale. Përmirësimi i deritanishëm i kuadrit ligjor përkatës dhe Kodit Penal kanë mundësuar rritjen e parandalimit dhe goditjes së këtij fenomeni kriminal si dhe rritjen e nivelit të bashkëpunimit institucional kombëtar dhe ndërkombëtar.

Gjatë viteve 2013, 2014 dhe 2015, Policia e Shtetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Zyrën Shqiptare për të Drejtat e Autorit, AKU-në, INTERPOL-in, EUROPOL-in, SELEC-in kanë ndërmarrë detyrime në fushën e bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar dhe kanë organizuar dhe përfunduar me sukses disa operacione të rëndësishme policore “Për goditjen e aktivitetit kriminal të shkeljes së të drejtave të pronësisë industriale/intelektuale dhe prodhimit e trafikimit të mallrave të falsifikuara/ paligjshme/nën standarde”.

Operacioni “PIRATERIA TELEVIZIVE” zhvilluar nga strukturat policore për hetimin e krimit ekonomik e financiar dhe mbështetur nga Drejtoritë Rajonale Tatimore në të gjithë vendin gjatë periudhës Dhjetor 2013 – Maj 2014 si rezultat i të cilit u kontrolluan 65 subjekte “transmetues televiziv kabllor” dhe u referua ndjekja penale për: “Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale” dhe “Riprodhimi pa të drejtë i veprës së tjetrit”, parashikuar nga nenet 149 dhe 149/a të Kodit Penal për 49 subjekte dhe 50 persona u proceduan penalisht në gjendje të lirë shoqëruar dhe me një numër të konsiderueshëm sekuestrimesh si dekoder, karta transmetuese, antena parabolike, pajisje qendrore transmetuese, amplifikatorë etj.

Operacioni “MERKURI i BARDHE I”, organizuar në periudhën Shtator - Tetor 2013, nga INTERPOL/Programi për trafikimin e mallrave të jashtëligjshme dhe falsifikuara, me bashkëpunimin e shtatë vendeve të Ballkanit (Shqipëria, Bosnja & Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia). Në të morën pjesë 120 forca policore, si dhe pati mbështetje edhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Në gjithë territorin e vendit u kryen 500 kontrolle në punishte, lokale, magazina e ambiente tjera tregtare, si dhe në automjete (furgone, kamionë dhe trajlera) në pikat e kontrollit krijuar në akset kryesore rrugore. Si rezultat i veprimeve policore e procedurale u evidentuan dhe referuan në prokuroritë përkatëse 25 raste për veprat penale të: “Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale”, “Riprodhimi pa të drejtë i veprës së tjetrit”, “Prodhimi i kundraligjshëm i artikujve dhe mallrave industriale dhe ushqimorë”, “Ruajtja apo depozitimi i mallrave kontrabandë” dhe “Falsifikimi i vulave, stampave dhe formularëve”, parashikuar nga nenet 149/a; 148; 149; 288/a, 179 dhe 190 të Kodit Penal, u proceduan penalisht 25 autorë prej të cilëve 2 u arrestuan në flagrancë dhe 23 u proceduan penalisht në gjendje të lirë.

Operacioni “MERKURI i BARDHE II”, organizuar në periudhën Shtator - Tetor 2014, nga INTERPOL/Programi për trafikimin e mallrave të jashtëligjshme dhe falsifikuara, me bashkëpunimin e tetë vendeve të Ballkanit (Shqipëria, Bosnja & Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia dhe Sllovenia). Ndryshe nga operacioni i parë, përveç Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, ky operacion pati gjithashtu edhe mbështetjen e Drejtorisë të Përgjithshme të Tatimeve dhe Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit. Në gjithë territorin e vendit u kryen 411 kontrolle në punishte,

lokale, magazina e ambiente tjera tregtare, si dhe në automjete (furgone, kamionë dhe trajlera) në pikat e kontrollit krijuar në akset kryesore rrugore. Si rezultat i veprimeve policore e procedurale u arritën këto rezultate:

- U proceduan penalisht për veprën penale të Shkeljes së të Drejtave të Pronësisë Industriale (Neni 149/a të Kodit Penal) gjithsej 36 subjekte;
- U proceduan penalisht për vepra të tjera penale si Kontrabandë, Prodhim të Kundraligjshëm, Falsifikim të Stampave, Vulave apo Formularëve, Fshehje e të ardhurave, etj. (Nenet 174, 178, 190, 288/a si dhe 180 të Kodit Penal) gjithsej 25 subjekte;
- U proceduan penalisht në gjendje të lire 54 persona;
- U arrestuan në flagrancë 10 persona;
- Janë vënë në total 2.100.000 leke të reja gjoba nga Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit dhe Drejtoritë Rajonale Tatimore;
- Janë sekuestruar mallra të ndryshme të falsifikuara si konfeksione, parfume, këpucë, këpucë sportive, çanta, CD, DVD, Kompjutera, Lap Top, paketime të ndryshme kartoni dhe plastike, duhane dhe cigare, kafe, kuzhineta, llamba, shampo, detergjente, barna mjekësore, telefona celulare, etj., në shkelje të të drejtave të pronësisë industriale të markave të njohura si Adidas, Puma, Prada, Mango, Lacoste, Dolce&Gabana, Armani, Louis Vuiton, Channel, SKF, Marlboro, Samsung, Swiss, Rolex etj., në një vlerë të përafërt prej rreth 1,6 milion Euro.

Operacioni “MERKURI i BARDHE III”, organizuar në periudhën Shtator - Tetor 2015, nga INTERPOL/Programi për trafikimin e mallrave të jashtëligjshme dhe falsifikuara, me bashkëpunimin e nëntë vendeve të Ballkanit (Shqipëria, Bosnja & Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia, Sllovenia dhe Greqia). Ndryshe nga operacioni i parë dhe i dytë, përveç Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Drejtorisë të Përgjithshme të Tatimeve dhe Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit ky operacion pati gjithashtu edhe mbështetjen e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit. Në gjithë territorin e vendit u kryen 456 kontrole në punishte, lokale, magazina e ambiente tjera tregtare, si dhe në automjete (furgone, kamionë dhe trajlera) në pikat e kontrollit krijuar në akset kryesore rrugore. Si rezultat i veprimeve policore e procedurale u arritën këto rezultate:

- U proceduan penalisht për veprën penale të Shkeljes së të Drejtave të Pronësisë Industriale (Neni 149/a të Kodit Penal) gjithsej 35 subjekte;
- U proceduan penalisht për vepra të tjera penale si Kontrabandë, Prodhim të Kundraligjshëm, Falsifikim të Stampave, Vulave apo Formularëve, Fshehje e të ardhurave, etj. (Nenet 174, 178, 190, 288/a si dhe 180 të Kodit Penal) gjithsej 25 subjekte;
- U proceduan penalisht në gjendje të lire 57 persona;
- U arrestuan në flagrancë 5 persona;
- Janë sekuestruar mallra të ndryshme të falsifikuara si konfeksione, parfume, këpucë, këpucë sportive, paketime të ndryshme kartoni dhe plastike, duhane dhe cigare, kafe, pajisje kantine, makineri paketuese, telefona celulare, pije energjike etj., në shkelje të drejtave të pronësisë industriale të markave të njohura si Adidas, Nike, Puma, Prada, Lacoste, Dolce&Gabana, Hugo Boss, Armani, Louis Vuiton, Channel, Guci, Polo, Ili Kafe, Marlboro, Samsung, Nokia, Iphone, Blackberry, Taraboshi, Sheldia, Grand, B-52, Swiss, Rolex , etj.

Operacioni “OPSON V”, organizuar në periudhën Nëntor 2015 – Shkurt 2016 nën organizimin e INTERPOL dhe EUROPOL me pjesëmarrjen e 57 vendeve nga e gjithë bota, nga të cilat 27 vende evropiane, për goditjen e aktivitetit kriminal të prodhimit, trafikimit, importimit/eksportimit të produkteve ushqimore/pijeve të falsifikuara apo nën standarde. Ky operacion përveç bashkëpunimit ndërkombëtar, pati gjithashtu një bashkëpunim të suksesshëm kombëtar me autoritetet doganore dhe ato të AKU-së, e si rezultat i veprimeve policore e procedurale u arritën këto rezultate:

- U kontrolluan në total rreth 200 subjekte tregtare, persona fizike, punishte dhe automjete transport;

- U proceduan penalisht për veprën penale të Shkeljes së të Drejtave të Pronësisë Industriale (Neni 149/a të Kodit Penal) gjithsej 8 subjekte;
- U proceduan penalisht për vepra të tjera penale si kontrabandë, prodhim të kundraligjshëm, falsifikim të stampave, vulave apo formularëve, fshehje e të ardhurave, etj. (Nenet 172, 174, 179, 180, 190 si dhe 288/a të Kodit Penal) gjithsej 32 subjekte;
- U proceduan penalisht në gjendje të lire 19 persona;
- U arrestuan në flagrancë 6 persona;
- U shpall kërkimi për 1 person;
- Janë sekuestruar mallra të ndryshme ushqimore dhe pije të falsifikuara/nën standarde në sasi të: 48 828 litra vere; 3 870 litra raki rrushi; 120 litra birre Peja; 934 litra pije alkoolike të forta si Whiskey, Konjak, Fërnët, Vodka, Uzo, Xhin, etj.; 203 litra pije energjike B 52 dhe B 2; 1990 litra musht rrushi; 2 640 kg kafe kokërr; 83 kg mjaltë; 18 000 kokrra veze; aksesore voluminoz kantine, etj.

Gjithashtu Policia e Shtetit ka ndërmarrë iniciativa për ndryshime ligjore të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale e konkretisht:

- U propozua hartimi i një dispozite shitesë në Kodin Penal, për prodhimin dhe tregtimin e barnave dhe pajisjeve mjekësore të falsifikuara dhe të rrezikshme për jetën dhe shëndetin. Kjo iniciativë ligjore u realizua me Ligjin nr. 135/2015 dhe në Kodit Penal u shtua një nen i veçantë dhe konkretisht Neni 284/d : “Prodhimi dhe tregtimi i barnave dhe pajisjeve mjekësore të falsifikuara ose të rrezikshme për jetën dhe shëndetin”.
- Janë propozuar ndryshime për nenet 59 dhe 284 të Kodit të Procedurës Penale dhe konkretisht të hiqen nga neni 59 i Kodit të Procedurës Penale (i dëmtuari akuzues) nenet 148 (Botimi i veprës së tjetrit në emrin e vet) dhe 149 (Riprodhimi pa të drejtë i veprës së tjetrit) të Kodit Penal dhe të parashikohen tek neni 284 të Kodit të Procedurës Penale (Ankimi), me qëllim që veprat penale të Pronësisë Intelektuale (nenet 148 dhe 149 të Kodit Penal) të ndiqen me ankim, në mënyrë që detyrimin për të hetuar dhe provuar akuzën ta ketë jo i dëmtuari akuzues, siç është aktualisht, por organi procedues (prokuroria).
- Është ndërmarrë iniciativa ligjore për të nënshkruar dhe ratifikuar në Kuvendin e Shqipërisë, Konventën e Këshillit të Evropës “Për Falsifikimin e Produkteve Mjekësore dhe Krimeve të Ngjashme që Përbëjnë Kërcënim për Shëndetin Publik” (“MEDICRIME CONVENTION”, hartuar datë 28.10.2011), konventë kjo e cila me Vendim Nr. 520, datë 16.06.2015, të Këshillit të Ministrave është miratuar në parim, si dhe më datën 17.12.2015, në Strasburg, është nënshkruar nga Ambasadori ynë në Këshillin e Evropës.

Sfidat për të ardhmen.

- *Përmirësimi dhe modernizimi i mëtejshëm i legjislacionit me synim harmonizimin e plotë të tij me atë evropian.*
- *Ngritja e nivelit profesional të specialistëve për hetimin e krimit ekonomik dhe financiar.*
- *Rritja e sasisë dhe cilësisë së hetimeve për shkeljet e të drejtave të Pronësisë Intelektuale.*
- *Ngritja në një nivel më të lartë e bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar.*
- *Hartimi i kurrikulës së hetimit të veprave penale të shkeljes së të drejtave të PI.*

1.4.2 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE (DPD)

Administrata Doganore Shqiptare në kuadër të misionit fiskal, ekonomik dhe mbrojtës ka për detyrë, mbrojtjen e të drejtave të Pronësisë Intelektuale me qëllim:

- Mbrojtjen e ambientit të biznesit të cilët janë mbajtës dhe/ose përdorues të një të drejte të Pronësisë Intelektuale nga konkurrenca e pandershme.
- Mbrojtjen e konsumatorit dhe shëndetit publik nga mallra të falsifikuara/piratë për pasojat që shkaktojnë dhe kufizimin e mundshëm të humbjeve të të ardhurave në buxhetin e shtetit që vinë si pasojë e mallrave që cenojnë një të drejtë të Pronësisë Intelektuale.

Për të mundësuar një mbrojtje së të drejtave të Pronësisë Intelektuale si dhe për të arritur të njëjtin nivel mbrojtje për çështjen e Pronësisë Intelektuale si në vendet e Bashkimit Evropian, Sistemi Doganor krijoi në maj të 2010-të Drejtorinë për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale.

Baza ligjore mbi të cilën vepron sistemi doganor është:

- *Marrëveshja Trips, nenet 51-60*
- *Marrëveshja e Stabilizim dhe Asocimit, neni 42 dhe 73*
- *Kodi Doganor, Neni 82/4*

Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor (VKM 1090 datë 28.12.2015)

Procesi i mbrojtjes së të të drejtave të Pronësisë Intelektuale është pothuajse plotësisht i përafruar me Rregulloren (EU) Nr. 608/2013, nenet 118 - 120 të VKM 205 13.04.1999 ‘Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor’ të ndryshuar me VKM nr. 1090, datë 28.12.2015 përcaktojnë në mënyrë të detajuar procedurat doganore që duhet të ndiqen nga autoritetet doganore nga bllokimi i mallrave të dyshuara si cenuese së të drejtave të Pronësisë Intelektuale, kur veprojnë me iniciativën e vet (ex officio) dhe/ose bazuar mbi një aplikimin doganor. deri në procesin e shkatërrimit të tyre duke respektuar normat mjedisore.


Drejtoria për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale (DMPI) është strukturë përbërëse e Departamentit Operativ – Hetimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. Stafi i saj është i përbërë nga 1 drejtor dhe 4 specialistë.

Objekti i punës të DMPI është të zbatojë legjislacionin për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale sipas ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi për territorin Doganor Shqiptar, të koordinojë punën ndërmjet Drejtorive të tjera të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Institucione të treta dhe/ose grupeve të interesit për çështjet e Pronësisë Intelektuale, të administrojë me profesionalizëm kërkesat e/i interesuarve të paraqitura pranë D.M.P.I-së, duke mbajtur në vëmendje respektimin e afateve kohore, procedurale dhe trajtimin e çështjeve në mënyrë profesionale. Gjithashtu, të ushtrojë në mënyrë të përshtatshme dhe efikase kompetencat e dhëna nga ligji dhe hartimin e materialeve sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe të përditësojë njohuritë për çështjet e Pronësisë Intelektuale duke marrë pjesë në aktivitete trajnuese dhe/ose aktivitete që trajtojnë çështjet e PI.


Ligje të tjera të cilët ju referohemi dhe/ose trajtojnë sistemin doganor janë:

- *Ligji për të drejtat e Autorit dhe të drejta të lidhura më të;*
- *Ligji për Pronësinë Industriale*

Aplikim për veprim është instrumenti i vetëm që vë në lëvizje institucionin doganor.



Mallra të shkatërruara bazuar në një kërkesë për veprim:



Nga momenti i funksionimit të Drejtorisë për Mbrojtjen e Pronësisë Intelktuale numri i aplikimeve për mbrojtjen e të drejtave të Pronësisë Intelktuale ka ardhur në rritje, duke ju referuar statistikave nga 0 në vitin 2010, në 89 kërkesa për vitin 2013, në 95 në vitin 2014 dhe 117 në vitin 2015. Po ashtu edhe numri i shkatërrimeve të mallrave që janë konstatuar si cenuese të IPR-së ka ardhur duke u rritur.

E shprehur në %:

Nga vitin 2013 në vitin 2014 ka pasur një rritje 86 % të shkatërrimeve të mallrave cenuese;
 Nga viti 2014 në vitin 2015 ka pasur një rritje 108% të shkatërrimit të mallrave cenuese;
 Nga viti 2013 në vitin 2015 ka pasur një rritje 290 % të shkatërrimeve të mallrave cenuese.

Rezultatet e punës të sistemit doganor në fushën e mbrojtjes së pronësisë intelektuale siç ilustron nga grafikët janë konkrete, të matshëm dhe ajo që është më e rëndësishme kurba e shkatërrimit është në ngritje nga viti në vit. Këto rezultatet kanë sjellë dhe rritjen e nr. të aplikimeve nga mbajtësit e së drejtës të cilët kërkojnë mbrojtje nga sistemi doganor. Duhet të pranojmë dhe të jemi të ndërgjegjshëm që në institucionet ligjzbatues, Drejtoria Përgjithshme e Doganave është në vendin e parë për parandalimin e fenomenit të cënueshmërinë e mallrave.

Drejtoria për Mbrojtjen e Pronësisë Intelktuale duke mos e kufizuar punën e saj vetëm në rolin ligjzbatues që ka Sistemin Doganor si dhe duke konsideruar shumë të rëndësishëm ndërgjegjësimin e biznesit (mbajtësve të së drejtave), dhe publikut si konsumator, ka mundësuar pjesëmarrjen për dy vjet radhazi në panairin e organizuar nga “Klik Ekspo Group International Trade Fair” duke ekspozuar mallra që shkelin një të drejtë të Pronësisë Intelktuale dhe që janë sekuestruar nga Autoriteti Doganor.

Gjithashtu, në kuadër të Projektit të Binjakëzimit IPA -2011 janë zhvilluar aktivitete me fëmijët e Shkollës së Kuqe, Workshop në ambientet e EU Center me gjimnazistë për sensibilizimin në çështjet e Pronësisë Intelktuale si dhe Workshop me temë “Progresi dhe Sfida në Fushën e Pronësisë Intelktuale” me pjesëmarrës dhomat e tregtisë, studio ligjore dhe biznese.

Përforcimi i kapacitetit administrativ të DPD dhe Degëve Doganore.

Faktori human mbetet gjithnjë faktori më i rëndësishëm, që mundëson mirëfunksionimin e sistemit. Për sa më sipër, Drejtoria për Mbrojtjen e Pronësisë Intelktuale, në mënyrë që të rrisë kapacitetet administrative të personelit të Administratës Doganore Shqiptare, në lidhje me çështjet IPR, ka zhvilluar ciklin e trajnimeve në vendin e punës duke asistuar në kontrole të përbashkëta në Degëve Doganore kryesore, për të njohur doganierët me rastet dhe trendet e reja në lidhje me falsifikimin e mallrave dhe për të konstatuar raste të mallrave mallra cënuese të të drejtave të Pronësisë Intelktuale.

Gjithashtu, DMPI ka organizuar seminare së bashku me disa nga mbajtësit e së drejtës (adidas TM, Bjorn Borg TM, LVMH brands, Puma TM, Pentlandbrand, Louis VUITTON, Kyocera TM, APPLE TM, Samsung TM, Stihl TM), ku janë trajnuar oficerë doganore, grupet e Antikontrabandës si dhe disa përfaqësues nga drejtoritë kryesore të DOH-së, për mënyrën e identifikimin e produkteve të falsifikuara.

Në kuadër të bashkëpunimit ndër –institucional dhe zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Zbatimin e të Drejtave të PI, DMPI ka pasur këto bashkëpunime si më poshtë:

- Trajnim i përbashkët me Drejtorinë e Policisë së Shtetit në Qendrën e Formimit Policor, me temë: “Mjetet, metodat dhe procedurat për hetimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimeve në detyrë”. Metodika e hetimit të krimit ekonomik financiar.
- Është siguruar pjesëmarrja në të gjitha trajnimin e organizuar nga Zyra Shqiptare për të Drejtën e Autorit (ZSHDA) të ofruara nga Komisioni Evropian me anë të Programit të Asistencës Teknike TAIX/KE.

Në korrik të viti 2015 është nënshkruar me Drejtorinë e Patentave dhe Markave një kalendar trajnimesh për të gjitha degët doganore, në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet këtyre dy institucioneve.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, DMPI ka marrë pjesë në aktivitetet dhe operacionet e mëposhtme:

- DG TAXUD (workshope në kuadër të Programit Dogana 2013);
- Trojan Horse V organizuar nga Selec
- “White Mercury I-V” – “Mërkuri i Bardhë I-V” nga Interpoli në bashkëpunim me Policinë e Shtetit;
- Iniciativa e Bashkëpunimit të Venecias (workshope dhe vizita studimore);
- SELEC (ish SECI) (takime në lidhje me organizimin e operacioneve);
- Seminar Rajonal mbi ilaçet e falsifikuara në Evropën Juglindore në bashkëpunim me UNODC (Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimet);

- ACG (mbledhja e Komitetit Ndërkombëtar), Kongresi i Gjashtë Botëror mbi luftën kundër falsifikimeve dhe piraterisë.

Sfidat për të ardhmen.

- Ndërtimi i një infrastrukture të mirëfillte administrative brenda institucioneve kombëtare të përfshira në sigurimin e mbrojtjes së Pronësisë Intelektuale nëpërmjet:
 - o Përforcimit të kapaciteteve administrative të DPD-së dhe Degëve Doganore.
 - o Përditësimi i bazës ligjore me akte nënligjore si udhëzime dhe manuale për doganierët. Miratimi i manualeve dhe udhëzimeve.
 - o Krijimit të përdoruesve në bazën e të dhënave sipas specifikave të çdo institucioni për të përfshirë informacione të cilat do të shërbejnë për të përmirësuar cilësinë e punës.
- Instalimi i versionit të plotë të software INES + i cili do të shërbejë si bazë të dhënash dhe në procesimin e kërkesave për veprim doganor në format elektronik.
- Rritja e bashkëpunimit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar me aktorët e tjerë të përfshirë në mbrojtjen e të drejtave të Pronësisë Intelektuale.
- Trajnime të stafit të DPD dhe rritja e bashkëpunimit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar me aktorët e tjerë të përfshirë në mbrojtjen e të drejtave të Pronësisë Intelektuale.
- Ndërmarrja e fushatave për ndërgjegjësimin e publikut lidhur me rëndësinë e IPR-së.

1.4.3 INSPEKTORATI SHETETËROR I MBIKËQYRJES SE TREGUT (ISHMT)

Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut është institucion qendror publik, buxhetor, i krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 36, datë 20.01.2016 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e inspektoratit shtetëror të mbikëqyrjes së tregut. Ai ka si objekt të veprimtarisë së tij inspektimin dhe monitorimin e tregut të brendshëm dhe konstatimin e rasteve të shkeljeve të të drejtave të Pronësisë Intelektuale (mallra të falsifikuara dhe pirate), duke siguruar mbrojtjen e konsumatorit, mbrojtjen e shëndetit publik, ruajtjen e një konkurrence të ndershme në treg dhe mbrojtjen e mbajtësve të drejtës.

Baza ligjore për krijimin e Inspektoratit, e hartuar me mbështetjen e Projektit të Qeverisë Gjermane të zbatuar në Shqipëri nga GIZ “Mbështetje për zbatimin e legjislacionit shqiptar të përafëruar me legjislacionin e BE-së”, përfshin:

- Mbikëqyrja e Tregut;
- Detyrimet, roli i shtetit,
- Parimet e funksionimit të sistemit të mbikëqyrjes së tregut,
- Rolet e strukturës administrative për sigurinë e produkteve dhe bashkërendimin e aktiviteteve të mbikëqyrjes së tregut në MZHETTS, në Doganë dhe në ZSHDA, DPPM etj.

ISHMT ka si mision garantimin e sigurisë së produkteve për konsumatorët, të vendosura në treg dhe në shërbim/ përdorim, nëpërmjet aktiviteteve mbikëqyrëse sipas legjislacionit në fuqi. ISHMT është gjithashtu përgjegjëse për të monitoruar respektimin e të drejtave të Pronësisë Intelektuale si dhe të të drejtave të tjera sipas fushës së veprimtarisë institucionale, objekt inspektimi sipas këtij vendimi.

Inspektorati i tregut pritet të përmirësojë zbatimin e të drejtave të PI në Shqipëri. Trajnime shpesh dhe në mënyrë të vazhdueshme do të mund të ndihmojnë për të pajisur inspektoratin me ekspertizën e nevojshme.

Ndërkohë është përgatitur edhe një paketë e plotë e instrumenteve të nevojshëm teknik për bërjen funksionale të këtij inspektorati përfshirë:

- (a) procedurat standarde të veprimtarisë së mbikëqyrjes së tregut, (tashme të miratuara),
- (b) formularët e inspektimit në formën e listave të kontrollit për produkte të caktuara,
- (c) metodologjinë e vlerësimit të riskut,
- (ç) misionin, përshkrimin e punës dhe kërkesat specifike për stafin e inspektoratit,
- (d) vlerësimin e kostove të nevojshme për ngritjen e tij.

Inspektorati i Mbikëqyrjes së tregut në fushën e PI do të zbatojë:

- Ligjin 35/2016, “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”.
- Ligjin nr. 9947, datë 07.07.2008 “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar.

si dhe inspektimin për respektimin e kërkesave të detyrueshme ligjore në fushën e mbrojtjes të konsumatorëve, mbrojtjes së pronësisë industriale, mbrojtjes së të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to.

Mbikëqyrja e tregut për të drejtat e autorit ka qëllim parandalimin, ndalimin e shkeljes së të drejtave, rritjen e ndërgjegjësimin për mos shkeljen e të drejtave, si dhe ndëshkimin e personave fizik, juridik, privat apo publik që shkelin këto të drejta.

Të tjera detyra të Inspektoratit:

- Sigurimi i kapaciteteve për të mbledhur dhe ruajtur të dhëna dhe për të kryer analiza të vlerësimit të riskut për të identifikuar produktet dhe shërbimet.
- Bashkërendimi i programeve dhe praktikave të zbatimit në mbarë territorin shqiptar, për të siguruar një efikasitetin dhe konsistencë më të madhe operacionale;
- Trajtim i ankesave dhe problemeve të identifikuara, për të siguruar që produktet, shërbimet dhe praktikatat që janë në përputhje me legjislacionin
- Ekzistenca e një sistemi që mund të zgjidhë problemet në burim dhe në mënyrë të bashkërenduar, duke adoptuar një qasje që udhëhiqet nga autoritetet publike;
- Ofrimi i trajnimeve të duhura për nëpunësit e mbikëqyrjes së tregut. Ata duhet të jenë në dijeni të kontekstit ekonomik në të cilin operojnë, të përdorin praktikatat më të mira dhe të ndjekin kurse trajnimi që sigurojnë zhvillimin e vazhdueshëm profesional;

Sfidat për të ardhmen

- Hartimi i rregulloreve për funksionimin e Inspektoratit.
- Parandalimi dhe ndalimi i shkeljeve të të drejtave të Pronësisë Intelektuale si dhe mbikëqyrja e tregut në lidhje me origjinën tregtare të produkteve dhe shërbimeve
- Trajnime për kualifikim të stafit
- Bashkëpunim me institucionet e përfshira në mbrojtjen e të të drejtave të PI.

1.4.4 SHKOLLA E MAGJISTRATURËS

Shkolla e Magjistraturës është institucioni që siguron kualifikimin profesional për gjyqtarët dhe prokurorët shqiptarë nëpërmjet Programeve të Formimit Profesional, i cili përfshin:

- Programin e Formimit Fillestar për kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë;
- Programin e Formimit Vazhdues për gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë.

Programi i Formimit Fillestar përmban lëndën “pronësia intelektuale”, e cila përmban 32 orë mësimore nga të cilat 16 orë janë në lidhje me të drejtën e autorit dhe 16 orë për pronësinë industriale. Lënda zhvillohet për kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë që ndjekin studimet e trajnimit fillestar.

Programi i Formimit Vazhdues ka një përmbajtje tematike gjithëpërfshirëse diktuar nga vlerësimi i nevojave të gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë nisur nga problemet e praktikës, proceset e reformës në drejtësi dhe të përjasjes me *acquis communautaire* si dhe me standardet ndërkombëtare, ndryshimet ligjore, problemet ligjore dhe sociale, etj. Hartimi, miratimi dhe realizimi i Programit të Formimit Vazhdues bëhet sipas procedurave të caktuara në ligj ku një rol të rëndësishëm ka stafi pedagogji, Departamenti i trajnimit Vazhdues, Këshilli pedagogjik dhe Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës. Frekuenca e realizimit të një aktiviteti trajnues varet nga numri i aplikantëve për atë temë. Kjo do të thotë se ka kurse me frekuenca të larta për tema të interesit më të gjerë dhe kurse të zhvilluara me frekuencë më të limituar. Po kështu, ndërtohet edhe niveli i kurseve. Me këtë duam të themi se ka kurse të nivelit bazik siç janë ato që lidhen me fushat e reja ose më të avancuar që lidhen me thellimin e njohurive.

Lidhur me pronësinë industriale, nisur nga kërkesat e gjyqtarëve/prokurorëve, Shkolla ka organizuar mesatarisht një deri në dy trajnime në vit akademik. Kështu për shembull, për periudhën 2011-2015 janë organizuar 9 aktivitete trajnuese me këtë tematikë. Këto trajnime në disa raste kanë qenë rrjedhojë e një bashkëpunimi edhe me ekspertë të huaj si në rastin e trajnimit të zhvilluar në bashkëpunim me ZPIBE. Për sa i përket pjesëmarrësve, Shkolla e Magjistraturës është kujdesur që për këto tema të bëjë një referim të veçantë duke nxitur aplikimet e gjyqtarëve/prokurorëve.

Për vitin akademik 2015-2016 është parashikuar të zhvillohet vetëm një trajnim me këtë temë. Duhet nënvizuar se programi tematik dhe kalendari i aktiviteteve është fleksibël dhe dinamik, kjo jep mundësinë që numri i tyre, nëse do të ketë interes, të shtohet me miratimin e Këshillit Drejtues.

Në Programin e Formimit Vazhdues për gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë si dhe në Programin e Formimit Fillestar për kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë, Shkolla e Magjistraturës planifikon të përfshijë tematikat e mëposhtme për periudhën 2016-2020:

- Pronësia Industriale, kuadri ligjor, institucionet e përfshira dhe aktivitetet e tyre, praktika e gjykatës në lidhje me konfliktet që burojnë nga shkelja e të drejtave të markave, patentave dhe disenjave industriale, duke përfshirë juridiksionin e ECJ-së.
- Legjislacioni për doganat në lidhje me piraterinë e mallrave dhe produkteve.
- Procedurat administrative për mbrojtjen dhe administrimin e të drejtave të autorëve dhe të drejtave që burojnë nga pronësia industriale, procedurat e gjykatës.
- Legjislacioni i BE-së në lidhje me pronësinë industriale, vendimet e OHIM-it, Gjykatës Evropiane të Drejtësisë dhe Gjykatës së Përgjithshme në këtë fushë.

Sfidat për të ardhmen

- Pasurimi i bibliotekës me materiale shqiptare dhe të huaja për të përballuar kurset e reja që do të zhvillohen.
- Zhvillimin dhe thellimin e lidhjeve tona me bibliotekat e shkollave evropiane të magjistraturës dhe institucioneve të tjera ligjore. Prioritet do të jetë sigurimi i aksesit në biblioteka dhe bazë të dhënash online e cila do bëjë të mundur thellimin e njohurive dhe realizimin e kërkimeve në fushën e Pronësisë Intelektuale.
- Shkolla e Magjistraturës në bashkëpunim me GDPT do të sigurojë përkthimin në shqip të vendimeve më të rëndësishme të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë.
- Shtimi i numrit të trajnimeve të gjykatësve (1-2 trajnime në vit) që do të angazhohen në gjykatën administrative, dhe në mënyrë të veçantë me ata që do të merren në mënyrë specifike me çështjet e DPI.
- Bashkëpunim i Shkollës së Magjistraturës me DPPM dhe ZSHDA, për informacione në lidhje me çështjet e PI.

1.4.5 AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i harmonizuar tërësisht me *acquis communautaire* dhe standardet evropiane, përcakton Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA) si autoritetin rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në Republikën e Shqipërisë, institucion i cili ka si detyrë funksionale monitorimin dhe mbrojtjen e një prej degëve të Pronësisë Intelktuale, konkretisht të të drejtave të transmetimit dhe të drejtave të autorit.

Ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, në nenet 32, pika 6 dhe neni 33, pika 1/ë, parashikon shprehimisht respektimin e të drejtës së transmetimit, si dhe të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të nga ana e ofruesve të shërbimit mediatik.

Roli i AMA-s në mbrojtjen e këtyre të drejtave realizohet nëpërmjet rolit kontrollues që i ka caktuar ligji si dhe nëpërmjet bashkëpunimit me institucionet e tjera.

Në rastin e mosrespektimit të kushteve dhe afateve për të cilat i licencuari ose i autorizuari ka nënshkruar marrëveshje me mbajtësit e të drejtave të veprave të transmetuara prej tij, AMA, mund të vendosë sanksione administrative që nga sanksionimi me gjobë, ulje të afatit të licencës dhe/ose autorizimit, apo edhe heqjen e licencës dhe/ose autorizimit, në rast ripërsëritjeje.

Po ashtu, ligji nr. 97/2013, parashikon se mosrespektimi i kërkesave lidhur me detyrimin e çdo ofruesi të shërbimit mediatik audio ose audioviziv (OSHMA) për të respektuar të drejtat e autorit sipas legjislacionit në fuqi për të drejtat e autorit dhe të drejtat e lidhura me të, përbën shkak për sanksionimin me gjobë të subjektit kundërvajtës.

Ndër të tjera, ligji organik i jep të drejtën AMA-s që të heqë licencën/autorizimin në rast se një OSHMA ndëshkohet më shumë se 3 herë brenda një viti kalendarik, për një nga kundërvajtjet administrative të parashikuara nga ligji.

Autoriteti i Mediave Audiovizive, është investuar në nxitjen e frymës së partneritetit dhe bashkëpunimit me transmetuesit audio/audiovizivë, duke kërkuar në mënyrë të vazhdueshme korrektësinë në marrëdhënie me palët e treta. Në këtë kuptim AMA nuk ka pasur prioritet të vendosë sanksione në mënyrë represive por të sigurojë komunikim të vazhdueshëm me OSHMA-të, sa i përket mbrojtjes dhe respektimit të së drejtës së transmetimit dhe të drejtës së autorit.

Pikërisht me qëllim rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit dhe shkallës së informimit të publikut në lidhje me rëndësinë e të drejtave të transmetimit/autorit si pjesë e Pronësisë Intelktuale, AMA është angazhuar në zhvillimin e takimeve me subjektet që operojnë në fushën e transmetimeve audio dhe audiovizive.

Po ashtu, AMA në mënyrë aktive ka luajtur rolin e arbitrit që në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe konflikteve të ndryshme midis ofruesve të shërbimit mediatik.

Për sa i përket subjekteve të palicencuar/paaautorizuar, gjatë vitit 2015, AMA ka ndërmarrë në mënyrë të vazhdueshme një numër të konsiderueshëm aksionesh për ndalimin e gjendjes së informalitetit në të cilin disa subjekte ushtronin aktivitet audioviziv.

Nga ana tjetër, AMA ka ndjekur me prioritet të gjitha ankesat për pirateri të depozituara pranë autoritetit, duke kryer inspektimet në terren apo monitorimet rast pas rasti. Në përfundim të

procedurave administrative, AMA ka vendosur sipas rastit, tërheqjen e vëmendjes ndaj subjekteve ose sanksionet gjatë.

Si pasojë gjatë vitit 2015 mes subjekteve audiovizive është vënë re një rritje e ndërgjegjësimit lidhur me detyrimet që ata kanë në respektimin e të drejtave të transmetimit dhe të drejtave të autorit, ndërgjegjësim i cili pasqyrohet në dokumentacionin e depozituar prej OSHMA-ve për kalimin e të drejtave të transmetimit të programeve, si dhe dokumentacionin përkatës për përmbushjen e detyrimeve kundrejt agjencive të licencuara të administrimit kolektiv të të drejtave të autorit.

Sfidat për të ardhmen

- *Forcimi i bashkëpunimit në nivel kombëtar e rajonal në funksion të përmirësimit të punës në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të Pronësisë Intelektuale në fushën e transmetimeve audio dhe audiovizive.*
- *Rritja e ndërgjegjësimit të OSHMA-ve në Shqipëri lidhur me të drejtat e Pronësisë Intelektuale në fushën e transmetimeve audio dhe audiovizive.*

1.4.6 MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT (MAS)

INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT (IZHA)

Ministria e Arsimit dhe Sportit ka një rol të rëndësishëm në hartimin dhe miratimin e kurrikulave kombëtare për arsimin parauniversitar si dhe trajnimin dhe kualifikimin e mësuesve në fushën e të drejtave të PI. Institucioni përgjegjës për hartimin e kurrikulave është Instituti i Zhvillimit të Arsimit (IZHA).

Instituti i Zhvillimit të Arsimit, IZHA, është institucion i ri, i krijuar si institucion publik, në varësi të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës. Megjithatë IZHA është trashëgimtar i Institutit të Studimeve Pedagogjike, i themeluar në vitin 1970, i cili ka vijuar ekzistencën e tij përmes emërtimeve të reja që ka marrë gjatë 20 vitet e fundit si: Instituti i Kurrikulave dhe Standardeve (IKS -2003), Instituti i Kurrikulave dhe Trajnimit (IKT – 2007) dhe Instituti i Zhvillimit të Arsimit (IZHA -2010)

Në aktin e themelimit misioni dhe objekti i IZHA përcaktohet si më poshtë:

1. IZHA i ofron Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe institucioneve arsimore në vend ekspertizë dhe këshillim me nivel të lartë profesional, mbështetur në rezultatet e punës kërkimore-shkencore dhe praktikës arsimore.
2. IZHA ka për objekt të veprimtarisë së saj hartimin e kurrikulës për sistemin arsimor parauniversitar, zhvillimin e politikave të arsimit parauniversitar, përgatitjen e dokumenteve të ndryshme në lidhje me politikën kombëtare në fushën e arsimit dhe kryerjen e punëve kërkimore studimore në fushat e didaktikës dhe përdorimit të teknologjive moderne në mësimdhënie dhe mësimnxënie.

Sfida për të ardhmen

Për realizimin e misionit dhe të politikës dhe objektivave së saj, në kuadër të këtij misioni, IZHA bashkëpunon dhe bashkërendon veprimtarinë e saj me institucione të tjera shtetërore dhe jo shtetërore. Aktualisht, IZHA është në krye të një reforme të thellë dhe tërësore të Arsimit Parauniversitar në disa drejtime themelore:

1. *Reforma e kurrikulës së arsimit parauniversitar*
2. *Reforma e sistemit të trajnimit dhe kualifikimit të mësuesve*
3. *Reformimi i raporteve të shkollës me komunitetin dhe i rolit të saj në këtë komunitet, me*

Kjo reformë është pjesë e Strategjisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar për periudhën 2014-2020 dhe, si e tillë, shkrihet në vizionin e përgjithshëm të qeverisë për periudhën në fjalë dhe me strategjitë e tjera në fushat parësore të veprimtarisë së saj.

1.4.7 MINISTRIA E DREJTËSISË

Roli i kësaj Ministrie në këtë Strategji është të hartojë, ndjekë procedurat për ndryshimet e Kodit Penal dhe të Kodit të Procedurës Penale, të iniciuara nga institucione të përfshira në fushën e PI, si dhe trajnimin e gjyqtarëve/prokurorëve në përgjithësi dhe në fushën e PI në veçanti.

Sfidat për të ardhmen

- *Miratimi i ndryshimeve në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurave Penale.*
- *Trajnimi i Gjyqtarëve në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës.*

1.4.8 UNIVERSITETI POLITEKNIK

Qendrat e transferimit të teknologjisë pranë universiteteve apo organizmave shkencore dhe të zhvillimit shërbejnë si lidhje të dobishme e kërkesës me ofertën për rastet e shpikjeve teknike. Roli i tyre është të informojë ekonominë mbi mundësitë e bashkëpunimit, në bazë të informacionit të brendshëm në lidhje me R & D, kapacitetet dhe rezultatet e punës shkencore të institucioneve të tyre, të marrë pjesë në përzgjedhjen e partnerëve të biznesit dhe zbulimin e burimeve të financimit, të kontribuojnë në mënyrë aktive për ngritjen dhe ligjshmërinë e këtij bashkëpunimi dhe të mbikëqyri realizimin e tij.

Qeveria duhet të mbështesë aktivitetet e universiteteve dhe organizatave të shkencore dhe zhvillimore në ngritjen e qendrave të transferimit të teknologjisë dhe fillimin e punës së tyre.

Të drejtat dhe detyrimet e universiteteve, organizata shkencore dhe të zhvillimit duhet të jenë të përcaktuara qartë. Kjo është një nga parakushtet e rëndësishme për avancimin e përdorimit të shpikjeve në ekonomi.

Sfidat për të ardhmen

- *Ngritja e qendrave të transferimit të teknologjisë pranë Universiteteve.*
- *Hartimi i një model kontrate ligjore për veprimtari shkencore dhe zhvillim ku të përcaktohen qartë të drejtat dhe detyrimet e të gjithë aktorëve në bashkëpunim (universitet me organizatat shkencore dhe të zhvillimit me individët).*

1.4.9 PROKURORIA

Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Prokuroria i ushtron funksionet nëpërmjet prokurorëve.

Në ushtrimin e kompetencave të tyre prokurorët u nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve. Prokurorët i ushtrojnë kompetencat e tyre duke respektuar parimet e procedimit të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor dhe mbrojtjes të së drejtave, të interesave dhe të lirive të ligjshme të njeriut.

Prokuroria organizohet dhe funksionon nën drejtimin e Prokurorit të Përgjithshëm si strukturë e centralizuar, ku përfshihen zyra e Prokurorit të Përgjithshëm, Këshilli i Prokurorisë dhe prokuroritë pranë sistemit gjyqësor.

Prokuroria organizon duke bashkëpunuar edhe me institucione shtetërore, si dhe me subjekte të tjera publike e private nga radhët e shoqërisë civile veprimtari për edukimin e shoqërisë, me synim njohjen e ligjit dhe parandalimin e kriminalitetit.

Ndryshimet e fundit si dhe ndryshimet që do ti bëhen Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale të parashikuara në këtë Strategji do të ndihmonin prokurorët për parandalimin e shkeljeve në fushën e PI. Nga këto ndryshime rritet efektiviteti i ndjekjes penale pasi ky proces behet (*ex officio*) për këto vepra si dhe sigurohet një mbrojtje me e fortë për Pronësinë Intelektuale. Organet e policisë gjyqësore janë në shërbim të prokurorit për ushtrimin me efikasitet të ndjekjes penale.

Sfidat për të ardhmen

- *Trajnimi i prokurorëve në bashkëpunim me DPSH, DPPM, ZSHDA, SHKM.*
- *Bashkëpunim me DPPM për informacione në rastet e shkeljes së të drejtave të pronarëve të objekteve të PI.*

1.4.10 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve mund të konsiderohet si pjesë e procesit të zbatimit të të drejtave të Pronësisë Intelektuale për sa i përket vjeljes së saktë të taksave. Gjatë procedurës së vjeljes së taksave Drejtoria (punonjësit e saj) mund të marrin informacion për pastrim parash, mashtim dhe/ose mallra të falsifikuar. Prandaj punonjësit e tatimeve duhet të bashkëpunojnë ngushtë me Doganat dhe Policinë, që është detyra e tyre kryesore në strategjinë për zbatimin e të drejtave të Pronësisë Intelektuale.

1.4.11 AUTORITETI I KONKURRENCËS

Politika e Konkurrencës

Objektivi i politikës së konkurrencës është promovimi i efijencës dhe maksimizimi i mirëqenies së konsumatorëve. Politika e konkurrencës në thelb përbëhet nga dy elemente: (i). zbatimi i një sërë politikash që nxisin konkurrencën e lirë dhe efektive në treg, e cila ka të bëjë me liberalizimin e tregut, hapjen ndaj investimeve të huaja dhe liberalizimin ekonomik; etj. si dhe (ii). Respektimi i dispozitave ligjore në fushën e konkurrencës, veçanërisht në parandalimin e praktikave anti-konkurrese , kontrollin e përqendrimeve etj.

Pronësia intelektuale është e lidhur ngushtë dhe zbatohet edhe në respektim të normave në fushën e konkurrencës. Qasja e Politikës së konkurrencës, sugjeron se krijimi dhe ruajtja e kushteve për konkurrencë dhe konkurrimit në treg në fushën e DPI, nuk është vetëm obligim si pasojë e kuadrit ligjor të konkurrencës ose institucioneve zbatuese të këtij ligji, por dhe e kuadrit ligjor në vetë fushën e Pronësisë Intelektuale. Përcaktimi i ekuilibrit të duhur midis konkurrencës dhe DPI është një objektiv që të arrihet përmes hartimit të politikave dhe regjimeve ligjore përkatëse në të dy fushat.

Ligji i Konkurrencës dhe ai i Pronësisë Intelektuale bashkëveprojnë me njëri tjetrin. Përmendim përdorimin aktual të një patente të caktuar, dhe rastet kur kjo do të sillte shqetësime në lidhje me përdorimin e vet patentë-mbajtësit, si dhe shqetësimeve në lidhje me marrëveshjet e licencimit. Problematikë për konkurrencën nuk do të ishte pozicioni dominant i bazuar në kontrollin e patentave apo forma të tjera të Pronësisë Intelektuale, pasi nuk ka asgjë të veçantë në lidhje me situata të tilla dominimi të Pronësisë Intelektuale IP- ato trajtohet si çdo formë tjetër e dominimit. Në këtë rast duhet të përqendrohemi tek licencimi. Çështjet e licencimit mund të jenë të lidhura ngushtë me zbatimin e dispozitave të ligjit të konkurrencës për marrëveshjet e ndaluara apo përjashtimin nga marrëveshjet e ndaluara dhe duhet të trajtohen në zbatim edhe të akteve nënligjore lidhur me transferimin e teknologjisë .

Një rast tjetër bashkëveprimi mes ligjit të konkurrencës dhe të DPI ka të bëjë me sjelljen e aplikantëve për patenta dhe patentë-mbajtësit brenda procesit rregullator të vetë PI-së. Ndërsa shkelja e dispozitave ligjore në këtë fushë, normalisht do të dënohet nga vetë ligji për PI, një shkelje e tilla mund të ketë gjithashtu një dimension anti-konkurrues, që lidhet me respektimin e rregullave të ligjit të konkurrencës, me abuzimin me pozitën dominuese dhe pengimin e konkurrencës në treg.

Një rast tjetër bashkëveprimi mes ligjit të konkurrencës dhe të DPI ka të bëjë me rregullat lidhur me kontrollin e përqendrimeve, pasi këto transaksione mund të çojë në një përqendrim të lartë të të drejtave të PI. Në këtë rast dhënia e autorizimeve me kushte dhe detyrime nga Autoriteti i Konkurrencës, për të përfituar nga benefitet e një përqendrimi të tillë dhe bashkëpunimi midis dy agjencive do të ishte i nevojshëm.

Institucionet publike duhet të marrin një rol aktiv në promovimin e konkurrencës efektive në fusha, ku DPI dhe kuadri ligjor ne fuqi janë përcaktues të rëndësishëm të sjelljes konkurruese. Bashkëpunimi ndërmjet institucioneve të ndryshme mund të jetë thelbësore për të krijuar dhe ruajtur një mjedis konkurrues.

Sfidat për të ardhmen

- *Bashkëpunim i institucioneve të PI me Autoritetin e Konkurrencës. Organizimi i takimeve dypalëshe apo edhe trajnimeve të përbashkëta lidhur me bashkëveprimin e të drejtës së konkurrencës me Pronësinë Intelektuale;*
- *Rritja e ndërgjegjësimit të biznesit dhe publikut lidhur me fushat respektive si dhe adresimi pranë Autoritetit të Konkurrencës të çdo sjellje të mundshme antikonkurruese në fushën e të drejtave të Pronësisë Intelektuale.*

1.4.12 DHOMAT E TREGTISË / UNIONI I DHOMAVE TË TREGTISË/ DHOMA AMERIKANE E TREGTISË

Dhomat e tregtisë luajnë një rol të rëndësishëm në mbështetje të PI. Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë ofron trajnime dhe këshillime për anëtarët e saj për përdorimin e të drejtave të PI, për rëndësinë e regjistrimit të tyre, veçanërisht për markat tregtare dhe disenjot industriale. Dhoma Amerikane e Tregtisë përfaqëson kompanitë më të mëdha të huaja dhe fokusi i punës së saj në këtë fushë është më shumë në promovimin e zbatimit të PI në Shqipëri. Për këtë qëllim, Dhoma Amerikane e Tregtisë ka një komitet që ndihmon për të promovuar interesat e anëtarëve të saj.

1.4.13 AGJENCIA E KËRKIMIT, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT

Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKTI), e krijuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 903, datë 26.08.2009 "Për krijimin e Agjencisë së Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit", me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.7.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" do të ristrukturohet në Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit nën varësinë e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Kjo agjenci është institucioni juridik publik përgjegjës për financimin e kërkimit shkencor në shtatë fusha prioritare:

1. "Shkencat Sociale dhe Albanologjike"
2. "Sistemet dhe Teknologjitë e Informacionit (TIK)"
3. "Bujqësia (Veterinaria, Zooteknika), Ushqimi dhe Bioteknologjitë"
4. "Uji dhe Energjia"
5. "Biodiversiteti dhe Mjedisi"
6. "Shëndeti"
7. "Materialet".

Në këtë kuadër, Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit konsiderohet pjesë e rëndësishme e procesit të zbatimit të të drejtave të pronësisë intelektuale.

Nëpërmjet bashkëpunimit me DPPM-në, do të synohet promovimi dhe rritja e ndërgjegjësimit pranë Ndërmarrjeve të Vogla e të Mesme dhe universiteteve publike/private të së Drejtës së Pronësisë Intelektuale duke arritur në gjenerimin e shpikjeve të patentueshme.

AKTI, në bashkëpunim me DPPM-në, do të ofrojë asistencë teknike për të gjithë grupet kërkimore shkencore që aplikojnë pranë AKTI-t për financimin e një kërkimi shkencor, në lidhje me patentimin dhe hedhjen në treg të tij.

1.4.14 AVOKATËT DHE PËRFAQËSUESIT E AUTORIZUAR

Një tjetër komponent i rëndësishëm i sektorit privat në mbështetje të infrastrukturës së Pronësisë Intelektuale në Shqipëri janë avokatët dhe përfaqësuesit e autorizuar.

Ata shërbejnë si një lidhje e rëndësishme mes kompanive, universiteteve, individëve me DPPM, në veçanti, pasi aplikimi për regjistrimin e të drejtave të PI nga subjektet e huaja duhet të paraqitet nga një përfaqësues i licencuar nga DPPM.

KAPITULLI II

VIZIONI, POLITIKAT DHE QËLLIMET STRATEGJIKE

2.1 Vizioni i Qeverisë Shqiptare

Vizioni i Qeverisë Shqiptare, lidhur me Sistemin e Mbrojtjes së të Drejtave të Pronësisë Intelektuale në këtë Strategji është një ***sistem më i fortë i Pronësisë Intelektuale në Republikën e Shqipërisë, i cili siguron një mbrojtje efektive të objekteve të PI, inkurajon krijimtarinë dhe inovacionin në funksion të stimulimit të rritjes ekonomike dhe zhvillimit kulturor dhe shkencor në Republikën e Shqipërisë.***

Fokusi i saj është përmirësimi i funksionimit të sistemit të Pronësisë Intelektuale me qëllim, nxitjen dhe mbështetjen e inovacionit nëpërmjet nxitjes së punës kërkimore, në veçanti nga kompanitë shqiptare, universitetet vendase dhe individët, për të asistuar ekonominë shqiptare dhe qytetarët në rrugën drejt zhvillimit ekonomik dhe drejt standardeve më të larta. Në mënyrë specifike ajo do të mund të shërbejë si një mjet i politikës për të inkurajuar investimet në kërkim dhe zhvillim, si dhe garanton suksesin në treg.

Kjo Strategji synon rritjen e ndërgjegjësimit, si dhe forcimin e sistemit të regjistrimit, administrimit dhe mbrojtjes së të drejtave që rrjedhin nga Pronësia Intelektuale, si të drejta që ushtrojnë një ndikim të fuqishëm në zhvillimin dhe mirëfunksionimin e ekonomisë. Ajo gjithashtu synon të vendosë një numër objektivash në lidhje me R & D (kërkim dhe zhvillim) dhe forcimin e kërkimit shkencor në sektorin privat dhe publik në vend. Shpërndarja e subvencioneve qeveritare për R & D apo krijimi i fondeve publike për institutet kërkimore shkencore janë politika që synojnë të japin drejtpërdrejt kontribut në risi duke ofruar stimuj për të investuar në punë kërkimore.

Në përputhje me kërkesat dhe detyrimet që rrjedhin nga procesi i integritetit të Shqipërisë, sistemi i Pronësisë Intelektuale në Shqipëri duhet të garantojë efektivisht një nivel mbrojtje të të drejtave të Pronësisë Intelektuale të njëjtë me atë që ekziston në Bashkimin Evropian.

2.2 Politikat

Strategjia përcakton lidhjet ndërmjet politikave kombëtare në fusha të ndryshme për të pasur një koordinim efektiv për zbatimin e Pronësisë Intelektuale. Forcimi i sistemit të Pronësisë Intelektuale luan rol shumë të rëndësishëm në një konkurrence të ndershme në treg, mbrojtjen e konsumatorit, krijimin e besueshmërisë në treg për investime në kërkim dhe zhvillim, e si pasojë shërben për zhvillimin kulturor, social dhe ekonomik të një vendi.

Kjo strategji do të ndikojë mbi një sërë politikash sektoriale, të tilla si politikat e zhvillimit të industrisë, politikat e përmirësimit të konkurrueshmërisë në treg, për përmirësimin e klimës së biznesit dhe politikat për mbrojtjen e konsumatorit.

2.3 Qëllimet strategjike

Qëllimi i Qeverisë Shqiptare në fushën e Pronësisë Intelektuale është të stimulojë zhvillimin ekonomik, shkencor dhe kulturor në vend, të sigurojë një funksionim të përshtatshëm të tregut të brendshëm duke vendosur ekuilibrin e duhur ndërmjet të drejtave të pronarëve të objekteve të Pronësisë Intelektuale dhe interesave të përdoruesve si dhe të forcojë sistemin e regjistrimit dhe mbrojtjes së PI.

Në të njëjtën linjë, qëllimi i kësaj strategjie është të forcojë Sistemin e Mbrojtjes së Pronësisë Intelektuale në Republikën e Shqipërisë dhe ta bëjë atë të krahasueshme me vendet e Bashkimit Evropian, si një mekanizëm stimulues të zhvillimit ekonomik, social dhe kulturor në Republikën e Shqipërisë.

Ky qëllim arrihet nëpërmjet:

- Ofrimit të një sistemi të besueshëm dhe efikas të mbrojtjes së të drejtave të Pronësisë Intelektuale;
- Nxitjes, zhvillimit dhe shfrytëzimit ekonomik të Pronës Intelektuale.

Prioritetet strategjike vijnë si rezultat i detyrimeve që rrjedhin nga: (1) Dokumenti i Partneritetit Evropian (EPD); (2) Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA); (3) Raportet e Progresit të KE për Shqipërinë (4) Marrëveshja TRIPS dhe *acquis* i BE-së.

Qëllimet strategjike të këtij dokumenti lidhen me **katër objektivat e mëposhtme:**

- I. Përmirësimi i kuadrit ligjor;
- II. Zhvillimi dhe forcimi i institucioneve, të përfshira në zbatimin e të drejtave të Pronësisë Intelektuale;
- III. Forcimi i bashkëpunimit dhe koordinimit midis institucioneve, si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel rajonal apo me gjerë, në funksion të përmirësimit të punës në mbrojtje të të drejtave të Pronësisë Intelektuale;
- IV. Rritja e nivelit të ndërgjegjësimit në lidhje me PI në vend.

KAPITULLI III

OBJEKTIVAT E POLITIKËS DHE PRODUKTET MADHORE

I. **Përmirësimi i kuadrit ligjor.**

1. **Përmirësimi i kuadrit ligjor të Pronësisë Industriale dhe të drejtës së autorit.**

- i. Miratimi i ndryshimeve dhe shtesave në ligjin nr. 9947, datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale”, i ndryshuar:
 - Rregullimi i disa procedurave dhe kompetencave të DPPM-së, bazuar në praktikën kombëtare dhe atë ndërkombëtare në zbatim të ligjit në fushën e PI-së;
 - Përcaktimi i kompetencave *ex officio* të Zyrës për çregjistrim ose fshirjen nga regjistri i objekteve të PI-së të regjistruara në DPPM;
 - Ndryshimi i organizimit dhe strukturës administrative të DPPM-së nga një institucion publik buxhetor në një agjenci autonome në bazë të Neneve 10 e 20 të Ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me qëllim forcimin e kapaciteteve administrative dhe financiare, si element kryesor i realizimit të misionit të saj;
 - Ndryshim i kompetencave të gjykatës administrative lidhur me pretendimet e ngritura kundër vendimit të Bordit të Apelit. Meqenëse ky i fundit duke është një organ më i specializuar në fushën e pronësisë industriale, gjykata administrative shqyrton ligjshmërinë e vendimit të Bordit të Apelit të DPPM-së, dhe në rast se konstaton shkelje procedurale apo ligjore, e kthen çështjen për rishqyrtim në Bordin

e Apelit, me orientimet përkatëse, të cilat janë detyruese për këtë të fundit kur e merr për rishqyrtim po atë çështje;

- Përmirësimi i procedurave të regjistrimit të objekteve të PI;
 - Krijimi i bazës ligjore për rikompozimin e Bordit të Apelit dhe ndryshimi i kompetencave;
 - Krijimi i bazës ligjore për sigurimin e objekteve të PI-së, si dhe për përdorimin e tyre si kolateral, me qëllim që objektet e PI-së të marrin në treg vlerën që u takon;
 - Lehtësimi i procedurave të ekzaminimit, si dhe krijimi i një mjedisi ligjor për përmirësimin e shërbimeve elektronike dhe të komunikimit;
 - Krijimi i mundësisë së aplikimit online në funksion të lehtësimit të procedurave;
 - Rishikimi i kriterëve për licensimin e përfaqësuesve të autorizuar.
 - Përcaktimi ligjor i kriterëve për markat e mirënjohura dhe hartimi i rregullores përkatëse.
 - Krijimi i bazës ligjore për licensimin e ekspertëve të PI nga DPPM për nevojat e proceseve gjyqësore dhe të hetimit.
 - Krijimi i bazës ligjore për krijimin e dhomës për pavlefshmëri dhe shfuqizim, si një strukturë e re brenda DPPM.
- ii. Hartimi i rregulloreve në zbatim ndryshimeve të mësipërme të Ligjit nr. 9947, datë 07.07.2008 “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar.
- iii. Miratimi ndryshimeve në Ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i RSH”, i ndryshuar.
- iv. Hartimi i rregulloreve për funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut.

2. Ratifikimi i marrëveshjeve të tjera në fushën e Pronësisë Industriale dhe të të drejtës së autorit.

- i. Nënshkrimi i Marrëveshjes së Lisbonës dhe Aktit të Gjenevës për Marrëveshjen e Lisbonës në lidhje me treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës, për të përcaktuar procedurat për mbrojtje ndërkombëtare të treguesve gjeografikë dhe emërtimeve të origjinës.
- ii. Nënshkrimi i Marrëveshjes së Lokarnos për klasifikimin ndërkombëtar për disenjt industrialë.
- iii. Nënshkrimi i Marrëveshjes së Vjenës për klasifikimin e elementeve figurative të markave.
- iv. Ratifikimi i Marrëveshjeve për klasifikimet e Vjenës dhe Lokarnos do të përmirësojnë cilësinë shërbimeve të DPPM-së.
- v. Aderimi me ligj në Traktatin e Marakeshit për personat me dëmtime në shikim.
- vi. Aderimi me ligj në Traktatin e Pekinit mbi veprat audiovizuale.

3. Hartimi dhe miratimi i dispozitave në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale, me qëllim rritjen e masave të dënimit për rastet që përbëjnë shkelje të të drejtave të PI dhe kërcënim për shëndetin publik.

- i. Ndryshime të Kodit të Procedurës Penale, duke hequr nga neni 59 i Kodit të Procedurës Penale (i dëmtuari akuzues) nenet 148 (Botimi i veprës së tjetrit në emrin e vet) dhe 149 (Riprodhimi pa të drejtë i veprës së tjetrit) të Kodit Penal, dhe të kalojnë tek neni 284 të Kodit të Procedurës Penale (Ankimi), me qëllim që veprat penale të pronësisë intelektuale (nenet 148 dhe 149 të Kodit Penal) të ndiqen me ankim, në mënyrë që

detyrimin për të hetuar dhe provuar akuzën ta ketë jo i dëmtuari akuzues, siç është aktualisht, por organi procedues (prokuroria).

4. Përditësimi i bazës ligjore me akte nënligjore si udhëzime dhe manuale për doganierët.

- i. Hartimi dhe miratimi i manualeve dhe udhëzimeve.

5. Ngritja dhe funksionimi i sistemit anti-plagjiaturë

- i. Hartimi dhe miratimi i projekt vendimit për ngritjen e sistemit anti-plagjiaturë të doktoratave në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe AKTI-n.

II. Zhvillimi dhe forcimi i institucioneve, të përfshira në zbatimin e të drejtave të Pronësisë Intelektuale.

6. Forcimi i kapaciteteve administrative.

- i. Shtimi i stafit të DPPM me mbi 30 punonjës.
- ii. Krijimi i këshillit mbikëqyrës të DPPM.
- iii. Rikompozimi i përbërjes së Bordit të Apelit të DPPM, si dhe rishikim i kompetencave të tij.
- iv. Krijimi i dhomës për shfuqizim dhe pavlefshmëri si pjesë e DPPM.
- v. Trajnim i vazhdueshëm i stafit të DDA, DPPM ofruar nga ekspertiza e huaj mbi zhvillimet e fundit në fushën e të drejtës së autorit, kurse dhe trajnime të mbështetur nga BE, OBPI, ZEP, ZPIBE me qëllim rritjen e profesionalizimit të punonjësve të përfshirë në sistemin e PI.
- vi. Marrja pjesë në konferenca, trajnime dhe workshop-e ndërkombëtare.
- vii. Organizimi i trajnimeve disa ditore në Akademinë e sigurisë me specialistët e hetimit të krimeve ekonomike dhe financiare në bashkëpunim me DPPM, DPD, DDA, Prokurorinë dhe AKU.
- viii. Përmirësimi i strukturës organizative dhe funksionale të Institucioneve të përfshira në sistem, lehtësimi të procedurave, mënyrat e rekrutimit dhe trajnimit të stafit.
- ix. Krijimi i një Akademie për PI-në brenda strukturës së DPPM, e cila do të bëjë trajnimin e vazhdueshëm të të gjithë aktorëve në sistem, si dhe do të hartojë tekste informuese në këtë fushë.

7. Ndërtimi i një infrastrukture të mirëfilltë administrative brenda institucioneve kombëtare të përfshira në sigurimin e mbrojtjes së Pronësisë Intelektuale.

- i. Forcimi i kapaciteteve administrative të DPD dhe Degëve Doganore, nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme për të përditësuar me zhvillimet më të reja legislative dhe për të përvetësuar më mirë procedurat ekzistuese doganore, që lidhen me zbatimin e të drejtave të Pronësisë Intelektuale.
- ii. Krijimi i përdoruesve në bazën e të dhënave të DPD sipas specifikave të çdo të institucioni për të përfutur informacione të cilat do të shërbejnë për të përmirësuar cilësinë e punës

8. Rritja e nivelit të cilësisë së shërbimeve të DPPM.

- i. Shkurtimi i afateve të ekzaminimit;
- ii. Rritja e numrit të publikimeve të buletinit të PI;
- iii. Hartimi i udhërrëfyesve për ekzaminimin e markave dhe patentave.

9. Rritja e numrit të hetimeve për shkeljet e të drejtave të Pronësisë Intelektuale për Policinë e Shtetit.

- i. Rritja me 5% në vit e evidentimit të veprave penale në shkeljen e të drejtave të PI.

10. Përmirësimi i sistemit të menaxhimit dhe përpunimit të informacionit për të drejtat e Pronësisë Intelektuale në DPD

- i. Instalimi i versionit të plotë të software INES +, i cili do të shërbejë si bazë të dhënash dhe në procesimin e kërkesave për veprim doganor në format elektronik.

11. Komunikimi elektronik ndërmjet institucioneve të përfshira në sistem.

- i. Modernizimi i sistemeve TIK me qëllim përmirësimin e komunikimit ndërmjet institucioneve të përfshira në sistemin e regjistrimit dhe zbatimit të të drejtave të PI.
- ii. Përditësimi në kohë reale i të dhënave.
- iii. Trajnimi i stafit të institucioneve në përdorimin e këtyre sistemeve

Ky komunikim do të realizohet nëpërmjet platformës së ndërveprimit të AKSHI-t. (Sipas termave të përcaktuara në Kornizën Kombëtare të ndërveprimit për Republikën e Shqipërisë.)

12. Mbikëqyrja dhe monitorimi i AAK nga institucionet përgjegjëse.

- i. Nxitja e krijimit të agjencive të administrimit kolektiv të të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura dhe për degë të artit të cilat nuk janë të mbuluara, p.sh. fotografia etj.
- ii. Krijimi i një sporteli unik “one stop shop” për pagesat e të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura.
- iii. Monitorimi në mënyrë periodike i veprimtarisë së Agjencive të Administrimit Kolektiv të të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura me to.

13. Zhvillimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i bibliotekës së Shkollës së Magjistraturës

- i. Pasurimi i bibliotekës me materiale në gjuhën shqipe dhe të huaj për të përballuar kurset e reja që do të zhvillohen.
- ii. Përkthimi në shqip i çështjeve më të rëndësishme të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në fushën e PI.
- iii. Zhvillimi dhe thellimi i lidhjeve tona me bibliotekat e shkollave evropiane të magjistraturës dhe institucioneve të tjera ligjore. Prioritet do të jetë sigurimi i aksesit në biblioteka dhe baza të dhënash online, të cilat do të bëjnë të mundur thellimin e njohurive dhe realizimin e kërkimeve në fushën e Pronësisë Intelektuale.

14. Përmirësimi i infrastrukturës TIK dhe modernizimi i shërbimeve të DPPM dhe përmirësimi i procedurave të regjistrimit të objekteve të PI (2018-2020).

- i. Zhvillimi i kapaciteteve dhe pajisjeve në mënyrë që të implementojë një sistem TIK moderne, si një faktor kyç në realizimin e objektivave strategjike të saj. Sigurimi i një përputhshmërie të plotë të sistemit TIK kombëtar me atë të OBPI, ZEP dhe ZPIBE.

- ii. Aplikimi online për të gjitha shërbimet që ofron DPPM dhe integrimi i sistemit SAPI në rrjetin e ndërveprimit të bazave të të dhënave shtetërore, implementimin 100% për çdo dokument të depozituar në DPPM në sistemin EDMS duke e kthyer procedurat e zyrën në e-dossie.
- iii. Përmirësimi i faqes zyrtare të DPPM-së dhe regjistrave online.
- iv. Përfundimi i saktësimit në sistemin SAPI, të të dhënave të markave ndërkombëtare;
- v. Skanimi arkivës së Markave, Disenjove Industriale dhe Treguesve Gjeografike dhe saktësimi i të dhënave të regjistrave.

15. Përmirësimi dhe funksionimi sistemit të regjistrimit online të së drejtës së autorit (2018-2020).

- i. Regjistrimi i veprave të së drejtës së autorit do të kryhet online duke automatizuar kështu procesin e regjistrimit të veprave.
- ii. Aplikimi i këtij sistemi online sjell procedura me të shpejta regjistrimi si dhe verifikimin online të çdo vepre të regjistruar.

16. Ngritja e qendrave të transferimit të teknologjisë

- i. Ngritja e qendrës së transferimit të teknologjisë në Universitetin Politeknik të Tiranës.
- ii. Hartimi i një model kontrate ligjore për veprimtari shkencore dhe zhvillim ku të përcaktohen qartë të drejtat dhe detyrimet e të gjithë aktorëve në bashkëpunim (universitet me organizatat shkencore dhe të zhvillimit me individët).

III. Forcimi i bashkëpunimit dhe koordinimit midis institucioneve, si në nivel kombëtar, ashtu edhe në nivel rajonal apo me gjerë, në funksion të përmirësimit të punës për mbrojtjen e të drejtave të Pronësisë Intelektuale

17. Forcimi i bashkëpunimit dhe koordinimit midis institucioneve në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar.

- i. Bashkëpunim transparent dhe eficient midis institucioneve dhe organizatave kompetente të përfshira në sistem, bashkëpunime të ngritura mbi bazën e marrëveshjeve të miratuara.
- ii. Trajtime të vazhdueshme të institucioneve të përfshira në fushën e Pronësisë Intelektuale si dhe për sistemin e drejtësisë, si dhe rritje e bashkëpunimit me Shkollën e Magjistraturës;
- iii. Organizimi i operacioneve të përbashkëta kombëtare me DPD, DPT, AKU, Inspektoratin shtetëror të mbikëqyrjes së tregut.
- iv. Organizmi i operacioneve të përbashkëta me strukturat ligjzbatuese në nivel kombëtar (Policia e Shtetit, Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit/ Drejtoria e të drejtës së Autorit, dhe/ose struktura kontrolluese të tregut të brendshëm).
- v. Organizmi dhe menaxhimi i operacioneve për mbrojtjen e të drejtave të Pronësisë Intelektuale duke përfshirë vendet e anëtare Southeast European Law Enforcement Center (SELEC)
- vi. Organizimi dhe menaxhimi i operacioneve nga INTERPOL-i, Organizata Botërore e Doganave dhe/ose nga Shërbime Doganore Homologe.
- vii. Forcimi i bashkëpunimit me zyrat rajonale homologe në fushën e të drejtës së autorit si dhe organizmit të aktiviteteve të përbashkëta me qëllim promovimin e të drejtës së autorit.

- viii. Bashkëpunim i institucioneve të PI me Agjencinë e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Autoritetin e Konkurrencës. Organizimi i takimeve dypalëshe apo edhe trajnimeve të përbashkëta lidhur me bashkëveprimin e të drejtës së konkurrencës me Pronësinë Intelektuale.
- ix. Bashkëpunim me DPPM për informacione në rastet e shkeljes së të drejtave të pronarëve të objekteve të PI.
- x. Zbatimi në praktikë i ligjit të konkurrencës për të shmangur abuzimet e mundshme gjatë ushtrimit të të drejtave të Pronësisë Intelektuale.

18. Nënshkrimi i memorandumeve të bashkëpunimit dhe krijimi i grupit ndërinstitucional për monitorimin dhe respektimin e të drejtave të autorit

- i. Krijimi i një mekanizmi për të siguruar bashkëpunimin transparent dhe eficient me DDA, (Memorandume bashkëpunimi).
- ii. Nënshkrimi i Memorandumeve të Mirëkuptimit me Zyrat Rajonale homologe të së Drejtës së autorit.
- iii. Krijimi i një grupi ndërinstitucional për monitorimin e respektimit të të drejtave të autorit nga OSHMA-ja.
- iv. Krijimi i planeve të përbashkëta të punës me Policinë e shtetit, tatimet dhe me AMA për monitorimin dhe respektimin e të drejtës së autorit.

19. Përmirësimi dhe forcimi i bashkëpunimit me AAK-të (2018-2020)

- i. Trajnime të vazhdueshme të stafit të AAK-ve mbi çështjet e menaxhimit kolektiv;
- ii. Ofrimi i ekspertizës së huaj të ekspertëve të BE-së për AAK;
- iii. Monitorimi i vazhdueshëm nga ZSHDA (DDA) të AAK në ushtrim të kompetencave që u njeh ligjit.
- iv. Bashkëpunim i DDA me AMA.

20. Forcimi dhe trajnimi i vazhdueshëm i sistemit gjyqësor 2018-2020

- i. Shtimi i numrit të trajnimeve të gjykatësve (1-2 trajnime në vit), që do të angazhohen në gjykatën administrative, dhe në mënyrë të veçantë me ata që do të merren në mënyrë specifike me çështjet e DPI.
- ii. Bashkëpunim i Shkollës së Magjistraturës me DPPM dhe Ministria e Kulturës/DDA.
- iii. Përmirësimi i kurrikulave, programeve e planeve mësimore, në programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, duke reflektuar ndryshimet në legjislacion dhe në praktikat kombëtare e ndërkombëtare në fushën e Pronësisë Intelektuale.

21. Parandalimi dhe ndalimi i shkeljeve të të drejtave të Pronësisë Intelektuale.

- i. Vlerësimi i riskut për produktet apo shërbimet (kryerja e analizave përkatëse). Marrja e masave administrative ndaj shkelësve të së drejtës.

22. Takime për monitorimin e Strategjisë të PI (2016-2020)

- i. Takime periodike (dy herë në vit), midis institucione të përcaktuara në këtë Strategji, ku secili të raportojë mbi realizimin e detyrave të tij dhe të mbajë përgjegjësi në raste të mospërmbushjes së aktiviteteve të cilat janë përcaktuar në këtë dokument.

IV. Rritja e ndërgjegjësimit të publikut në Shqipëri lidhur me të drejtat e Pronësisë Intelektuale

23. Zbatimi i një projekti me qëllim krijimin e një ambienti stimulues për rritjen e aplikimeve për disenjot industriale dhe patentat për shpikje.

- i. Identifikimi i bizneseve me potencial të mundshëm inovativ, si dhe organizimi i seminareve dhe aktiviteteve trajnuese në lidhje me to.
- ii. Krijimi i qendrave të tjera informuese në universitetet teknike në Vlorë, Shkodër dhe Korçë;
- iii. Përgatitja dhe organizimi i trajnimeve specifike për stafin e qendrave të informacionit mbi përdorimin e sistemit.

24. Zbatimi i një projekti me qëllim kryerjen e një analize territoriale për evidentimin e produkteve shqiptare me karakteristika gjeografike sipas zonave (potenciale për t'u regjistruar si tregues gjeografik apo emërtim të origjinës) promovimi dhe nxitja për rëndësinë e mbrojtjes së treguesve gjeografikë shqiptarë.

- i. Analiza dhe harmonizimi bazës ligjore që siguron mbrojtjen e Tregueseve Gjeografike në Shqipëri.
- ii. Studimi në krahinat e ndryshme dhe sidomos në zonat rurale të Shqipërisë për të evidentuar produktet potenciale për tu mbrojtur si TG.
- iii. Hartimi i analizës dhe përcaktimi kriterëve dhe karakteristikave të produkteve potenciale te secilës krahine.
- iv. Organizimi i aktiviteteve promovuese dhe trajnuese për mbrojtjen dhe regjistrimin e TG të organizuar sipas rretheve: Gjirokastrë, Tepelene, Elbasan, Vlorë, Malësia e Madhe etj.. Aktivitetet për secilin nga këto rrethe janë të parashikuara si shembulli i aktiviteteve për rrethin e Gjirokastrës dhe Përmetit. Analiza do të jetë baza për evidentimin e rëndësisë për aktivitete ndërgjegjësimi në rrethe të tjera të Shqipërisë.

25. Zbatimi i një projekti me qëllim krijimin e një ambienti stimulues për rritjen me 2% të numrit të aplikimeve për regjistrimin e produkteve dhe shërbimeve si marka tregtare.

- i. Identifikimi i bizneseve me potencial të mundshëm për regjistrimin e shërbimeve që ato ofrojnë si marka tregtare;
- ii. Organizimi i seminareve dhe aktiviteteve trajnuese në lidhje me to;
- iii. Asistencë në hartimin e dokumentacionit të nevojshëm për regjistrimin e markës tregtare.

26. Rritja e ndërgjegjësimit dhe edukimit publik në Shqipëri, lidhur me të drejtat e Pronësisë Intelektuale.

- i. Nxitja e krijimtarisë tek brezat që rriten përmes aktiviteteve promovuese të ndryshme në formën e konkurseve të talenteve të rinj të degëve të ndryshme: art, letërsi, art, pikturë, interpretim në kuadër dhe të Ditës Botërore të Pronësisë Intelektuale, çdo vit më datë 26 Prill (2018-2020).
- ii. Organizimi i tryezave të rrumbullakëta me publikun si dhe i takimeve informative me kategori të ndryshme përdoruesish të drejtash në lidhje me çështjet e PI;
- iii. Rritja e shkallës së informimit të publikut, shoqërisë dhe komunitetit në fushën e Pronësisë Intelektuale përmes organizimit të seminareve, konferencave dhe aktiviteteve promovuese.

- iv. Rritja e ndërgjegjësimin të biznesit dhe publikut lidhur me fushat respektive, si dhe adresimi pranë Autoritetit të Konkurrencës të çdo sjellje të mundshme antikonkurruese në fushën e të drejtave të Pronësisë Intelektuale.

Fokusi i DPPM-së në planin e aktiviteteve promovuese për vitin 2016-2017 do të jenë:

- ✓ Universitetet vendase për nxitjen e punës kërkimore dhe për regjistrimin e saj si shpikje pranë DPPM-së, në bashkëpunim me AKKSHI.
- ✓ Prodhuesit vendas për evidentimin dhe regjistrimin e produkteve karakteristike shqiptare si tregues gjeografikë.
- ✓ Bizneset në përgjithësi për evidentimin dhe regjistrimin e disenjave industriale.
- ✓ Edukimi i gjeneratave dhe brezave nëpërmjet aktiviteteve promovuese dhe ndërgjegjësuere në fushën e Pronësisë Industriale.

27. Hartimi i kurrikulave, materialeve mësimore dhe moduleve për nxënësit, mësuesit, studentët dhe stafi akademik.

- i. Hartimi i materialeve mësimore për Pronësinë Intelektuale në ciklin 6-9 të arsimit bazë dhe në arsimin e mesëm.
- ii. Hartimi i moduleve për mësuesit e lëndës së qytetarisë për ciklin 6-9 të arsimit bazë. Moduli “Pronësia Intelektuale” të integrohet në kurrikula të gjimnazit kur të hartohen programet e reja të arsimit të mesëm.
- iii. Hartimi i materialeve kurrikulare për hetimin e krimit Ekonomik dhe Financiar për studentët e Fakultetit të Hetimit të Krimit (6 orë mësimore *për hetimin e veprave penale të shkeljes të të drejtave të PI*).
- iv. Trajnimi i mësuesve të lëndës së qytetarisë në arsimin e mesëm dhe trajnimi i mësuesve të lëndës së qytetarisë për klasat 6-9 për Pronësinë Intelektuale.
- v. Reformimi i kurrikulës së arsimit parauniversitar në kurrikulë me bazë kompetencat.

28. Organizimi i konkurseve, veprimtarive artistike etj., për nxitjen e krijimtarisë te brezat e rinj të DDA.

- i. Hartimi i një platforme për veprimin afatgjatë, përmes aktiviteteve të ndryshme në formën e konkurseve ndërmjet talentëve të rinj në degë të ndryshme si: art, letërsi, pikturë, interpretim etj.
- ii. Zhvillimi i konkurseve me krijime artistike dhe shpikje të thjeshta.

29. Informimi dhe ndërgjegjësimi i biznesit mbi vlerën e PI (2018-2020).

- i. Përmirësim i dialogut me biznese për rëndësinë, vlerën dhe mënyrat e mbrojtjes të Pronësisë së tyre Intelektuale;
- ii. Hartimi dhe zbatimi i projekteve me bizneset për ndërgjegjësimin e tyre në financimin e departamenteve të kërkim zhvillimit, dhe të regjistrimit të objekteve të PI-së.
